

Fluturimi i përdredhur i lirisë:

LEONARDO DE MARTINO VS. NDRE MJEDA

Nga Matteo Mandalà

Duke rilexuar faqet e dendura të përmbledhjes “Harpa e një arbëreshi” (*Arpa di un italo-albanese*) është vërtet e pamundur të mos vihen re në afshin patriotik të autorit, të cilit sot i kujtojmë njëqindvjetorin e vdekjes, rrënjët e paradigmes ideologjike që e bëri këtë intelektual arbëresh të jashtëzakonshëm ta shndërronte shpirtin zanafillor prej misionari franceskan në një gjendje të re jete dhe veprimi. At De Martino jo vetëm që zgjodhi të bëhej një interpretues autentik i ndjenjave dhe idealeve të traditës romantike italiane, por edhe një divulgues i vetëdijshëm i tyre qysh para transferimit të tij në Shqipëri në vitin 1865.

In memoriam

PASURITË E MËDHA TË MUSA VYSHKËS: POEZIA DHE MIQTË!

Nga Andon Andoni

(fq. 6)

LIDHJA E SHQIPTARËVE NË RUMANI “ALAR” NË BIBLIOTEKËN KOMBËTARE TË SHQIPËRISË

(fq. 21)

SHËNIME MBI LIBRAT

Romani “Kronikat e mjegullës” i Bashkim Hoxhës

HISTORI TË SAJUARA QË FSHIJNË TË VËRTETËN

Nga Kosta Nake

(fq. 5)

VISAR ZHITI SI KRIJUES I VEÇANTË NË SYTË E MI DHE NË LETRAT SHQIPE

Nga Dr. sc. Bardhyl Maliqi

(fq. 8)

Mbi vëllimin “Shtegtim vargjes” të Loreta Schillock POEZI E INDIVIDUALIZIMIT TË TEMAVE UNIVERSALE


Nga Arben Prendi

(fq. 9)

PËR POETIN LLUKA QAFOKU

Nga Lekë Tasi

(fq. 10)



Efektet e faktorit ndërgjuhësor në përkthimin turqisht të romanit “Rrethimi” (Kështjella) të Kadaresë

Nga Ece Dillioğlu

Ajo që përgjithësisht konsiderohet e pranueshme në kontekstin e përkthimit të një teksti nëpërmjet një gjuhe ndërgjuhësore është se teksti origjinal nuk është më i aksesueshëm ose teksti origjinal është dëmtuar. Në këtë aspekt dëshiroj të tregoj dy shembuj nga romani “Rrethimi” të Ismail Kadaresë. Romani u përkthye në turqisht nga Hasan Kaya në vitin 2011. Ky përkthim nuk është përkthyer nga burimi kryesor shqipja por nga frëngjishtja.



NË SHKODËR PËR HERË TË PARË “KALLXIMET E ANDERSEN-IT” - PËR SHKOLLA E FAMILJE -

Nga Xhahid Bushati


(fq. 19)

JON FOSSE:

Një gjuhë e heshtur

Ligjërata e Nobelit, 8 dhjetor 2023

Përktheu: Granit Zela



(fq. 22)

BIBLIOTEKË

Nasi Lera

(fq. 14)

Etër, bij dhe pylli

Sokol Zekaj

(fq. 12)

Rreth një arti poetik

Sali Bashota

(fq. 16)

Fundi i harrimit

Vangjush Saro

(fq. 17)

Pema e Krishtlindjes

Arben Velo

(fq. 16)

Një grua në avionin e

kujtimeve të mia

Suad Arilla

(fq. 11)

Zanafilla

Karin Smirnoff

(fq. 20)

Missing People

90 vjet më parë, Osip Mandelstam krijoi
Epigramin kundër Stalinit

KUR POETI U MËSON QYTETARËVE SI TË JETOJNË TË LIRË

Ese nga Elida Buçpapaj

Prej atij nëntori deri te ky nëntor kanë kaluar 90 vjet. 90 vjeçar do të duhet të jenë edhe ato 16 vargjet e Epigramit të Osip Mandestam kundër Stalinit, por që nuk njohin as plakje, as syrgjyn dhe as vdekje.

(fq. 18)


Duke rilexuar faqet e dendura të përmbledhjes “Harpa e një arbëreshi” (*Arpa di un italo-albanese*) është vërtet e pamundur të mos vihen re në afshin patriotik të autorit, të cilit sot i kujtojmë njëqindvjetorin e vdekjes, rrënjët e paradigmes ideologjike që e bëri këtë intelektual arbëresh të jashtëzakonshëm ta shndërronte shpirtin zanafillor prej misionari franceskan në një gjendje të re jete dhe veprimi. At De Martino jo vetëm që zgjodhi të bëhej një interpretues autentik i ndjenjave dhe idealeve të traditës romantike italiane, por edhe një divulgues i vetëdijshëm i tyre qysh para transferimit të tij në Shqipëri në vitin 1865. Njëkohësisht ai u bë përfaqësues po aq i vetëdijshëm në trojet shqiptare i lëvizjes kulturore dhe politike arbëreshe të shek. XIX, eksponenti kryesor i së cilës ishte Jeronim De Rada. Admirues dhe ithtar i imzot Giuseppe Marinoni-t (1810-1891) që ishte përfaqësues i përndritur i klerit lombard dhe themelues i institutit papnor për misionet e jashtme (1850-1891), qysh nga vitet e para të mbërritjes në Shkodër, më saktë në kuvendin e Troshanit, françeskani arbëresh u bë një pikë referimi për rininë shqiptare dhe një promovues i palodhur i letërsisë së re në gjuhën shqipe.

Gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX intelektualët arbëreshë, pasi morën pjesë aktive në lëvizjen për bashkimin dhe pavarësinë e Italisë, i kthyen sytë nga Shqipëria, atdheu i të parëve të tyre, i Skënderbeut dhe i besimit të lashtë të krishterë, duke i dhënë jetë kështu një procesi mitizimi, që kishte për synim të promovonte ringjalljen kulturore dhe politike të shqiptarëve për t'i çliruar ata shpirtërisht, së pari, nga zgjedha osmane, e pastaj për t'i mbrojtur edhe nga politikën kolonialiste të fuqive të tjera të rajonit. Për t'ia arritur këtij synimi ambicioz, ata hartuan një strategji që përpigje të përshtaste në mjedisin ballkanik të njëjtat mjete që kishin përdorur gjatë luftave të Risorxhimentos italiane. Kështu, për të ngritur në këmbë popullin shqiptar, që në masën dërrmuese ishte analfabet, u pa e nevojshme që jo vetëm të zbuloheshin forma të reja komunikimi kulturor dhe politik, si p.sh. teatri me shprehjet e shumta të tij, por edhe të ngriheshin shkolla dhe qendra formimi për rininë e të përhapje, falë shtypit në gjuhën shqipe, një vizion i ri kulturor kombëtar. Në kuadrin e përgjithshëm të kësaj politike për emancipimin kulturor të shqiptarëve u bë e domosdoshme lërimi i gjuhës shqipe dhe i një letërsie në shqipe, përhapja e shkrimit të gjuhës ndër të rinjtë, si edhe botimi i veprave të intelektualëve shqiptarë të mbetura në dorëshkrim. Me fjalë të tjera, kemi të bëjmë me një përpjekje për të rivendosur lidhjet historike me autorët e vjetër të shek. XVI-XVIII në mënyrë që t'i sigurohej letërsisë shqipe moderne një identitet më solid, mbi të gjitha në funksion të projektit të çlirimit kombëtar. Shkurtimeisht këto janë elementet kryesore të botëkuptimit rilindas apo neo-risorxhimental të Leonardo De Martino-s, i cili jo më kot në pjesët jopoetike të vëllimit *Harpa* vendosi të sjellë dëshmi dokumentare që shpalosin para bashkëkohësve parimet dhe synimet e filozofisë së tij politiko-kulturore. Kujtojmë këtu se vepra u botua në 1881, pak vite pas traktatit të Berlinit (1878) dhe themelimit të Lidhjes së Prizrenit (1878), dhe vetëm dy vjet para botimit të revistës *Fiamuri Arbërit* (1883) me të cilën De Rada do të tërhiqte vëmendjen e politikës europiane drejt “çështjes ballkanike”. Kjo datë e fundit simbolike nuk ia zvogëlon rëndësinë teksteve që ndërkohë kishin dalë në dritë më parë, si botimi në vitin 1868 i veprës *Vaji i hapset* me të cilën De Martino përkthente për herë të parë në shqipe kryeveprën e romantizmit lombard: romancën e famshme *Rondinella pellegrina* të Tommaso Grossi-t (1790-1853), mbi historinë e përkthimit të së cilës do të ndalemi më poshtë me qëllim që të nxjerrim në dritë të vërtetën historike mbi një ngjarje që përcaktoi braktisjen e misionit apostolik në Shqipëri dhe largimin e papritur e përfundimtar nga Shkodra të De Martinos, si edhe të vëmë në vend integritetin dhe prestigjin moral, politik dhe kulturor të këtij

intelektuali të shquar.

Falë mprehtësisë kritike largpamëse të Ernest Koliqit, dihet tashmë fakti se ndër premisat kulturore të qasjes ideologjike të De Martinos ndaj letërsisë së Rilindjes shqiptare ishte edhe nevoja për të forcuar lidhjet me letërsinë romantike italiane. Nuk është e rastit që te *Harpa* u përfshinë përkthimet në gegërishten e Shkodrës të shumë veprave të autorëve të shquar italianë, si Pietro Metastasio, Alessandro Manzoni, Giacomo Leopardi dhe i lartpërmenduri Tommaso Grossi, autori i romanit historik *Marko Viskonti*, i cili qysh nga botimi i tij i parë në vitin 1834 njohu një përhapje të madhe dhe u ribotua shumë herë gjatë gjithë shek. XIX. Interes të madh ngjalli sidomos romanca *Rondinella pellegrina* që me kohë u shndërrua në një lloj manifesti letrar të risorxhimentos italiane. Rivëniet e shpeshta në skenë dhe përshtatjet e shumta muzikore – që arritën në disa dhjetëra të tilla në mbarë Italinë

nga Veriu deri në Jug – e transformuan veprën e Grossi-t në një *topos* të dashur për të gjithë poetët dhe shkrimtarët romantikë italianë. Tek e fundit, nuk kishte imazh më të mirë për të përfaqësuar brengat dhe mundimet e popujve të shtypur nga fuqitë e huaja sesa ai i “dallëndyshes në kafaz” e nuk kishte metaforë më të goditur për të shprehur në rrafshin letrar rrugën e gjatë drejt pavarësisë dhe lirisë sesa fluturimi i vetmuar i shpendit të brengosur. Për më tepër, zanafilla e tekstit të romancës përmbante disa tipare parahistorike që e mbikarakterizonin në sytë e romantikëve të kohës: me rrënjë të largëta popullore, “dallëndyshja shtegtare” e kishte zënë fillin në kulturën alpine të luginave të Bergamos, ku ishte përhapur si këngë dasme. Më pas u përpunua nga Paolina Secco-Suardo Grismondi (1746-1801), poetesha e njohur me pseudonimin Lesbia Cidonia, e cila në versionin e saj poetik që doli pas vdekjes në vitin 1820, por që ishte shkruar në shek.



FLUTURIMI I PËRDREDHUR I LIRISË: LEONARDO DE MARTINO VS. NDRE MJEDA

Nga Matteo Mandalà



XVIII, solli shumë ndryshime semantike: së pari, përjetësoi krakëllimën e ngjirur të shpendit duke e identifikuar me «vajin» e poeteshës dhe, së dyti, konsakroi vlerën simbolike të fluturimit «rreth folesë së dashur» ku poetët e mëvonshëm romantikë njohën truallin e shenjtë të atdheut. Falë këtyre elementeve ideologjike jo vetëm që nuk ka dyshime mbi prejardhjen e romancës së Grossi-t, por nuk mund të vihet në dyshim as evolucioni ideologjik dhe përhapja e saj: në fakt, kjo këngë jo vetëm që i përkiste poezisë popullore italiane, pra jo vetëm që lidhej me traditën e këngëve të dasmës, por ajo ishte e përhapur në gjithë gadishullin Apenin, nga Veriu në Jug, madje deri edhe mes arbëreshëve. Vlen të kujtojmë këtu këngën e dasmës me titullin domethënës *La rondinella* (dallëndyshja) që Michele Marchianò botoi në vitin 1906 pasi e gjeti në një dorëshkrim me origjinë siciliane të shek. XVIII.


Pjesa e dytë e fluturimit të “dallëndyshes në kafaz” u krye në mjedisin europian. Përkthimet thaujse të njëkohshme të *Marko Viskontit* gjermanisht (1835), frëngjisht (1836), spanjisht (1847) dhe anglisht, patën meritën se ndikuan në mënyrë vendimtare në letërsinë romantike europiane dhe i siguruan përhapje “vajt” në vende si Gjermania, që ishte në kërkim të bashkimit aq shumë të dëshiruar nga Hegeli, ku mundimet e shpendit simbolizonin mundimet e popujve që gjendeshin nën zgjedhën e huaj. Ndër vendet që u prekën nga fluturimi i vetmuar ishte edhe Shqipëria, ku “dallëndyshja shtegtare” vendosi të ndalej për të gjallëruar ndërgjegjet e mekura të shqiptarëve.

Sipas Filip Fishtës, studiues i historisë së letërsisë shqiptare të cilit nuk i janë njohur ende vlerat shkencore siç meriton, i pari që «këndon këngën e bylbylit ndër tetë-rrokësja» ishte Pjetër Zarishi, i cili qysh nga viti 1837 «u bā prekursori i De Martinit e i Ndrë Mjedjes mbi ket lëndë». Mund të supozohet që De Martini u frymëzua nga leximi i tekstit të Zarishit, dorëshkrimet e të

cilit i pati në dorë për një periudhë relativisht të gjatë para sa t'ia dorëzonte Prenk Bib-Dodës. Por pavarësisht nga ky fakt, s'ka dyshim që ideatori i përkthimit shqip të romancës së Grossit ka qenë pikërisht Leonardo De Martino, i cili në vitin 1868, sikurse e thamë më lart, e përktheu këngën shqip duke ia kushtuar atë një poeteshe tjetër, Dora D'Istrias, që atyre viteve ishte shndërruar në një lloj priftëreshe të lëvizjeve kombëtare të popujve ballkanikë e sidomos të atij shqiptar. Suksesi i *Vajit të hapses*, siç e quajti këngën përkthyesi ynë, qe i menjëhershëm: i botuar, sikurse shumë krijime të tjera të De Martinos, në një fletë fluturuese, që asokohe ishte një nga mjetet më të përshtatshme për të mbërritur gjithkund nëpër Shqipëri, ky përkthim pati një efekt vendimtar gjatë viteve fill pas botimit të *Harpës*, kur një jezuit i ri, ndoshta nxënës i françeskanit arbëresh, vendosi ta ripërpunonte atë tashmë me titullin e ri *Vaji i bylbylit*. Jezuiti i ri ishte Ndre Mjeda, që në vitin 1886 botoi për herë të parë një version të kësaj poezie të shquar, që më pas do të ripërpunohej shumë herë duke nxjerrë kështu në pah prirjen e spikatur filologjike dhe akribinë e veçantë gjuhësore të poetit shkodran. Nuk është vendi këtu rasti të ndalemi te këto aspekte, që do të jenë objekt i një studimi të posaçëm ekdotik kushtuar historisë së shkrimit të *Vajit të bylbylit* – përfitoj nga rasti të falënderoj miken dhe kolegen, profesoreshën Mimoza Priku, për ndihmën që më ka dhënë – por dua vetëm të saktësoj së paku dy pika kyçe: së pari, pa leximin e tekstit të De Martinos vështirë se Mjeda do të kishte arritur pjekurinë konceptuale që shfaqet qartë qysh nga versioni i parë që u botua në përmbledhjen *Shahiri Elierz*; së dyti, pa nxitjen e ngjarjeve të pakëndshme mbi të cilat do të ndalem në vijim, Mjeda, ndoshta as që do t'ia kishte hyrë rishikimeve të thella stilistike dhe gjuhësore që dëshmojnë në materialin e vëllimshëm dorëshkrimor që ruhet në Arkivin e Shtetit në Tiranë (gjej rastin të falënderoj përzemërsisht drejtorin e Arkivit, prof. Ardit Bido, për mbështetjen e tij profesionale). Shtojmë këtu edhe një pikë të tretë, që në fakt përbën pjesën më të vështirë të fluturimit të “dallëndyshes shtegtare”, atë më të pafatën, ose nga një këndvështrim tjetër do të thoshim atë që u shkon për shtat më mirë paudhësive që prodhon hera-herës pushteti.

Së paku qysh nga viti 1879 ngriheshin akuza denigruese ndaj integritetit moral të De Martinos. Ishte fjala më së shumti për shpifje që disa nga sivëllezërit e tij dërguan në Romë dhe që vetë De Martino, pasi u thirr në vitin 1880 për të dhënë shpjegime, i hodhi poshtë si të rreme duke ia atribuuar ato vesit të sivëllezërve të tij «për t'u marrë me thashetheme» e duke pranuar vetëm një akuzë: «se thurte vargje». Gjatë viteve në vijim akuzat u rimorën nga Imzot Pasquale Guerini, nga viti 1887 Arkipeshkv i Shkodrës, dhe u përdorën në mënyrë instrumentale kundër opinionëve politike të De Martinos. Qysh nga viti 1891 De Martino kishte botuar përmes fletëve të zakonshme fluturuese, të shpërndara në mënyrë kapilare në Shkodër dhe rrethina, *Vajin e bylbylit* të Mjedës, madje duke e përkthyer edhe në italishte. Për këtë ishte në dijeni edhe Imzot Guerini, që në vijim u rrek me të gjitha mënyrat të bllokonte veprimtarinë e De Martinos. Edhe Mjeda i ri ishte në dijeni të faktit se poezia e tij e famshme qarkullonte falë përpjekjeve të De Martinos, aq sa e pohon këtë hapur në një letër që i dërgon Gustav Mayer-it më 15 janar 1893, duke u shprehur me ngazëllim se *Vaji i bylbylit* «...u bë shumë popullor në Shkodër, kurse De Martinoja e ka përkthyer italisht, po ende s'e ka botuar».

De Martino, që e vlerësonte shumë ripërpunimin e Mjedës, në fakt e kishte botuar tashmë disa herë përkthimin italisht të *Vajit të bylbylit*: këtë na e thotë në një letër të tij të vitit 1896 pikërisht Imzot Guerini, kur shkruan se *Vaji i bylbylit* ishte «kënduar nga i lartpërmenduri At në kohë të ndryshme nga 1891 në 1896». Ishin me siguri qëndrimet politike të De Martino-s që hasën në kundërvënien e Imzot Guerinit, i cili bëri çmos që françeskani arbëresh, i gjykuar si subjekt i rrezikshëm që kërcënonte qëndrueshmërinë e kishës dhe



të marrëdhënieve të saj ndërkombëtare, të largohej nga Shkodra. Dokumentet që ruhen në Arkivin qendror të Shtetit në Tiranë na lejojnë të rindërtojmë zhvillimin e kësaj ngjarjeje dhe të ofrojmë një interpretim të ri për shkakun e vërtetë të largimit të papritur të De Martinos nga Shqipëria në muajt e parë të vitit 1897. Pikërisht gjatë atij viti, sapo mbërriti në Itali, De Martino shtypi në Bari botimin e parë të veprës *La questione albanese-orientale* (Çështja shqiptaro-lindore), ku përmbloodhi disa krijime poetike satirike të hartuara gjatë viteve 1891-96, pra para se të largohej nga Ballkani, ku shprehej hapur kundër dy fuqive perandorake, Osmane dhe Austriake, interesat e të cilave përplaseshin pikërisht në trojet shqiptare, dhe ku, nga ana tjetër, pohonte faktikisht të drejtat të Shqiptarëve për vetëvendosje kombëtare.

Botimi i parë i këtij vëllimi nuk tërhoqi vëmendjen, a së paku nuk ngjalli polemika të ngjashme me ato që shkaktoi botimi i dytë, që u botua të njëjtin vit 1897 nga e njëjta shtëpi botuese. Ky botim i ri, me titullin e ndryshuar *Poemetto eroico-comico* (Poemë heroiko-komike), përmban dy elemente të reja: së pari, frati arbëresh theksoi qartë vlerën politike të veprës së vet duke dënuar pazaret mes osmanëve dhe austriakëve që parashikonin, në mos copëtimin e trojeve shqiptare, së paku përcaktimin e sferave të influencës mes dy fuqive perandorake, pa pëlqimin e fuqive të tjera europiane. Nga kjo pikëpamje De Martino u rreshtua në krah të politikës së intelektualëve të tjerë arbëreshë, të cilët me nismën e Jeronim De Radës dhe Anselmo Lorecchios pikërisht në shkurt të vitit 1897 kishin organizuar në Ungër “punimet e Kongresit të Dytë Gjuhësor Arbëresh” ku kishin shtruar hapur edhe çështjen e sovranitetit të shqiptarëve kundër pretendimeve ekspansioniste të Austro-Hungarisë. Në këtë kontekst politik, që bashkonte qysh pas pavarësisë italiane edhe intelektualë të tjerë, qoftë italianë si Giosuè Carducci, qoftë arbëreshë si Gavril Dara i Riu dhe Pietro Chiara, u fut edhe De Martino, i cili u rreshtua haptazi në krah të kongresistëve arbëreshë, të cilëve

u kushtoi botimin e dytë të veprës, duke shkaktuar kështu zemërimin e Imzot Pasquale Guerini-t, që me atë rast lëshoi akuza të reja kundër frtit arbëresh. Kësaj here, ndryshe nga akuzat që cenonin integritetin moral të De Martinos, kritikant kundër tij kishin të bënin me përmbajtjen satirike të “poemës heroiko-komike”, që sipas arkipeshkvit komprometonte misionet katolike në Shqipëri. «Sidomos në këngën e tretë», shënonte Guerini, autori del «kundër Turqisë, në territorin e së cilës gjenden këto misione, si edhe kundër Austrisë, mbrojtëses së kultit në Shqipëri dhe mirëbërëses së misionëve dhe të Urdhrit Serafik. Poema pastaj mbaron me një thirrje për Pavarësi!». Guerini së fundi thotë: «Si arbëresh që është le ta mbështetë sa të dojë “Shoqatën e Kombit Shqiptar” që është themeluar në Kalabri (Pallagorio di Catanzaro) e le të përkrahë sa të dojë kongresin gjuhësor arbëresh dhe letërsinë shqipe, mirëpo mund të dëmtojë misionet kur satirizon me përçmim Perandorinë Osmane dhe Austrinë, sepse poezitë e tij mund të bien në duart e të mëdhenjve të të dyja palëve».

Elementi i dytë ka të bëjë me futjen në *shtojcën* e vëllimit të përkthimit italisht të *Vajit të bylbylit* të Ndre Mjedës, çka e acaroi edhe më shumë Imzot Guerinin kundër frtit arbëresh. Në fakt, arkipeshkvi i Shkodrës në letërën e tij denoncuese nuk harroi të theksonte se De Martino kishte “përdorur” për qëllimet e tij «*Vajin e bylbylit*, shkruar shqip nga Andrea Mjedia i shoqërisë së Jezuitëve». Jo vetëm kaq, por De Martino e paskësh botuar përkthimin e tij «pa lejen e poetit shqiptar» dhe «ajo çka është më e rëndë, u përpoq t'i atribuonte poetit shqiptar një këngë simbolike sikur me vajin e bylbylit të aludonte për çlirimin e atdheut». Në mbështetje të interpretimit të tij Imzot Guerini linte të nënkuptohej se edhe Mjeda ishte në një mendje me të. Megjithëse letra e arkipeshkvit nuk na ka mbërritur e plotë, mund të hamendësojmë se do të ketë qenë pikërisht prelati i lartë që e ka shtyrë të mbante qëndrim të riun Mjeda, i cili asokohe ndiqte studimet në Kraljevicë

të Kroacisë me një bursë që i ishte akorduar pikërisht nga Austria. Në fakt, dashur pa dashur Mjeda në datë 25 prill 1897 i dërgoi Imzot Guerinit një letër përulëse. Përveçse kundërshtoi instrumentalizimin që De Martino i kishte bërë poezisë së tij, Mjeda në fakt konfirmoi plotësisht akuzat e Imzot Guerinit, duke deklaruar se «dridhej kur shikonte se si një fetar, duke përdhosur karakterin e vet, jo vetëm e linte veten të binte kaq poshtë në punë kaq të largëta prej zanatit të tij», «por edhe guxonte të fyente me shpoti dhe sharje personazhe të nderuara, e të ngjallte mosbesim ndaj autoriteteve të larta kishtare». Me fjalë të tjera, poeti jezuit i përkrahu kërkesat e eprorit të tij, duke u gjunjëzuar kështu përpara pushtetit hierarkik deri në atë pikë sa të mohonte vlerën e poezisë së vet, të cilën më pas do ta rishikonte e ribotonte disa herë. Kështu Mjeda shkruan: «dhimbja ime u shtua shumë kur pashë të botuar në *Shtojcën* e vëllimit përkthimin e një poezie time shqipe, që, kur isha njëzet vjeçar, e shkrova si ushtrim letrar...». Na vjen të pyesim se sa e vështirë do të ketë qenë për ndërgjegjen e autorit të ri të poezisë së famshme kushtuar lirisë së popujve të mohonte vlerën simbolike dhe ideologjike të një prej krijimeve të veta më të bukura. Me siguri nuk do të ketë qenë e lehtë e me siguri Mjeda nuk mendonte vërtet se poezia e tij ishte thjesht një «ushtrim letrar», përndryshe nuk mund të shpjegohet pse më pas ai iu kthye disa herë tekstit të *Vajit të bylbylit*, duke na e lënë neve nderin dhe detyrën të rindërtojmë fazat e ndryshme të historisë së shkrimit të kësaj poezie.

Pjesa e fundit e fluturimit të dallëndyshes zhvillohet në muzgun e jetës së De Martinos. I tërhequr në kuvendin françeskan të Sarnos, frati arbëresh për një çerek shekulli do ta vijonte betejën e tij ideale në të mirë të çështjes shqiptare. Poezitë e tij, të shtypura sipas praktikës së kohës në fletë fluturuese, patën sukses të madh dhe sidomos qarkulluan në mjediset letrare më të rafinuara të Italisë. Disa prej tyre i kemi gjetur në bibliotekën private të Giosuè Carducci-t, me të cilin De Martino kishte lidhur një marrëdhënie miqësore, pasi i bashkonin, veç të tjerash, qëndrimet kundër politikës së Austrisë. Të tjera poezi i kemi gjetur në bibliotekën e kuvendit françeskan në Vigna di Venezia, ku frati arbëresh ishte i mikpritur dhe shkonte shpesh. Të tjera poezi i ka gjetur miku dhe kolegu Francesco Altimari, të cilin e falënderoj që m'i vuri në dispozicion, në bibliotekën e kuvendit të Sarnos, ku De Martino kaloi vitet e turbullta të shekullit të ri, duke shprehur gjithherë hapur pikëpamjet e veta prej intelektualit të lirë dhe fetari të devotshëm. Pikërisht në Sarno, në vitin 1923, përfundoi fluturimi i mundimshëm i dallëndyshes, duke na e lënë neve sot detyrën të rindërtojmë andrallat e jetës dhe sidomos të lidhim fillin e këputur të së vërtetës historike që ka mbetur e fshehur mes skutave të pluhurosura të arkivave dhe indiferencës së studiuesve.

Ndërkaq njërin skaj të atij filli të këputur e kemi gjetur te konstatimet largpamëse që Filip Fishta botoi në revistën *Shkëndija* në vitin 1940: «Nji nga dishiret kryesore qi e ka përcjellë [De Martinon] gjatë veprimit letrar e politik, ka qenë: Pavarësija e Shqipnis. Ai dritën e vëndit t'onë e lirin e tij e ka parapa nepër mjet rrugës së dijes». Të ritheksosh sot pas njëqind vjetësh se Leonardo De Martino ishte një promovues i madh i Rilindjes “së re” arbëresho-shqiptare dhe një nga frymëzuesit kryesorë të letërsisë bashkokohore shqiptare, mund të tingëllojë si e mirëqenë, madje banale. Në fakt, t'i përfshish këto merita në kontekstin historiko-politik kompleks të kohës, t'i vlerësosh ato në kuadrin e zgjedhjeve idealiste të një françeskani që vinte nga bota arbëreshe e Italisë së Jugut dhe, së fundi, t'i vendosësh ato në perspektivën e një analize të përshtatshme kritiko-letrare, kërkon një përpjekje hemeneutike të vështirë dhe të guximshme. Por këtë ia kemi borxh qoftë kujtimit të Leonardo De Martino-s, qoftë franceskanëve shqiptarë, të cilët janë rreshtuar gjithmonë historikisht në anën më të përparuar të procesit të emancipimit kulturor dhe kombëtar të shqiptarëve.

Ismail Kadare, një nga figurat më të rëndësishme të Letërsisë Shqipe, ka lindur në vitin 1936 në qytetin e Gjirokastrës, i njohur në turqisht si Ergiri Kasrı, në kufirin jugor të Shqipërisë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, ai dëshmoi pushtimet e qytetit nga forcat italiane, greke dhe naziste, si dhe lëvizjet popullore kundër këtyre forcave pushtuese. Pas pushtimeve dhe luftërave për pavarësi, Shqipëria u qeveris nga një regjim i ri nën udhëheqjen e Enver Hoxhës, i cili ndoqi politika të përqendruara fillimisht në Moskë dhe më vonë në Pekin. Ky regjim i ri, i cili do të zgjaste afërsisht 45 vjet, bëri që shoqëria shqiptare të përjetonte një “klimë të ashpër” që nga fillimi i tij deri në vdekjen e Enver Hoxhës. Mjedisi i luftës deri në vendosjen e regjimit të ri dhe qeverisja e Enver Hoxhës, shfaqen si periudhat më të rëndësishme që prekën fëmijërinë dhe rininë e Ismail Kadaresë.

Ismail Kadare u dërgua në Bashkimin Sovjetik në vitin 1958, si shumë bashkëmoshatarë të tij, për t'u shkolluar për t'u bërë shkrimtar socialist dhe për të ndërtuar Shqipërinë së bashku me ekonomistë, teologë dhe administratorë të tjerë. Për Kadarenë, atmosfera politike që hasi në Moskë ishte shumë e ndryshme nga regjimi që përjetoi në Shqipëri dhe ai pati mundësinë të mësonte letërsinë bashkëkohore perëndimore, të cilën ndoshta nuk do ta kishte pasur kurrë mundësinë ta lexonte nëse do të kishte qëndruar në Shqipëri. Pas këtij procesi, Kadare u kthye në Shqipëri dhe filloi t'i transferonte idetë e tij në letërsi me poezitë dhe romanet që filloi të shkruante. Prandaj, dashuria e tij për leximin që në fëmijëri dhe interesimi për ngjarjet që ndodhin rreth tij, u përzien me edukimin që mori në rininë e tij dhe u transferuan në një identitet letrar.

Ai u përpoq t'i pasqyroste lexuesit të gjitha ngjarjet që përjetoi gjatë gjithë jetës së tij përmes personazheve të ndryshëm në pothuajse çdo vepër të tij. Shumë prej veprave të Ismail Kadaresë, i cili botoi më shumë se tetëdhjetë vepra, kanë tërhequr vëmendjen mbarëbotërore. Këto vepra kanë një rëndësi të madhe, veçanërisht në drejtim të njohjes së Shqipërisë dhe shoqërisë shqiptare në botë. Ai ka kaluar nëpër shumë faza të trazura që nga lindja e tij e deri më sot, dhe pothuajse në të gjitha veprat që ka shkruar, ka përshkruar të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen e shoqërisë shqiptare me ligjërimet e tij unike, herë të nënkuptuar e herë hapur.

Hapat e parë në letërsi Ismail Kadare i hodhi me librin e tij të parë me poezi Frymëzime djaloshare, të cilin e shkroi në vitin 1954. Që nga momenti kur ai filloi të shkruajë, veprat e Kadaresë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në letërsinë shqipe. Vlerat që veprat e tij i dhanë letërsisë shqipe janë të dukshme në shumë mënyra. Një nga këto vlera është se, falë veprave të autorit, Letërsia Shqipe pushon së qeni një letërsi që vazhdimisht “merr” nga letërsitë e tjera dhe bëhet një letërsi që “i jep” atyre letërsive. Prandaj mund të thuhet se shkrimet e tij shërbyen si urë lidhëse midis Letërsisë Shqipe dhe Letërsisë Evropiane. Veprat e Ismail Kadaresë zënë një vend të rëndësishëm në zhvillimin e Letërsisë Shqipe dhe hapjen e saj me botën. Romani i Kadaresë, i cili është vepra më e përkthyer në gjuhë të huaja deri më sot, është Gjenerali i ushtrisë së vdekur. Turqishtja është ndër gjuhët në

Efektet e faktorit ndërgjuhësor në përkthimin e veprës “Rrethimi” (Kështjella) në turqisht të Kadaresë

Nga Ece Dillioğlu

të cilat është përkthyer ky roman dhe brenda një viti është përkthyer pothuajse në të gjitha gjuhët e Evropës Perëndimore. Aktualisht Kadare ka dymbëdhjetë romane të përkthyer në turqisht. Katër nga këto romane të cilat janë; Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur, Kronikë në Gur, Darka e Gabuar dhe Piramida janë përkthyer nga gjuha orgjinale (shqip) në turqisht. Këtë hap në Turqi e ka hedhur Shtëpia Botuese KETEBE e cila ka për qëllim të krijojë bibliotekën ballkanike. Ndërsa romanet e tjera janë përkthyer nga gjuhët anglisht ose frëngjisht.

Në këtë pikë, është e nevojshme të dimë efektet e përkthimit dhe të përkthimit ndërgjuhësor. Siç dihet përkthimi është

përcaktuar në mënyra të ndryshme gjatë historisë. Këto përkufizime janë të përqendruara kryesisht në kontekstet e gjuhës, kulturës dhe komunikimit. Përkthimi; është transferimi i informacionit nga një gjuhë në tjetrën në mënyrë të përshtatshme dhe harmonike, qoftë me shkrim apo verbale. Gjatë kryerjes së këtij transferimi, elementët e gjuhës burimore duhet të përshtaten me gjuhën e synuar. Sepse përkthimi është një fenomen komunikimi që ndodh në mënyrë të përshtatshme jo vetëm midis dy gjuhëve, por edhe midis dy kulturave. Personi që ofron këtë komunikim është përkthyesi. Përkthyesi përdor fjalorin e tij gjatë aktit të përkthimit dhe




bën përkthimin e tij sipas rregullave gramatikore, dhe përkthyesi përkthen duke marrë parasysh kulturën gjatë aktit të përkthimit.

Ndërsa kur shikojmë të kaluarën, mund të shihet se përkthimi nga ndërgjuhët ka një rol historik në transferimin ndërmjet kulturave të largëta dhe pranimin e klasikëve botërorë. Dihet se kur teksti burimor nuk është më i aksesueshëm ose nuk mund të gjendet një përkthyes që e njeh gjuhën burimore, përdoret përkthimi ndërgjuhësor dhe në këtë mënyrë bëhet shkëmbimi letrar. Megjithatë, përveç rolit të tij të rëndësishëm në të kaluarën dhe përdorimit të gjerë sot, përkthimi ndërgjuhësor duket se ka një konotacion negativ në fushën e studimeve të përkthimit. Kur vjen puna përse bëhet përkthimi nga një gjuhë e ndërmjetme, e cila shpesh konsiderohet si një lloj përkthimi problematik, ka arsye të ndryshme. Kërkesa e shtëpive botuese që t'ia japin punën përkthyesit me të cilin punojnë, në vend që të përpigjen të gjejnë një përkthyes që di gjuhën e librit që duan të përkthejnë, ndonjëherë që një përkthyes pëlqen një libër dhe dëshiron ta përkthejë librin dhe t'ia prezantojë lexuesit edhe pse nuk e njeh gjuhën origjinale, sidomos kur bëhet fjalë për përkthimin nga një gjuhë që ka një zonë të ngushtë sovraniteti ose nuk është në një pozicion qendror, fakti që nuk ka njeri që të përkthejë në gjuhën përkatëse dhe që shtëpitë botuese nuk kanë hyrë ende në institucionalizimin mund të të llogaritet ndër këto arsye. Ajo që përgjithësisht konsiderohet e pranueshme në kontekstin e përkthimit të një teksti nëpërmjet një gjuhe ndërgjuhësore është se teksti origjinal nuk është më i aksesueshëm ose teksti origjinal është dëmtuar.

Në këtë aspekt dëshiroj të tregoj dy shembuj nga romani “Rrethimi” të Ismail Kadaresë. Romani u përkthye në turqisht nga Hasan Kaya në vitin 2011. Ky përkthim nuk është përkthyer nga burimi kryesor shqipja por nga frëngjishtja.

Shembulli 1:

Citim nga vepra origjinale: “Duke i ndarë nga doket e tyre barbare e duke u dhënë zakonet tona madhështore, ne do t'ua çyshtim shpirtrat, vazhdonte shehu. Dhe pas shpirtit do t'i vijë radha trupit të tyre.”



Përkthimi ynë: “Barbarca geleneklerinden ayırıp bizim muhteşem geleneklerimizi vererek, ruhlarını arındıracağız, diye devam ediyordu şeyh. Ve ruhlarından sonra sıra bedenlerine gelecek.”

Përkthimi i Hasan Kaya: “Onları barbarca geleneklerinden arındırıp üzerlerine muhteşem elbiselerimizi geçirerek ruhlarını kötü yoldan kurtaracağız ki o yol bedenlerinin gittiği yoldur...”

Kur vlerësojmë përkthimet e kapitullit, shohim se të dyja përkthimet ndryshojnë nga njëri-tjetri për nga forma. Një nga arsyet për këtë është se përkthyesi i pasqyron dy fjali në tekstin burimor si një fjali gjatë përkthimit, ndërsa ne i përkthejmë në dy fjali, si në tekstin burimor, me një metodë të përkthimit fjalë për fjalë. Kur bëjmë një vlerësim tjetër, kuptojmë se përkthyesi ka bërë një përkthim të shkurtuar nga shprehja “vazhdonte shehu”, e cila është në tekstin burimor, por nuk është përfshirë në përkthim. Veç kësaj, fakti që përkthyesi e ka dhënë shprehjen “duke u dhënë zakonet tona” si “duke u dhënë rrobat”, ka bërë që kuptimi të ndryshojë për sa i përket tekstit burimor.

Shembulli 2:

Citim nga vepra origjinale: “I dogjëm trupat e të vvarëve dhe hirin e vendosëm në hinore e ato i fshehëm thellë nën tokë që, sido që të ndodhë, të mos mund t'i gjejnë dot e t'i përdhosin, siç e kanë zakon.”

Përkthimi ynë: “Ölülerimizin bedenlerini yaktık ve kül kaplarına koyduk ve her ne olursa olsun onları bulamasınlar ve hep yaptıkları gibi saygısızlık edemesinler diye toprakta derine sakladık.”

Përkthimi i Hasan Kaya: “Yanarak ölen adamlarımızın küllerini toplayıp kül kaplarına koyarak derinlere gömdük, böylece ne olursa olsun düşmanlarımız onları bulup, her zaman yaptıkları gibi, ölülerimize saygısızlık edemeyecekler.”

Kur vlerësojmë përkthimet e këtij seksioni, shohim se përkthyesi ka bërë përkthim kuptimor. Megjithatë, mund të thuhet se një ngatërrim kuptimor ka lindur për faktin se shprehja “i dogjëm trupat e të vvarëve” në tekstin burimor është përfshirë në përkthimin e përkthyesit me shprehjen “Burrat tanë që vdiqën duke u djegur”.

Kur shqyrtuam të gjithë veprën, sipas rezultateve që morëm nga vlerësimet e përkthimit, konstatuam se përkthyesi turk është munduar t'i zbuste tekstet që përcillte në kuptimin semantik. Megjithatë, duhet të theksojmë se qëllimi i krahasimit të përkthimeve tona nuk është zbulimi i gabimeve. Sepse në këto krahasime të përkthimit rëndësi të madhe ka edhe vepra e përdorur në gjuhën e ndërmjetme. Ne u përpoqëm vetëm të zbulonim kuptimin që donte të përcillte vepra burimore, pa u ndikuar nga asgjë, jo nga këndvështrimi turk apo shqiptar, por si dikush që u rrit në mes të të dyja kulturave, plotësisht objektivisht.

Romani “Kronikat e mjegullës” i Bashkim Hoxhës, Onufri 2019

HISTORI TË SAJUARA QË FSHIJNË TË VËRTETËN

Nga Kosta Nake

Romancieri Bashkim Hoxha jo vetëm ka perfeksionuar teknikat e strukturimit të veprës, por të befason me shtigjet e zgjedhura të subjektit për ta çuar lexuesin te bërthama që përmban dhe përcjell mesazhe. Fillon si një histori e rëndomtë provinciale ku telat e shpirtit i drithëron vetëm seksi, dhuna dhe hajnia. “Këtu vetëm aktet trimërore që lidhen me vdekjen, sido që të jetë ajo, i japin rëndesë emrit dhe jetës. Pjesa tjetër e jetës quhet e shpëlarë e pa ngjyrë. Sapo në mes hyn vdekja, ndizen dritat e spektaklit me vlerë. Vdekja u jep tjetër nur të gjitha veprimeve.” (f.42)

Befas stërkalat e ngjarjeve që bëjnë historinë kombëtare, arrijnë deri atje. Flamuri kuq e zi, pasi është ngritur në Vlorë për të shpalosur pavarësinë, si në një stafetë sportive fillon e kërkon lartësi të tjera anë e kënd trojeve shqiptare. Po një akt i rastësishëm dhe krejt i zakonshëm i së shkuarës, në një çast kohor të së ardhmes, pasi injektohet politikë dhe interesa, fillon e vishet me një rrobë të mëndafshhtë; grushti i njerëzve që u ndodhën në një banesë ku nuk dihej se ç'përfaqësonte ai flamur, fillon e mbushet pas vakti me njerëz që e kthejnë në miting, madje dikush që nuk ka qenë fare, mëton të kthehet në organizator të eventit për të marrë grada e dekorata.

Bërthama e romanit fillon pikërisht këtu, pas qytetit pa identitet dhe pas një individi që përjer nga karakteristikat fizike, mendja na shkon menjëherë te qytete të njohura dhe figura historike që kanë shënuar ose devijuar rrugën e mundimshme të Shqipërisë. Në tragat e shumta të jetës shpesh ka ose kërkohet pak fat. Autori ndalet për një trajtesë filozofike rreth tij, kur fut

në faqet e veprës edhe antagonizmin Ferdinand – Lis, të dy djem të Azis beut të ardhur nga martesat të ndryshme. Bëmë me fat dhe hidhmë në ferrë, thotë një fjalë e urtë e popullit dhe ilustrimi i saj realizohet me Azis beun 24-vjeçar të cilit një vajzë 16-vjeçare, e mbetur pa nënë, shkon dhe ia dorëzon virgjërinë pa ia kërkuar. Ai ngrihet nga vulgariteti i mjedisit dhe synon të hartojë dekalogun e shqiptarit. “Edhe pse kishte qëndruar larg historisë, ajo e kishte ndjekur pas dhe e kishte përfshirë edhe atë në një ngjarje historike, duke i ardhur drejt e në shtëpi.” (f.70)

Kjo pikë takimi me historinë hap udhë për pika të tjera kontakti me austriaken Gertrudë, me figura historike të njohura si Faik Konica, at Gjergj Fishta dhe mbreti Ahmet Zogu, të kuptojë interesat e fuqive europiane ndaj Shqipërisë, si përplasje e cepave “të gjithë pllakave të mundshme të qytetërimeve që sjellin tërmete.” (f.87) Ndryshe nga politikanët që prodhoi tranzicioni Azis beu “nuk erdhi në politikë për të bërë para, paratë i kishte, erdhi në politikë se e kërkoi jeta.” (f.112)

Një prej karaktereve të tjerë të romanit, Misto N., në pragun e 25-vjetorit të shpalljes së pavarësisë, merr një ftesë nga Mbreti që i kërkon të punojë si historian për ta ndriçuar ngjarjen e madhe. Po atë që nuk e thotë Mbreti, e thotë oborri mbretëror: historia duhet shkruar që projektorët të ndriçojnë figurën e Mbretit dhe pikërisht kjo është kuintesenca e veprës. Misto N. dhe Ferdinandi, djali i Azis beut, zbresin në terren të qëmtojnë të vërtetat e ngjarjes dhe bien në rrymën e përpjekjeve për manipulimin e saj. “Është e mundimshme ta shkruash realisht historinë... Po mundimi

bëhet më i madh kur duhet ta bësh këtë me porosi.” (f.96-97)

Autori beson se më shumë se të shkuarës, historia e i përket së sotmes, ajo shkruhet për t'i shërbyer qeverisë në pushtet dhe qeveritarëve të saj që detyrimisht duhet të dalin se kanë qenë pararendës, largpamës, heronj. Ky manipulim është i mundshëm, sepse çdo vit largimi nga ngjarja shton mjegullën që endet mbi të, vështirimi mbi pjesëmarrësit vështirësohet dhe kushdo mund të pretendojë se ka qenë faktor. Kështu ndodh me Harunin që është bërë prefekt dhe rrjedhimisht i takon të jetë në qendër të ngjarjeve të ndritura të së shkuarës. Grotesku mbërrin deri te kryerja e një akti trimërie, vrasja e Masarit, të cilin të gjithë e njihnin si memec, por na dalka se paska qenë agjent i rusëve. Mistoja thotë: “Shqiptarët i ngjiten historisë pasi ajo ka ndodhur. Kur ajo ka mbaruar, përpiqen ta vendosin veten si pjesë të saj...” (f.147) Dhe më tej: “Historia është e mbushur vetëm me korrigjime.” (f.159) Vepra ka vlera të veçanta sepse kapërcen me shpejtësi periudha të ndryshme historike për të ilustruar atë gjë që përsëritet duke e shtrembëruar ose duke e fshirë tërësisht të shkuarën, aq sa mund të themi se nuk kemi një fill të pashkëputur të historisë sonë - nuk kanë dashur fitimtarët e përkohshëm. Mjafton të kujtojmë atë që bëri Enver Hoxha me paraardhësin e vet Ahmet Zogun: jo vetëm çdo gjë që bëri Mbreti, u nxi, jo vetëm që gjithë sukseset e socializmit shkëlqenin duke i krahasuar me vitin 1938, por edhe ndaloi paraqitjen e portretit të tij në tekstet e historisë. Me të njëjtin zell punoi edhe Sali Berisha për ta errësuar socializmin e Enver Hoxhës dhe për vite të tëra mohimi arriti deri te mospërmendja e emrit të diktatorit. Me të njëjtin zell Edi Rama kërkon ta largojë Sali Berishën nga skena politike. Të gjithë kanë vepruar sipas formulimit që bën në fund regjisori sovjetik Andrei Sokolov: “Fitimtari i merr të gjitha.” (f.218)

Për ironi të fatit, Ferdinandi shkon të mbledhë historinë ku i ati duhej të ishte heroi i pavarësisë në atë cep të vendit dhe zbulon se më mirë se heroin, i ati kishte bërë hamshorin.

Rrota e historisë bën që disa t'i ngrerë lart e pastaj t'i hedhë poshtë. Hëna, karakteri kryesor i veprës, ndjek një kah të kundërt lëvizjeje, nga poshtë lart dhe brenda fatit të vet gjen edhe thërime lumturie që mund t'i sjellë vetëm dashuria dhe sërisht kemi një meditim poetik rreth saj. Në kasollen e saj te Shpella e Kuçedrës gjatë viteve të luftës kishte bujtur Enver Hoxha me Shtabin e Përgjithshëm dhe pas glirimit ai e ngriti figurën e saj si nënë të dy dëshmorëve, madje u zgjodh edhe kryetare e keshillit.

Mjaft interesant është vëzhgimi për ëndërrimtarët dhe rrëmbimtarët pasi largohet armiku i jashtëm. “Ne ëndërrimtarët nuk jemi si ata. Ata janë të shkathët, përfitojnë nga rasti dhe zënë vendet. Kur shkon ti, vendet janë zënë nga ata, që bëjnë para si më parë dhe realizojnë ëndrrën tonë, sepse vetë ata nuk kanë asnjë ëndërr.” (f.164) Një kategori më vete shoqërore dhe estetike përbëjnë sarhoshët që frekuentojnë mejhanen e Luc Demës e cila ndërron emrin sa herë ndryshojnë rrethanat politike.

Linja që i qëndron të vërtetës është ajo raportit Azis – Hëna, një çift të rinjsh i bashkuar rastësisht që ndjekin rrugë të ndryshme në jetë: njëri me partizanët, tjetri me nacionalistët. Azis beu vdiq në kampin e kënetës së Maliqit, djali i tij Ferdinandi u largua nga Shqipëria me ushtrinë gjermane.

Poeti persian Shams Tabrizi ka thënë: “E kaluara është një mjegull në mendjet tona. Po e ardhmja? Krejt ëndërr. Ne nuk mund ta marrim me mend të ardhmen, as nuk mund ta ndryshojmë të shkuarën.” Por atëherë poeti nuk kishte njohur se si manovron politika e ditës me të shkuarën dhe ndoshta ishte i ndrydhur nga errësira e saj, ndoshta nuk e kishte zbuluar atë zonën gri ku ndahet realja me irealen, e vërteta me manipulimin. Nënvizimi i fundit i autorit që punon deri në fund me metaforën e mjegullës është zhgënjimi i regjisorit rus që vjen në Shqipëri me shpresën se do gjejë diçka jashtë klisheve të realizmit socialist, por zbulon se e njëjta mjegull që mbulonte të vërtetat dhe i deformonte në mënyrë banale kishte mbërritur nga Bashkimi Sovjetik deri në Shqipëri, sepse “marrëzia shtrihet si mjegulla dhe mbulon gjithçka, bëhet globale.” (f.222)

Bilisht, 16 – 18 nëntor 2023



“Ha, re Ndonkë, ça bane? Qysh a Flutra (time shoqe dhe mua na kishte pasur student). Si a Nasho? Pastaj i merrte të gjithë me radhë. Pyeste për të afërmit e mi dhe miq; për si tim ungj, shkrimtarin Sotir Andoni, Teodor Laço, për ta farë e fis dhe pastaj, si tundte paksa belin me duart e futur në xhepa, shtonte me një ngazël-lim plot dritë, duke ndjellë hundët gazplotë;

-Ke ba ndonjë trimni, ke ba!

Ky ishte Musa Vyshka. Që u nda nga kjo jetë për të shkuar në amëshim.

Njeriu i mirë dhe i paqtë, poeti lirik që nuk pushoi kurrë së dashuruari poezinë e jetës, lirizmin, i lidhur me mijëra fije me vendlindjen e tij Elbasanin, që nga librin i parë “Ne 20 vjeçarët”, dhe deri tek libri me poezi të zgjedhura, botimet M & B, 2019;

Tregimtari i pasionuar dhe shkrimtari i dashur për fëmijët me 20 libra për ta, të botuar me vjersha e tregime që nga poema “Pranë vëllezërve” (1968) dhe deri në 2014, me “Cila stinë është më e bukur”.

Një baba i dhembshur, që e lavdëronte doktorin (Gentini) dhe brenda vetes kishte më shumë se një krenari, por që asnjëherë nuk mund t’ia merrje për mburrje... Me ato gjestet e duarve të tij të mëdha...

-Jo, jo, Genti, a ndryshe.. A shkencëtar! A studiues i veçantë.. ka ngja nga Shkodra e Zamputëve, dhe atëkohë sytë i merrnin një përshkënditje plor dritë.

Oh sa shumë dashuri që kishte për fëmijët. Gjergjin e pat pikë të dobët, pasi thoshte se sporti dhe gazeta “A kot, o qyq! S’ka pare...”

I rregullt deri në skurpulozitet ndaj familjes, orareve, gjendjeve, pazareve, shkollave të mbesës dhe nipit.

Për vajzën e Gentit dhe të Erjonës, nxënëse dhe studente me medajle ari, ishte më shumë se i lumtur. Atë botë, edhe dy çunat nuk i hynin më në sy. A thua se edhe ai vetë si gjysh, kishte mbjellë brenda tyre nervin e leximit, po se po, por dhe të edukatës së jetës dhe vlerën e bukurisë së shpirti njerëzor.

Ishte një antikonformist i thekur në jetë dhe në raport me të tjerët.

-Mund të isha edhe deputet, zëvendës ministër, ministër...por nuk i pëlqente fort të kishte mbi fyt lak prej të tillë formati.

Mbaj mend, që teksa ngjiste shkallët, deri para disa vitesh, në një kafe të vogël tek rruga e Elbasanti, jo fort larg na shtëpia e tij përballë shkollës Kushtrimi i Lirisë,

In Memoriam

Pasuritë e mëdha të Musa Vyshkës: poezia dhe miqtë!

Nga Andon Andoni



për të pirë një kafe me kolegët –miq; Vath Korreshin, Teodorin, Bari Myftarin, Koci Petritin, Fisnik Sinën, sipas rastit, do shpotiste me atë zërin e tij përtej ironisë.

-Ha re, e batë mëmëdheun? Se ju jeni burrat e kom-bit...

Pasuria e tij më e madhe, dukej se ishin miqtë e mirë e të vërtetë. I lidhur me breza të tërë studentësh, vargani i tyre shkonte nga sa nga Lenia, në Tushemisht, në Shpat e Myzeqe, ne të gjithë Shqipërinë.

“Tek miqtë me kolltukë s’shkoj të ulem/
E para tyre kurrë në gjunjë s’ bije
Po si s’u bëra mbarë të çoj lule/
Tek varri i Gani Biciti në Lenije
Në Rrajcë më ka ftuar Mehmet Hoxha
Kiço më prët në Tushemisht përditë
Po ç’dreqin kam që s’më del koha kurrë!
Të shtroj edhe ta ndaj dhimbjen me miqtë
Në Shpat e Myzeqe kam lënë çelur
Ca dyer që më presin ditë e natë
O miq do vij tek ju gjallë apo vdekur
Do vij si Konstandini në baladë.

Dhe me të vërtetë ai është mes njerëzve, miqve dhe lexuesit të tij të dashur, edhe pse nga sot do mungojë fizikisht.

Si poet kishte një lloj egoje kaq të bukur dhe të vlerë, përballë kolegësh sa që, herë- herë fajin do t’ia hidhte jo Milanov Kallupit si poet (por botimit që i kishte bërë librit, “Kush je ti moter”, tregime 2004.

Dhe pastaj siç e kishte gjithmonë atë të folurën e tij brilante, shtonte po në sy të tij.

-Ky a gamor! hahahaha. Qysh ore ma bane atë libër për ibret...! Nuk i zemërohej askush.

Edhe ne të folurën e tij kishte lirizëm.

Lirizmi i tij ishte i brishtë dhe plot ngjyime,, që nga e kuqja e ndezur e dashurisë dhe deri tek portokallia dhe grija e pleqve.

Ajo që mbeti e dallueshme deri në fund të jetës se tij krijuese, ishte se poezia mbeti meditative, e sinqertë e hapur dhe progresiste ne raport me të shkuarën e tij krijuese. Me një njëtrajshmëri, në kadencat e vjershërimit, për të mos thënë edhe se u rrit artistikisht dhe estetikisht më shumë në vitet pas 90, krahasuar me librin “Ne njëzetvjeçarët” (1969) dhe libri i fundit “Mos e kthe kokën pas”. 2014

Sipas Dritëro Agollit, “prushi i rinisë së parë, erdhi dhe u bë një zjarr, tjetër i madh pas shumë vjetësh, mes prushërimit dhe flakës së të cilit sot në këtë ditë dhimbje ai do mbetet gjithmonë tek lexuesi.

E vija re që i dhimbet mëmëdheu. Një poet si ai e kishte të ravijëzuar brenda gjakut dhe shpirtit. Mëmëdheu i tij fillonte që aty në Elbasanin e portokalltave dhe kumrisë zë kuitëse. Që nga Fushëmreti, në sokakët e kall-drëmtë të Kalasë, tek Spaikoria dhe deri tek brezi i parë i ullishtave mbi Universitet, ku punoi si pedagog për vite të tëra me radhë.

“Dhe kur të bije në ç’ varr të dheut

Do hedh së fundi sytë, larg atje.

Të shoh në qan apo hesht mëmëdheu.

Tani që mua shtrirë po më sheh.”

Një burrë me sqimën e një dashurie ndaj, mikes, shoqes, redaktore dhe nënës së fëmijëve të tyre, Marien, e kishte më shumë se sa kaq. Zonjë dhe Shenjt. Kushdo që i njihte kishte një konsideratë të veçantë për këtë binom zamput-vyshka.

E prerë, pedante, skurpuloze; të përkthyer deri në ambicje.

“Ti fundi je i pritjes që ska fund.

Je prehje e shqetësimit që s’shqetësohet.

Sapo të shoh mërzia krahët shkund

Trishtimi i trishtuar larg largohet.

Aq shumë të dashkam sa as vetë se di

O dashuri. O dritë e kësaj bote.

Sa herë dal, në pasqyrë, për çudi

Veten kërkoj, më del fytyra jote.”

Në takimin që patëm, më 2019, teksa më dhuronte librin me poezi të zgjedhura, kishte një gëzim gati fëmijëror, për aq sa kishte lënë mbi këtë truall, gjatë tërë jetës së tij si poet, shkrimtar dhe njeri i dijes, arsimit dhe le-trave;

-Ma bënë surprizë Eriona dhe Genti... Nuk di c’të them. Ma, nuk shkruaj dot më të bukura se këto...ja lex-oje, lexojë këtë për pleqtë. Po na vjen virania vdekje, po na vjen...

Dhe si për çdo vdekatar, erdhi sot në mëngjes, më 14 të dhjetorit 2023, me kosën e saj të zezë dhe e mori në parajsë Musa Vyshkën.. poetin e shqetësimeve njerëzore, njeriun e dashur dhe gojëmbël me të gjithë, të diturin, të urtin, babain e dashur, birin e Elbasanit mes ullinjve të paqtë dhe portokallave e limonave të artë. Në paqe qofsh poeti im, Musa Vyshka.



Grafikë nga Ylli Haruni

Leximi i romanit “Pilisama selfie” të Zija Çelës më dha kënaqësi estetike, mesazhe të rëndësishme dhe gjurmë të pashlyeshme në kujtesë.

Që në rreshtat e faqet e para të librit, lexuesi i vëmendshëm e kupton se kemi të bëjmë me një roman distopik. Sipas definicionit në “Fjalorin e Oksfordit”, distopia është “vend ose gjendje imagjinare ku gjithçka shkon aq keq sa nuk ka më”. Zakonisht, autorët që shkruajnë vepra distopike ngjarjet i vendosin në të ardhmen ose edhe në të tashmen dhe me anë të tyre i ironizojnë shoqëritë dhe klimat politike dhe sociale. Shoqëria shqiptare në tranzicion është truell i përshtatshëm dhe frymëzues për të krijuar letërsi distopike.

Duke filluar nga titulli e deri në faqen e fundit, Zija Çela ka krijuar një karusel personazhesh, toponimesh e ngjarjesh, ku secili prej nesh, duke përfshirë të gjitha nivelet, gjen patjetër diçka nga vetja. Njeriu bashkëkohor, shqiptari i ditëve tona, tipologjia e secilës gjini e moshë reflektohet me të metat e veset e qenësishme. I pajisur me një përvojë të gjatë jetësore dhe një karrierë të shkëlqyer letrare, autori ka krijuar gjithashtu një toponomastikë satirike me një stil që të bën të qeshësh dhe të vajtosh njëkohësisht. Në këtë parodi të duket sikur askush nuk i shpëton fshikullimit. Tendencat e krijimit të karaktereve dhe toponimeve distopike janë vërejtur edhe në krijimet romanore të mëparshme të autorit, bie fjala, në dy romanet paraardhëse, “Banka e Ankesave” dhe “Lavjerrësi i qytetit”. Është në natyrën e Zija Çelës që duke parë nga afër, në të vërtetë sheh larg dhe jep në kohë ca paralajmërime alarmi. Te “Pilisama selfie” ato mbërrijnë kulmin. Me kaq realizëm janë përshkruar ngjarjet, kaq besueshëm irealja është shndërruar në reale, sa lexuesit as që i shkon ndër mend se po lexon fikcion. Në çdo faqe të librit vërehet satira deri në sarkazëm, por e përjetuar në mënyrën origjinale të Zija Çelës: ku ka satirë, ka dramë dhe ku ka dramë, ka gjithashtu qortim e dhembje. Romani, siç pritët nga mjeshtri, është shkruar me stil që rrjedh, gjuhë të pasur e plot kolorit, zhvillim shkallë-shkallë të konfliktit, çka e mban gjallë tërheqjen e leximit, si dhe me erudicion që të mrekullon.

Ngjarja zhvillohet rreth një treni (magjik në iluzionin e pilisamëve) që, sipas një projekti nga Brukseli, duhet të përfshijë një rrjet hekurudhor mes pesë qyteteve. Dhe pilisamët, në vend t'i hyjnë punës, nisin debatin se çfarë do të sjellë ky magjiku, por edhe çfarë do të marrë nga qyteti i tyre. Vjen apo s'vjen treni aty, dua ta anashkaloj këtë, sepse ju mbetet ta lexoni vetë.

Gama e gjerë e personazheve fillon me Viktor Frankurtin, kryetarin ose kryeparin e bashkisë së Pilisamës, njeri gjithë komplekse, personifikim i politikanit që ka për qëllim të mbetet në karrigen e pushtetit me çdo kusht. Vazhdon pastaj me Gerhard Hirsonin, përfaqësuesin e Brukselit, Klaus Kolerbahun që udhëheq një institucion po ashtu distopik (Agjencinë Botërore të Kohës), me Leandro Doçin, Qenan Qafalinë, bashkëshorten e Viktorit,

Refleksion për romanin e Zija Çelës “Pilisama selfie”, “Onufri”

PARODIA DISTOPIKE E TRENIT MAGJIK

Nga Aziz Mustafa

gazetarin televiziv Natan Brashova, hetuesin Mirel Krifca, drejtorin e bibliotekës Pandush Adura, Harun Cerunin - biznesmenin e paskrupullt, Ylber Dautin që shkruan një Poemë me sonete për të gjithë këta personazhe, etj etj. Një gamë e tërë personazh që ndër veprojnë duke u dashur a duke u urryer, duke punuar apo duke bërë gallatë, duke vjedhur a mashtruar, duke parë ëndrra në diell e duke u marrë me thashetheme, madje edhe duke u vrarë me njëri-tjetrin për një fjalë goje. Por, prej të gjitha veprimtarive, më e dendura është ajo e hedhjes së shortit për numërtimin e banorëve në listën e pranisë. Ç' numër do të ketë emri im, ç' domethënie ka ky numër, ndjell mbarësi apo ters, cili është emri që gjendet mbi mua dhe cili nën mua, është i denjë ky fqinjë të qëndrojnë përkrah meje?, pyesin veten pilisamët. Këto shqetësime sikur ua tymosin kokën, duke i çuar në shpërqëndrim dhe shpërdorim mizor të kohës. E si shfaqet mentaliteti i tyre? Përgjigjen e gjejmë në roman, por edhe në përmbledhjen që i bëri autori gjatë përrurimit të librit kur tha: “Në vendlindjen e përbashkët, në Pilisamë, njerëzit nuk rrojnë dot pa vënë baste dhe pa bërë shaka me zarar, madje atje edhe vetë koha shndërrohet në një shaka të madhe. Zakonisht, pilisami e nget makinën me njëren dorë në timon, me tjetrën në telefon dhe, po

ta kishte pasur, me të tretën duke kruar veshin. Me të shkelur për vizitë në një muze, pyetja e parë është: Ka wireless këtu? Qyteti ynë po bëhet i mërzhitshëm, ankohet njëri nga protagonistët, njerëzit këtu krijojnë halle të ngjashme, prandaj flasin thuajse njëlloj, teksa herë-herë më duket sikur na kërcënon një përmbytje kolektive. A thua nga balta që jemi mësuar të krijojmë vetë?! Shkurt, vazhdon protagonistin, s'më ka mbetur tjetër, veçse ta marr kryet nën sqetull dhe të largohem nga vendlindja, siç largohet djali nga nëna. Por ta dini, më tepër se nga Pilisama, njerëzit ikin nga pilisamët.”

E megjithatë, duke qenë ziliqarë të thekur, si të gjithë shqiptarët, e kanë të lindur ndjenjën lokaliste, pra që ata janë më të mirë se banorët e qyteteve fqinje, se ata janë më të vjetër, se kanë një histori më të pasur, se kanë një mal më të lartë etj. Jo më kot, kur në qytetin kundërshtar të Algurit ndodhte që një njeri nuk shihej në rrugë për disa kohë, dilte dikush që thoshte: “Ai ose ka vdekur, ose ka vajtur në të s'ëmës!”, duke aluduar me tallje për Pilisamën.

Përveç personazheve dhe vendeve, emërtimet e të cilave janë satirike dhe ironizuese (Mali i Pulës, Pilisama TV, Kullat Nusret e Kudret, Fabrika për Larjen e Krehjen e Leshit etj.), edhe kompozicioni i romanit është solid, madje do të meritonte vëmendje më



vete. Narracioni vjen i organizuar në pesë pjesë, që emërtohen me pesë nëntituj: Libri i Hapur, Libri i Pranisë, Libri i Shortit, Libri i Treshit dhe Libri i Mbyllur. Kompozim që i ngjan një opere të madhe klasike me uverturën, ariet, kulmin dhe finalen, që në fakat mbetet fund i hapur për fantazinë e lexuesit.



Por a kanë pilisamët binjakët e tyre nëpër botë? Komisionari Hirson, i cili ka bredhur shumë, gjatë një fluturimi natën me avion përpiket të krijojë një hartë të rruzullit me këtë synim. Dhe i rezulton se njerëzimi ka gjithandej pilisamat e veta. Prandaj, me një frikë në zemër, heq dorë nga kjo hartografi, sepse i duket si tumorgrafi.

Shkrimtari i shquar Mehmet Kraja e ka vërejtur me kohë prirjen e Zija Çelës për të përqeshur pambarim bashkëkohësit në romanet e tij. Në vlerësimet për “Pilisama selfie”, ndër të tjera Kraja thekson: “Duke qenë kuptim universal i shpresës dhe dështimit për Pilisamat e ngjashme të botës, ajo bëhet gjithashtu garë stigmatizuese për pushtet, prestigj e rang shoqëror, madje edhe për të arritur kuptimet e pamundura të universit.”

Dhe unë pajtohem plotësisht, sepse si të tillë e lexova dhe e përjetova, pasi në lojën e artit Zija Çela mbetet njëkohësisht gjithnjë i paparashikueshëm.

ZIJA ÇELA Pilisama selfie

OnufriRoman



1. Emri “Visar” në shqipen tonë ka pikërisht kuptimin e një thesari, por shpirtëror, prandaj dhe gjeneratat para nesh gjithë poezinë dhe legendat e krijuar në shekuj nga populli i kanë quajtur “Visaret e Kombit”.

Si asosacion idesh kjo më ndërmendet për Visar Zhitin poet dhe njeri, mik dhe shkrimtar, një krijimtari e begatë, një prurje, visar në letrat e sotme shqipe.

Që kur isha student në Shkodër, ku kishte qenë student dhe Visari, ai iku, kur unë shkova, e emëruan mësues fshatrave të Kukësit, ndëkaq mësova se ai kishte lindur në Durrës, rritur atje dhe gjimnazin e kreu në Lushnjë...

E gjithë kjo rendje dhe për shkak të biografisë politike të familjes, siç thuhej atëhere, i ati Visarit, Hekuran Zhiti, mësues dhe aktor nuk shihej me sy të mirë nga regjimi, janë përndjekur dhe kane pësuar dënime, burgje e pushkatime. Për Visari flitej se ishte një student që guxonte në të folur dhe në të shkruar, pati një poezi mbresëlënëse, metaforike.

Në rrethin tonë letrar studentor shpesh na dilte para emri i tij, mënyra e tij e leximit dhe e konceptimit të poezisë dhe artit në përgjithësi.

2. Njohja e parë reale me Visar Zhitin ishte empirike në një manifestim poetik në Durrës, si dy krijues të panjohur, por u gëzova me faktin, kur neve, të shkollës Ekonomike të Sarandës, na e mirëpriti idenë për një takim letrar me Kryetarin e Parlamentit, shkrimtarin Pjetër Arbnori, që vinte nga burgjet, do diskutonim dy vepra të tij. Visari në atë kohë punonte bashkë me atë, dy bashkëvuajtës, dy autorë disidentë.

Nga takimi i Sarandës ata ikën me mbresat më të mira për veprimtarinë e përbashkët letrare, për të cilën u botuan dy shkrime në Shqipëri dhe në Kosovë, një shkrim im për romanin “Mugujt e mesjetës” dhe të nxënësës sonë për novelën, “Kur dyndeshin vikingët”. Visar Zhitin e ftuam prapë në takimet poetike Joniane të Sarandës. Kujtoj që aty ishte dhe njëri nga ata, që kishte bërë akt-ekspertizën e poezive të Visar Zhitit, kur e dënuan me 10 vjet burg si poet kundër Realizmit Socialist, “kundër sistemit tonë politik, hermetik, me figura të errëta që nuk duhet botuar, po dënuar”, etj. Çudia ishte se Visari qëndroi me plot dinjitet dhe mëshirëmadh para spiunëve të tij dhe në fjalën që mbajti tha që “poezia na bashkon si prangat”, ironi e tij për ironinë e kohës.

3. Në jetën e Visarit dhe në krijimtarinë e tij letrare ka shumë gjera që të tërheqin vëmendjen dhe janë ngulitur si gurët kilometrikë në vetë ecurinë e kohës tonë.

Kjo duket që në titujt e vëllimeve të tij poetikë, ku ka simbolizëm apo metaforizime dhe risi, që nga i pari për të cilin u arrestua “Rapsodia e jetës së trëndafilave” dhe pas konfiskimit ka humbur si dorëshkrim e te librat që botoi pas rënies së komunizmit: “Kujtesa e ajrit”, “Hedhe një kafkë te këmbët tuaja”, “Mbjellja e vetëtimave”, “Dyert e gjalla”, “Si shkohet në Kosovë”, “Thesaret e frikës” apo te poezitë për fëmijë “Të rritesh nga dashuria”, etj.

Libra që të thërrasin dhe këtë nuk e realizon dot kushdo.

Visar Zhiti kaloi dhe në prozë, nga tregimi në roman. Krahës gjetjeve madhore dhe zbulimeve tronditëse, vendos edhe detajin e veçantë, domethënës, jetësor dhe poetik. Nga përmbledhja me tregime “Këmba e Davidit” te romani postkafkian “Funerali i pafundmë”, prapë nga romani symbolist dhe marramendës “Perëndia mbrapsht dhe e dashura”, te

VISAR ZHITI SI KRIJUES I VEÇANTË NË SYTË E MI DHE NË LETRAT SHQIPE

Nga Dr. sc. Bardhyl Maliqi



esetë e përmbledhjes “Në emër të a(r)tit”, te tregimet prapë “Shekull tjetër”, “Valixhja e shqyer” për adoleshentë apo lexuesin pa moshë, etj.

Në secilin prej tyre zbulohet mrekullia si perla e plagës në guackën e vuajtjes...

4. Visari, në aradhnë e autorëve të ferrit siç e pohon dhe vetë, pati fatin, por dhe guximin, edhe heroizmin, ndër të paktit, që nxori gjallë nga burgu rreth 300 poezi, të shkruara fshehurazi. Dhe siç e thamë, i dënuar me gjyq ishte pikërisht për poezinë, nuk duhej të shkruante më. Dhe i botoi të gjitha duke i sjellë poezisë shqipe një dëshmi të rrallë, një arritje sa danteske, po aq dhe modern.

Poezitë janë përkthyer edhe në gjuhë të tjera, ndonjë është kthyer në tekste këngësh në Itali e Angli, etj.

Po kështu Visari solli memoaristikë, gjininë letrare për të cilën krijoi termin burgologji. Botoi dy libra monumentale, të cilësuar nga kritika, për burgun famëkeq të Spaçit, “Rrugët e Ferrit”, dhe për burgun e akullit të Qafë-Barit, “Ferri i çarë”, që lexuesi i ka parë si romane-epope dhe është vlerësuar me Çmimin e Madh të letërsisë.

Ka vazhduar me romanet “Në kohën e britmës” dhe së fundmi “Këpuca e aktorit” si metafora e këpucës së ecjes së Shqipërisë. etj., Krijimtaria e tij është pritur mirë nga lexuesi ynë dhe i huaj.

5. Talenti i Visarit, vazhdues i veprës të shkrimtarëve të dënuar në burgjet komuniste, por dhe të pushkatuar, duke filluar me autorët e Klerit Katolik, me disidenten e parë femër, shkrimtaren e lauruar në Romë, Musine Kokalari, Ernest Koliqi – i dënuar me vdekje, i

arratisur politik, që hapi katedrën e parë albanologjike në Romë, Profesor Arshi Pipa, - i burgosur politik, që u arratis në SHBA, tragjediani i parë Ethem Haxhiademi – vdekur në burg, i helmuar, me romancierin Astrit Delvina, - i burgosur, Lazër Radi, gjithë jetën burgjeve dhe internimeve, me romancierin Astrit Delvina, - i burgosur politik, Lazër Radi, gjithë jetën burgjeve dhe internimeve, etj, me poetët Trifon Xhagjika, - i pushkatuar, Vilson Blloshmi e Genc Leka, - të pushkatuar, Havzi Nela – i varuri i fundit në të gjithë kampin e Lindjes, etj, etj, me Mitrush Kutelin, që e varrosën të gjallë në burgun e kënetës së Maliqit, por u ringjall si me magji, si e gjithë letërsia e tyre, që Visar Zhiti me të drejtë dhe në mënyrë magjistrare e thotë në një intervistë të vonë në “ExLibris”, “që me mundimin golgotian në burgje e internime arritën të jepnin një afresk madhor, tragjik, të ferrit shqiptar, e gjitha një kryevepër” dhe në këtë konstelacion skëterror, - shtoj unë, - vepra e Zhitit shkëlqen mynxyrshëm, por fort, edhe për nesër.

Mua personalisht më ka qëlluar të takoj disa nga autorët disidentë të letërsisë shqipe. Bilal Xhaferrin e kam takuar 2 herë, kur isha nxënës në Tiranë, Musinenë një here, kur ishim ekskursion në vendin e internimit të saj pas burgut, Pano Taçin disa here, kur ishim bashkë në takime letrare në Tiranë dhe në Shkup, pas rënies së komunizmit. Kam takuar disa herë edhe autorin shkodran, Frederik Rreshpja në Tiranë dhe në Shkodër. Mua dhe Zydi Morava, i përndjekur, që u bë dhe Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve pas burgut, më pëlqente, kishte poezi të drejtpërdrejta dhe elegante. Na ka vizituar në Manifestimet tona poetike disa herë dhe

ka lenë mbresa.

Kam studiuar edhe autorë klasikë disidentë si Ernest Koliqi e Kasëm Trebeshina, etj. Më pas do të kishim dhe antologjinë shkollore “Maja e çelur”, ku u futën autorët e munguar. Po mundoheshim të fitonim kohën e humbur...

6. Shpesh flitet për Letërsi të kujtesës. “Po a thua ka letërsi të harresës?” – do të pyeste me ironinë e tij shpotitëse Visar Zhiti. Nën “kulturën e së keqes” bëhen përpjekje të angazhuara për të harruar ç’nuk u duhet regjimeve dhe për të kujtuar dhunshëm ç’ duan ato. Kështu shpjegon Visari.

Por unë dua ta vazhdoj ironinë zhitjane dhe them se letërsi të harresës duhet të ketë, por jo për shkaqe jashtë letrare dhe veçanërisht jo për shkaqe politike, por sipas diagnoses “skarcitet letrar” dhe vetëm për këtë shkak duhen harruar shumë autorë dhe vepra të të ashtuquajturit Realizmi socialist. Ashtu si ka autorë dhe vepra që duhen të mbahen mend për arritjet e tyre letrare nën diktaturë si ato të Ismail Kadaresë, Dritëro Agollit, Petraq Markos, Fatos Arapit, Jakov Xoxas, Xhevahir Spahiu, Bardhyl Londos etj. Edhe shumë autorë dhe vepra nga radhët e letërsisë disidencës i takojnë muzeut të kujtesës, por kujtesës së ta ardhmes dhe kjo është e domosdoshme nëse nuk duam që traumat të përsëriten, ato letrare e kam fjalën në këtë rast.

7. Prandaj ne na duhet Visar Zhiti. Do ta citoj papë. Ai thotë se Letërsia shqipe përgjithësisht është letërsi martire. Ajo që në fillimet e saj nisi nën pushtim, me autorë të përndjekur, me poetë të vrarë e të syrgjynosur.

Shembuj madhorë mund të merren edhe nga letërsia e vjetër shqipe, edhe nga letërsia e Rilindjes Kombëtare, e Pavarësisë, e viteve të socrealizmit. Mund të vazhdohet dhe me 33 vjetët e postdiktaturës, të demokracisë sonë të cunguar. Letërsia ka qenë martire jo vetëm brenda, por edhe jashtë Shqipërisë, në trojet e populluara me shqiptarë në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, në Malin e Zi, tek arvanitasit në Greqi apo arbëreshët në Itali. Po marr tre raste kur Aristidh Kola, Bilal Xhaferri dhe Luka Çiçipi vdiqën në rrethana të dyshimta, nga sëmundjet e shpikura në laboratore. Por të mos harrojmë atë që pohon Visari se “Letërsia e burgjeve”, nuk erdhi të zëvendësojë letërsinë shqipe, siç u trembën disa shkrimtarë të realizmit socialist, por për të sjellë vetveten, dhe kjo e drejtë s’mund të mohohej gjithsesi. Ajo e pasuroi letërsinë shqipe. I solli dinjitetin dhe moralin dhe të vërtetën, shpjegon magjistralshtëm Visar Zhiti. Diktatura aq mizore e përndoqi, e mpaku, por nuk e zhduk dot, ajo s’mund të zhbëhet tani. Veçse rritet. Visari vazhdon të na thotë: “Letërsia e burgjeve” është një mrekulli ringjalljeje... ajo u gatua në terret e vdekjes. Dhe në burgjet e diktaturës nuk është



futur kurrkush për t’u bërë shkrimtar, përkundrazi, por për të mos shkruar dot, për t’i thyer “penën dhe kokën”. Por ndodhi triumfi...

8. “Realizëm i dënuar” – kjo është ajo që propozon Visar Zhiti si studiues. Mjafton të shfletojmë veprën e tij, sprovën “Kartela të Realizmit të Dënuar”, ku nuk është fjala thjesht te një kundërvënie ndaj Realizmit Socialist, por tek përgjithësimi se realizmi është një dhe vetëm një. Po edhe letërsia është e tërë dhe e përbashkët, na thotë Visari.

9. Te ai do të doja të qendroja më gjatë e më shumë, Po kaq e lejon kumtesa ime sot. Mund të shtoj për portretin letrar të Visarit se poezia e tij është perkthyer në të gjitha gjuhët e Ballkanit dhe në shumë gjuhë të mëdha në Europë, është botuar që nga Amerika dhe deri në Kinë dhe ka marrë shumë vlerësime dhe çmime letrare, kombëtare dhe ndërkombëtare.

“Jeta dhe vepra e Visar Zhitit, - thoshte albanalogu i shquar kanadezo-gjerman Robert Elsie, ndërkohë dhe përkthyes i tij, - janë pasqyra më e mirë e histories së kombit të tij”.

“Poezia u shkakton frikë regjimeve diktatoriale si me rastin e Visar Zhitit”, - thoshte shkrimtari italian, Umberto Eco, filozof dhe semiolog, ndër më të mëdhenjtë e shekullit XX në botë.

Do ta mbyll me vargje, me tre kohë të poezisë së Visarit,

- E para, në diktaturë, kur ishim bashkë studentë:

Shumë gjak është derdhur në këtë botë,
Por ne ende nuk e kemi krijuar
Diellin e gjakut..
Dëgjo, miku im, këto fjalë që dridhen,
Ne një diell të dytë do të krijomë
me gjakun që derdhet, në formën e
zembrës.

Visari, pra, deshi një diell tjetër në formën e zembrës dhe e burgosën.

- E dyta, koha e burgut. Ja, si shkruan: “Ardhja e Pegasit në poezinë time”:

Kisha kohë pa u parë në një pasqyrë,
pothuaj e kisha harruar fytyrën time,
u pashë në sytë e kalit
kaq shumë njerëzorë
dhe me një si brengë shndritëse.
Isha i qethur tullë, pis dhe me mjekër..
U mënjanova, se mos i dukeshka kalit i
egër.

Nuk ka përmbyllje më të bukur artistike se kjo, gjë që tregon artin e vërtetë. Ja dhe një strofë tjetër nga poezia “Ëndrrat”, e shkruar në burgun e Spaçit në dimrin e vitit 1982:

... dhe s’po të them që i vrasin ëndrrat,
që kam shëtitur ndër varret e tyre.
Ndodh që na vrasin më parë se ëndrrat
dhe qajnë ato mbi ne si vejushë.

Dramatike! Ëndrrat vejushat me ëndërrimtarë të vrarë.

Dhe koha e tretë, pas burgut, në posdiktaturë, në liri, kur vendi u hap, për t’iu bashkuar qytetërimit euroatlantik, demokracisë. Visari me një distik mahnitës na drejtohet të gjithëve:

Jeta, që s’mjafton për dashurinë,
Ku gjeni ju kohë për t’u urryer...

E gjithë poezia dhe romanet e Visar Zhitit, jeta e tij, janë në disidencë me të keqen, mision i dashurisë dhe çarje e natës për të rrjedhur dritë hyjnore. Ai si poet, si shkrimtar ia doli...

Mbi vëllimin “Shtegtim vargjesh” të autores Loreta Schillock

Poezi e individualizimit të temave universale

Nga Arben Prendi

Poetja Loreta Schillock promovoi vëllimin e saj poetik në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Në vijim të aktiviteteve për “Muajin e letërsisë” poetja Loreta Schillock u takua më datë 20 nëntor 2023 me studentët e degëve *Gjuhë-letërsi* dhe *Gazetari-komunikim* në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Takimi u zhvillua në mjediset e Bibliotekës Shkencore të këtij universiteti. Moderator i takimit prof. as.dr. Arben Prendi, drejtor i departamentit të Letërsisë, prezantoi autoren dhe vëllimin e saj poetik “Shtegtim vargjesh”. Ai vlerësoi se këto takime janë një mundësi e mirë për studentët që të njihen me vepra dhe autorë të ndryshëm të letërsisë shqipe bashkëkohore, si dhe të nxiten që edhe ata të marrin kurajo për të publikuar krijimet e tyre letrare.

Autorja Loreta Schillock shprehu kënaqësinë e saj që librin e saj të parë me poezi e promovon në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” para studentëve, që janë edhe lexuesit më të mundshëm të poezisë. Për vlerat artistike të këtij vëllimi diskutuan Edon Bushaj, student i masterit profesional në Gjuhë-Letërsi dhe Arben Prendi, drejtor i departamentit të Letërsisë.

Poetja Rozafa Shpuza përmes një bashkëbisedimi me autoren, veçoi edhe kontributin e saj si përkthyes e letërsisë nga gjermanishtja në shqip dhe anasjelltas si dhe përvojën e saj si docente në Universitetin e Shtutgartit.

U lexuan me këtë rast disa poezi të autores nga Aleksandër Prenga, student i baçelorit në Gjuhë-Letërsi, Xhuljana Guri, studente e baçelorit në Gjuhë-Letërsi dhe Arjola Zadrima, studente e baçelorit në Gazetari-Komunikim. Gjithashtu, poezi u lexuan edhe nga Nikolin Ferketa, aktor i Teatrit “Migjeni”.



Vëllimi poetik “Shtegtim vargjesh” është libri i parë me poezi i autores Loreta Schillock. Përveçse poete, autorja është përkthyes nga gjuha gjermane dhe shqipe, docente në Universitetin e Shtutgartit. Siç shprehet autori i parathënies së librit prof. Besim Rexhaj, leximi i lirikave të poetes Loreta Schillock është një udhëtim poetik nëpër shtigjet e një bote të veçantë, të ndryshme dhe origjinale nga ajo që rëndom hasim gjatë leximit të poezisë, e cila tash e sa kohë, duke ju falë modës e trendeve, jo rrallë tradhton vetveten e uniformizohet deri në skematizëm.

Do të shtoj se, poezitë e këtij vëllimi janë kryesisht lirikë intime, moderne në kuptimin e mënyrës se si ajo e vështron dhe e përjeton vetveten, “unin” saj njerëzor. Kjo lirikë është mbështetur në gjendjet shpirtërore të poetes, të cilat, përkthehen në imazhe poetike, por edhe në domethënie kuptimore, ngjyra dhe tinguj.

Gjuha poetike e saj synon komunikativitetin përmes qartësisë së domethënieve kuptimore, fjalorit poetik, të kapshëm prej lexuesit. Madje ajo është një lirikë që kërkon bashkëpunimin e lexuesit të saj. Gjejmë aty temat universale të lirikës, si: dashuria, vetmia, trishtimi, gëzimet dhe zhgënjimet e jetës së përditshme, deri tek familja, atdheu, poezia si art etj., mirëpo këto tema universale, poetja i individualizon me thjeshtësi dhe duke folur me vete...Nga vargu në varg poetja është njëfarësoj si Liza në botën e çudirave, por që udhëton brenda vetes. Atë e mrekullon dhe e çudit bota e unit të saj. Loreta është një poete e ndjeshme, delikate në skicimin e imazheve poetike. Madje në një tekst ajo e cilëson veten si “poezi pa titull” që pret pikërisht titullin nga i dashuri, duke krijuar një lojë poetike ku rezulton se i dashuri i saj është lexuesi i nënkuptuar, ose të paktën i dashuri i saj është lexues dhe shijues i poezisë:

“Pa titull
... Më rrëmbe në krah e më lexo:
Se jam shkruar për ty,
Kam mbetur pa titull...
Sepse titullin e pres nga ti.” (f.39)

A është i dashuri si lexues apo lexuesi si i dashur?! Mund të jenë të dyja!

Marrëdhëniet themelore në krejt vëllimin poetik “Shtegtim vargjesh” janë ato mes të dashurit dhe të dashurës. E dashura shkruan për të dashurin, për dashurinë, sepse ai e bën të dashurën e tij të ndihet si në fillim të krijimit të botës (Adami-Eva).


“A do të isha e dashur
po të mos t’më ledhatonte dashuria jote.”
(f.48)

I dashuri duhet ta lexojë të dashurën siç lexohet një poezi, madje ta lexojë kaq me kujdes, përkujdesje e dashuri, përkushtim, sepse ai duhet t’i vendosë poezisë edhe titullin e duhur...

Lirika moderne, siç thuhet shpesh, është gati e papërkthyeshme dhe madje, për dallim nga lirika tradicionale, edhe e pakomentueshme deri në fund. Edhe lirikat këtij vëllimi, secilit lexues do t’i flasin ndryshe.

LORETA SCHILLOCK

shtegtim
vargjesh



OnufriPoezi

Prej vitesh e prisnim një libër poezie nga Lluka i cili çmohet nga një rreth i madh shokësh e miqsh si një personalitet unik, qoftë për vlerat po edhe për mënjanimin e tij në vazhdimësi. Fizikant astronom autor esesh, ai vjen nga një familje e vjetër beratase-vlonjate, me kontribute në çështjen kombëtare. Gjyshi bankier, i ati gjeolog, gjyshi tjetër pronar i madh, por të përndjekur rëndshëm të tre siç u takonte familjeve të shquara që me praninë e tyre çvlerësonin regjimet e cilsuara si antipopullore por edhe ata që u vetshpallën ‘popullor’ njeri, dhe ‘demokratik e pluralist’ tjetri pas tij... I edukuar me frymë fetare nga nëna zotëruese e një kulture evropiane siç mund të merrej në një kolegji murgeshash franceze diku në Evropë, ai shkëlqeu që në fëmëni si *enfant precoce*, gjë që tërheq prapësi e bullizma jo vetëm nga moshatarë po edhe nga të rriturit, ai nuk u zbraps nga ‘e tija’ as në momentin kur liria u lejua por fshehtazi kanosej, pikërisht në kushtet e pluralizmit të posa nisur, kur pësoi madje keqpërdorimin kulmor, atë fizik, sidhe pushimin nga postet që kish nën diktaturën e mirëfilltë, normalisht jo aq e çmendur sa të hiqte një kuadër që i bënte punën, siç do ta bënte vazhduesja e saj ‘demokrate’ që të mbaronte punët e saj në demokraci...

Mund të pritej që poezia e tij të sillte jehona nga këto momente të hidhura e veçanërisht absurde, ndaj dhe me vlerë për polemikë, por nuk ndodh kështu në libër. E shohim autorin në të tjera vise, me tjetër disponim. Indinjata tek njerëz si ai nuk vjen si shpagim qoftë me finecë i padrejtësive të pësuar. Kur themi i mënjauar, e kuptojmë në sensin filosofik dhe jo ndaj një shoqërie me të cilën je në të drejtën të mbash mëri. Kjo ndihet që në faqet e para, madje që në vargjet e para të librit *Prizëm*, ku ndarja me botën kuptohet si e ndodhur prej kohësh:

Tek rri më kot ngajnë shumë gjëma Anembanë kësaj bote vlerëçpuar

Komponentët “rri më kot”, “ngajnë shumë gjëma” tregojnë boshllëk dhe kaos që ua gjejmë shkakun tek togfjalsi “.. kësaj bote vlerëçpuar”

Të kërkojsh ligjërim sentimental o idealist në poezinë e Llukës je tërësisht *out*. I dhënë si më lart humori i autorit, mes kotësisë dhe gjëmave shpjegon sëpari mënjanimin e tij si qëndrim të papajtuari me atë që *hiqet* në treg, por *bota vlerëshpuar* e kthen atë mospajtim në filozofik, dhe pa afat. Të presësh prej tij angazhim se si do shkojë aksh projekt reformues, s’ke kuptuar portatën e preokupimeve të tij, të ç’natyre janë. Indinjata nuk i mungon, dhe shpërthen shpesh edhe për motive të njejta me tonat, madje me ashpërsi të habitshme, që i shoqëron ato me indinjatën e kokave të mëdha të kohërave. Sepse i adresohen, posi e atyre, shkakut të thellë, fillestar të mbrapështis së botës. Inatin pra e ka jo aq emocional sa qënësor, të atij që e njohu dikur Botën në bukurinë e saj të pacikur, dhe ajo i çfaqet tani e tjetërsuar, plot shëmti, për faj të një pabesie o shkelje të fjalës. Ta kesh këtë dramë mendore ose ide fikse me të cilën merresh në vazhdimësi, mund ta përfytyrojmë si vetmi që njëherazi vlen si një favor i hidhur që u jepet gjenive. Kjo vetmi theksohet dhe më në kohët e sotme kur roli i inteligjencës bie thekshëm për shkak të automatizmit dhe të zbavisë invadente.

Kështu që në vazhdim të komentit e poezisë kyç ‘Vërejtje’, merr rëndësi të kuptohet ç’ lidh strofën e parë të saj, kaq goditëse, me Hyrjen në faqen e parë të librit, ku lexuesit i është njoftuar në prozë të matur nga autori, se poezitë që vijnë në libër bëjnë fjalë për persona, akte, kategori mendore të një sfire tjetër, të dëgjuar dikur, të panjohur për të tjerë: E shenja, jeta si dhuratë, Ai që na e dhuroi, etika, pëllumbi përfaqësues i dlihtësis sublime, jepen në atë Hyrje si brendi e përfutur *përmes tejpushmëris që përbind botën reale*. Fjalë të forta por që të thëna nga një vetmitar meritojnë të analizohen në tri instanca 1. Si pjesë e një tradite të njerzimit dhe tonës 2: për bukurinë e tyre të paperëndueshme tek arti i shekujve 3. Për faktin që thuhet nga dikush që u ka përkushtuar jetën. Mund të mos kuptohen menjëher pa u kushtuar vëmendje

PËR POETIN LLUKA QAFOKU

Nga Lekë Tasi

këtyre mundësive për meditim, madje gjasa është që kjo të mos ndodhë, me përjashtime të pakta.

Strofa e cituar më lart, e para, plotëson tek dy strofat e tjera momentin që *vlera e heshtur* na dëftën se ku gjenden shtigjet e shpëtimit:

*Zemra rreh drejt heshtjes dhe humbjes
Shpirti dhemb, varrohet dhe harrohet
Por një shenjë e pagjurmë
Më kujtohet edhe në gjumë*

*Një shpresë e një rrugë të çuditshme
Një shpresë që mërgon çdo luhatje
Drejt amanetit t’pathënë
Drejt një fjale dikur dhënë*

Kthesa e pritur po afron, por kur del në rrugë, e njejta dritë e mugët si në strofën e parë ia mpi shpresat – i bëhet e pamendueshme të gjendet rruga e atij uniteti antik tek sheh turmat të mbetura në atë harresë kaq të rrënjosur, prandaj i emëron *Vërejtje* tri strofat që u drejton, varianti më miqësor për kritikën.

Zemra i rreh dhe shpirti i dhemb,
por prapë s’mund të heqë dorë si nga një send

që e kemi varrosur dhe harruar.


I ripropozon “fjalën e dhënë” dikur, që na mbante të bashkuar në atë rrugë të çuditshme. Është vërtet e çuditshme (po citoj Hyrjen:) *..dhurata sublime e jetës njerëzore, që Ai vetë na e dha me Shpirtin e Shenjtë që u simbolizua realisht dhe përmbajtësisht përfaqësues i pastërtisë sublime*

Janë fjalë të fuqishme por që e ndalin në vend tek sheh një masë kaq të pavëmendshme për çka ai e mendonte si të maturuar për ta përqaftuar. Vërtet kjo ndodh gjithmonë, por nuk mund të shtyhet pa afat zgjidhja... Veçansia madje e këtij botimi qëndron te kjo distancë që krijon vetmia. Ajo është e nevojshme e domosdoshme për të aftësuar një raport të ri aty ku është, por që s’mund të jetë veçse një fillim. Dhe fillimi është edhe ai i detyrueshëm. E rëndësishme bëhet ajo që autori thotë më pas në Hyrje

“Çdo përpjekje për sinqeritet që solli në jetë këto shkrime modeste është një teh i Prizmit të tejpushmërisë që përbind botën reale duke refraktuar ndriçimin e brëndshëm

. Kështu pëllumbi etik transformohet në pallua poetik dhe bardhësia verbuese e borës etike në lulëzim laryshor të estetikës pjellore të realitetit: Jerina fishtjane dhe vula e Solomonit në pafundësinë e interpretimeve në realitetin njerëzor”.

Me këtë poetizim kaq të gjetur të asaj që ndodh në momentet e kthesave historike Lluka vihet në pozicionin ekstrem të vetmitarit, me rreth vrojtimi të plotë, që bashkë me realen e fshehur përfshin një pejsazh me gjithfarë mostrash nga e kaluara e plot nisma të çmendura për të ardhmen. Vetmi edhe më produktive tani si i rritur, se nuk do tu kushtojë kohë joshjeve të asnjë lloji, ashtu siç nuk do tu përgjigjet goditjeve të pësuar me hidhësirën e të zhgënjyerit ose me inatin e hakmarrësit, (pretekst i shkëlqyer ky për poezi sociale). Ashtu ai e ndien më thellë sfidën, ai ka lënë një karrierë të sigurt si fizikant teorik, për të përqaftuar atë që mund të cilsohet dorëheqje për hir të drejtësisë në pikën gjeografike të shkeljes së saj më skajore. Një tension tipikisht shqiptar që bëhet universal për të, sepse kjo çështje e ka preokupuar siç thamë filosofikisht. Dorëheqja kësajohet bëhet një realizim *sui generis* kur i privuar në maksimum nga mjetet, i ofrohet rasti për meditim e veprim intelektual, që në karrierën e ngjeshur në botë mund t’i mungonin. Dorëheqja për hir të një interesi mbipersonal është pjesë e kulturës botërore e jo vetëm e asaj kristiane. Qëndrimi në atdhe i këtij pinjollit të elitës më patriote merr për ne miqt dhe admiruesit e tij një kuptim simbolik, si një kthesë e fatit për Shqipërinë, nga viktimitë dhe e braktisur që priste ndihme prej bijve të mërguar, në Shqipëri të mëkëmbur dhe të aftë për veprim të pavarur. Të vijnë në mend edhe raste të tjera nga familja e Llukës, gjyshi i tij, faktor përparimi qytetar në Vlorë, i mbaruar në kampet naziste, vëllai i gjyshit tjetër - murg në Athos, për të mbajtur amanetin e dhënë për shërim. Vepra eseistike e Llukës, puna e tij shumvjeçare dhe organizata **albshkenca** e ideuar bashkë me vëllanë e tij Niko Qafoku, shkencëtar në rang federal i SHBA, me mijra antarë elitare të afirmuar në botë pjesë të këtij zotimi familjar të hershëm për një proces gjallërues që funksionon pa bujë por me një



të ardhme shpresojmë të sigurt. Edhe dalja në dritë e librit ‘Prizëm’ ngjan të përmbushë një etapë të këtij kalendari të menduar për ngjarjet që do vijnë

.. e një etike, që manifestohet me pastërtinë e vetvetishme të përsosurisë së pastërtisë.

E “vetvetishme” besoj do të thotë ajo aftësi që të jepet një herë e mirë, dhe autori e spjegon me impenjimin e patundur në zotim e që gjen hirin për të vazhduar

Një shpresë që mërgon çdo luhatje

Duhet të ketë qënë një zotim i kësaj natyre që fizikanti me të dhëna maksimale mërgoi idenë e largimit. Ai hoqi dorë nga një karrierë shumë premtuese si zotërues edhe i një kulture eprore nga çdo aspirant tip, dhe e bëri atë të merrej me ç’i sillte dita, një zgjedhje për tu falënderuar nga ne miqt e tij atëhere dhe sot. U vendosën kontakte shumëplanëshe, me shkëmbim mendimesh që na hapnin vizionin edhe për punët tona. Për vet Llukën kariera në fizikën teorike u zëvendësua me punëra domethënëse si bashkëpunimi me Petro Zhejin për Gjuhën Shqipe, një përpjekje e bazuar në shkencën evropiane të kohës (që e gjenin në libra të ndaluar asokohe) por as e pranuar as e diskutuar nga Akademia sot e kësaj dite; një sërë esesh në Anglisht, ndër to “Zoti i Shqiptarëve”, e rëndësishme për të interpretuar edhe historinë tonë, por pa mundësi debati në kushtet tona, për mungesë vullneti po edhe kompetence siç e dëshmon vetmia tjetër e tij në mes dhe të miqësorëve e jo vetëm të dijes zyrtare. Mjafton një shikim tek një ese tjetër e tij në anglisht “Ese mbi një ese” ose “POETI I RËNDIMIT ose POETI I PAZOT [në të dy kuptimet]=I PAPERËNDI HEROI I MENDIMAT po dhe[HEROI IMAGJINAR “, dhe referencat që bëhen në futnotat, për ta kuptuar këtë vetmi të padëshiruar të tij dhe ngushtimin e habitshëm që vuan dija në vendin tonë aq sa të krijojnë një tematikë më vete të bazuar mbi rastin e Llukës dhe të të ngjashmëve të tij: refuzimi i një shoqërie të qasë dijen e plotë përderisa refuzon një pjesë të saj, ergo vullnet për ta patur të gjymtuar.; eseja tjetër prej 23 faqesh në anglisht “Some associations and reflections, sparks of thought on Animal Man, other animals and their environment (Umwelt) I call Time=lifespan(inklings to insights) (Ana-logical b-ridges)me një shikim të pasur të shumanshëm në ç’ është shkruar mbi këto tema që tërheqin kureshtjen e tij kudo ku mund të gjenden zbërthime të problemeve thelbësore të njeriut; përkthim të mjeshtërore nga Bibla, “Ekleziasti”, “Zbulesa”, pastaj “Kështu foli Zarathustra”, një ese e tij për ketë vepër, veprën e filozofit francez E.Levinas, dhe kontributi i tij në një sesion ndërkombëtar mbi këtë autor që trajton ngjashmëritë o analogjitë e fateve të Shqiptarëve me Hebrejt , dhe në mbyllje por jo shteruese proza e gjatë “Spitali”, e botuar dhe e kaluar në heshtje. Bien në sy te kjo vepër prej 30 fq një pasuri mjeshtrare që të impresionon për menyrën rrënjësisht origjinale (të guximshme) që trajton realen dhe të imagjinuarën, fantazinë për të sjellë të ardhmen tonë të rënë pre e lirisë së shqyer por dhe nën dritën e fuqishme të drejtësis hyjnore, gjëra që e rreshtojnë ndër autorët më të avancuar sipas meje, dhe për impenjimin kostant prej kërkuesi për të intuiar ç’ mund të ngajë në botë me start nga sot dhe me implikime që ravizohen qysh sot, natyrisht si mund ta shohë një artist që vë në punë hiperbolën, (por a nuk do të quheshin tepërime, realitetet shekullit të kaluar kur i parathoshte një artist? Shembull Orwell) Problemi që rri përposht ngjarjeve të një harku kohor sot, me mundësi të provuara tragjike



qëndron te indiferenca dhe papjekuria e botës së pasur . Në fakt është raporti i dobët preokupim/ problemim që tregon bota nominalisht e krishterë në sjelljen e saj ajo që përbën shqetsimin e tij. Dhe përqëndrohet sigurisht ai tek ndajfolja *nominalisht* .

Kurse poezia e Llukës, e pashkëputur nga dialogu me veten, vepron në momente të zgjedhura por thuasje pa pushim , me një gjuhë esenciale falë rigorozitetit të tij në shije dhe kulturës së gjerë,... Në vazhdim të volumit ‘Spektër’ lexuesi do të vërë re këtë depërtim në thelbin e gjërave, kur gjen të tjera pretekste me fokusime të papritura , që i evidentojnë originalitetin. Që këtej vjen dhe e ohuranj ‘ ngushtësi’ e poezis në pak shijues. Kjo dhunti intuitive e çon autorin, mbasi ka numuruar edhe çfaqjet më të hidhura të jetës me pak rreshta, tek një vis i largët prej të cilit vargu merr si një dritë ku ndihet nostalgjia e përjetimeve në moshën e harmonisë me Botën, adolescenca e parë, dhe që i ka lënë në shpirt jo dëshirën o pezmin për të ndryshuar dishka, ai është i sigurt që ndyshimi ndodh objektivisht, por një dëshirë për *plotësi* që do të thotë përsëri vetmi ngaqë çdo individ ka linjën e tij të pareduktueshme. Ajo përshkon si prizëm tërë librin, që na jep çastet kur meditacioni i tij kërkon *plotësinë* pikë arritjeje,dhe provat që bën në sferën e të dukshmes të lidhur me të padukshmen kaq gjat të ‘banuar’ prej tij në vetminë e tij . Ndërkohë ‘spektri’ i tij ka edhe të tjera shikime realitetit të dukshëm, prej modernisti befas, për ta intriguar lexuesin, psh e para në rend mbas ‘Vërejtje’ me titull “Përshkrim i një momenti”,në të cilën ekzistenca e përjetuar fizikisht rrudhet në një moment të shkurtër tek vetëm suksesioni i ndijimeve pa asgjë tjetër, një vartësi e pacak dhe e pa kuptim. Poezia që pason (“Një portret”) më e gjata dhe më e bukura e përmbledhjes jep të kundërtën, shpërthimin e fizikes që mbush një vajzë të re me energji *orgjiake*,(term i tij) që për instinkt provon të gjitha mundësitë e trurit e të reflektimit, pra pasuri fiziko-psihike me kapacitetin të zgjedhë, pra edhe lirinë – shkurt njerzoria në potencialitetin maksimal të saj.

Poezis së devocionit të shpërfillur deri dje, dhe tani duke rimarrë veten, po i shtohet tek libri një fill bashkëkohor.kur ia merr popullit besimtar qendisjet delikate në nderim të ikonës së Virgjreshës Mari dhe u shton një flok dëbore ! Kjo grimë e ardhur nga qielli me ngadalësi dhe në heshtje ka këtë modernitet nga shkenca që e ka studiuar duke na e ofron ashtu siç është, një brilant, kur e sheh në mikroskop. Nëse ato përdorin objekte tipike secila të epokës së vet, e vjetra *arazzot* dhe qendisjet që i japin luks ikonës së Virgjreshës, e sotmja lulet e fushës o të serrave në ngutjen e saj, *spektri* që kemi në dorë gjen në ravgimet e tij një flok dëbore send që natyra na i ofronte përherë,por që me sa di nuk i është ofruar Hyjlindëses deri dje ndonjëherë ,dhe natyrisht as me atë intencion si ky që formulohet në këtë poezi të Llukës,përmbyllëse e librit :

I përshtatet kësaj dite dërgimi i një dhurate i një dhurate të pafajshme fëminore i një floku dëbore	
që është i butë, i heshtur,sublim dhe i panjollë	
dhe vezullon si çdo brilant	
me kristalet e tij fisnike, të përkryera megjithse të përkohshme dhe të thinjura;	
por aq të brishta dhe delikate sa nuk durojnë as më të voglën prekje të frymës apo gishtit Të lashtët katragjyshë	
të lulëzimit pranveror	
po aq të përkohshëm sa çdo lumturi në këtë botën tonë të mjerë	

NJË GRUA NË AVIONIN E KUJTIMEVE TË MIA

Tregim nga Arben Velo

Një grua me një fëmijë për dore, la pas pikën e kontrollit të aeroportit të Venecias. Ndrichi i mjegulluar, që depërtonte nga dritaret e portës së daljes, iu veshi siluetat. Jashtë, pushtetin e kishte bora

-Zot, përse?- pyeti gruaja
-Sa shumë borë!- tha fëmija
-Pse s’më le ta shihja për herë të fundit-mori frymë thellë gruaja

-Cilën, borën?- pyeti fëmija
Gruaja nuk iu përgjigj. Vetëm psherëtiu. Nga shkallët, të dy, përfunduan në sallën e qëndrimit, e fundit para hipjes në autobusin që të dërgon në derë të avionit.

Diçka i pëshpëriti fëmijës, ndërsa ai heshti. I mituri u ul në ndenjësë, ajo qëndroi në këmbë. Jashtë, në pistë, avionët ngjanin me ca buaj që shkroftënin. Çuditërisht nuk nxirrnin avuj nga trupi.

Gruaja i ra përqark sallës, duke mëshuar hapat mbi dysheme, aq sa krijonte një zhurmë, sikur të vinte jo nga ai parket, por nga parketi i hirtë i natës.

Kisha shëtitur gjithë ditën në Venecia. Hezitoj të rrëfej hollësira nga ajo shëtitje, duke e ditur se nuk do të ndalja së treguari mbresa, bukuri dhe veçanti nga ai qytet i mahnitshëm, të cilat po përpiqem ti mbaj për ti rrëfyer herë tjetër. Veçse nuk më rrihet pa treguar për një grua që mbante prej dore një fëmijë. E gjitha veshur me ngjyrë të zezë, vetëm ecte e lëvizte nëpër një sallë pritjeje, pa e lëshuar nga dora fëmijën, Ky i fundit, ishte veshur, me kostum sportiv, atlete dhe xhiboks ngjyrë bojëqielli. Nisi të më bjerë më shumë në sy, atëherë kur orari i avionit ndryshoi, dhe u shty me një orë, në tabelën e njoftimit. Nga ora 18 00, shënoi orën 19 00. Mënyra se si e vështroi fëmijën, pastaj tabelën, pastaj sërish fëmijën dhe me një pamje të veshur me dhimbje, habi, dhe inat njëkohësisht, por mbi të gjitha se si lëshoi një “aahhh” nga goja e saj, aaahh, i cili u pasua nga ofshama e pasagjerëve të tjerë të pranishëm, gati më detyroi të ndiqja veprimet e saj. Befas ra sinjali i alarmit të derës së emergjencës. Një nga punonjëset, dukej nga kostumi i shërbimit që kishte veshur, vrapoi te dera, stakoi sinjalin, dhe hodhi vështrimin nga gruaja. “Mos e bëj prapë veprimin”, ishte përkthimi i vështrimit të vëngër. Jashtë bora xixërinte nëpër flakëzat e llampave ndriçuese sidomos të pistës së aeroportit.

Nuk po arrija të lexoja çfarë po ndodhte brenda asaj gruaje. Nisa ta imagjinoj se si e përpinte në një gotë atë mbrëmje dhe pastaj mundohej të shtrëngonte nofullat duke mos treguar shijen që kishte ajo errësire e përzier me borë. E shihja teksa qëndronte gojëlidhur, e përfshirë nën peshën e një padurimi, më bëntë çudi mënyra e të ecurit nëpër sallë, ngutshëm, ethshëm, përzier me nervozizëm pse jo dhe me dhimbje. Përherë i drejtohej këndit të majtë të sallës së pritjes dhe që andej kthehej po vrullshëm, përballë vendit ku qëndroja unë. Sa herë gjendej te ai kënd i majtë i sallës, atje ku bashkoheshin dy mure, një flakëz drite, përzier me tis mjegulle, i binte mbi flokët e zeza. Ai ndriçim fitili flakëze, kthente flokët në një kupolë mermeri të zi. Mes ecejakeve, që nuk përfundonin, në asnjë moment, kur ajo lëvizi në të kundërt të tabelës, i ktheu pra shpinën asaj, isha unë që u shtanga. Ndoshta, i pari pashë se orari i nisjes së avionit, ndryshoi sërish. Edhe pse fërkova sytë,, për ti mbushur mendjen vetes se e



kisha parë gabim, orari i fluturimit nga 19 00, shkoj në 23 00.

Pa e mbledhur veten nga ai ndryshim, që përkthehej, pritje rraskapitëse, nisa të shaja kompaninë e fluturimit nëpër dhëmbë, kur....aaahhh-u i saj u kthye në ulërimë. Aaaaaaa. Alarmi ra sërish, Fëmija u tremb dhe gati nisi të qante. Në sallë, njerëzit u shtangëm. Nuk jam në gjendje të përcjellë atmosferën e krijuar. Vetëm mund të them që nga ajo ulërimë, u shuan flakëzat e ndriçimit në pistë dhe kudo rreth aeroportit, Nata shtrëngonte nofullat e qëndronte gojëlidhur nga ajo thyerje e shuarje drite Bora nën një gjysmë ndriçim , ngjante me një çallme të bardhë që e kishte hedhur mbi krye errësira. Ndërsa avionët e parkuar në pistë, tundeshin e zgjoheshin nga ajo dremitje buajsh. Brenda kokës time, nisi të ndriçonte një gjysmë hëne e munguar, e cila në vend të dritës, , lëshonte një xixërimë flakëze pyetjesh të befta. Cfarë po ndodh? Çfarë është kjo?

-Zot përseee?-ulëriti gruaja
-Mami çpo ndodh!- pyeti fëmija
-Pse spo më le ta shihja për herë të fundit-Pse po më lë këtuuuu!
-Kë do të shikoje borën? Kush po të lë ?-pyeti fëmija

Punonjësja e shërbimit në aeroport, gati duke hungëritur, vrapoi drejt daljes se emergjencës dhe stakoi sërish sinjalin që binte pa reshtur.

Ulërima jo vetëm kishte shuar dritat, zërat sharjet, mllfet, por dhe kishte ndezur hamendjet, pyetjet përsetë te secili udhëtar, Të gjithëve na ka ndodhur. E dimë çdo të thotë të ngujohesh me orë, pasi ke marrë vulat në pasaportë, je përballë portës së daljes për të shkuar me autobuz drejt avionit, dhe kur të vjen mandata se ende duhet të presësh, për shkaqe teknike, merreni me mend. Për atë grua, ai ndryshim orari, duhej të ishte më shumë se kaq.Po dridhej, qante dhe lutej. Bashkë me të ëmën, dridhej e qante edhe fëmija.

Nuk dija sa sy njerëzish bëheshin në atë sallë po ti numëroje. Asnjë gojë nuk pipëtinte. Jashtë bora luante indiferenten me pritjen tonë. Ndërsa brenda gruaja qante e ngashëryer. Nga kupa e qiejve, jashtë binte borë. Në dyshemenë e sallës pikë, pikë binin lotë nga kupat e syve të saj. Deri në orën njëzetë e dy e tridhjetë as bora dhe as gruaja nuk dinin të reshtnin. Vetëm kur u hap dera e imbarkimit, një erë e beftë e fortë, i ktheu xixërimat e borës, si kurrë ndonjëherë, në flakëza të çuditshme, që dilnin nga goja e errësirës. Ato arrinin të futeshin brenda llambave ndriçuese të pistës dhe aeroportit, pastaj brenda shkulumave të erës, pastaj brenda nesh, mes përmes avionit që tundej në pistë, ende pa u nisur.

“Bëni kujdes”. Ishte zëri i stjuardesave në

dy hyrjet e fluturakut të metaltë

-O zot, bërtiti një grua, në fund të shkallëve lëvizëse. Ç’po ndodh kështu.?

- Çne kjo furtunë e papritur, kujdes fëmijët”- u frikësua një zë nëne. Njerëzit po mblidheshin e shtyheshin kush e kush të futej më parë. Mes tyre edhe ajo grua me fëmijën. Pas gjithë asaj tollovie, e cila zgjati shumë pak, situata duket se u qetësua. Udhëtarët, po zinin vendet. Ende në fytyrat e tyre lexohej frika. Gruaja dhe fëmija u ulën në sedijen nr. 23 B dhe E. Unë një radhë më pas, 24 C. Avioni ulëriti këtë herë në hyrje të pistës. Nisi të ngrohte motorët duke kalitur fuqitë për të vrapuar mes reve të borës dhe qiejve. Dhe ky proces vazhdoi për gjysmë ore.Pastaj u shkund, mori shpejtësi dhe u ngrit në ajër. U dëgjua më pas zhurma e mbylljes së rrotave. Gruaja shihte akrepat e orës dhe më buzën që i dridhej, pëshpëriste e pëshpëriste, ngashërima e lutje bashkë. Befas , teksa vijonte marrja e lartësisë, diçka kërciti në krahët e fluturakut.Ishte ora 24 00.Mes motorëve hyri një shkulmë e madhe ere përzier me borë. Ngjante me një shpirt të bardhë njeriu, i cili, endej gjithë ditën poshtë në tokë, dhe në mesnatë, merrte lart qiejt. I kthyer në një shkulmë dëborë, e bardhë fluturonte në pafundësi. Dhe gjatë këtij fluturimi , na kishte gjetur e takuar në atë avion, në atë pikë të qiejve, . Avioni nisi të dridhej fort dhe gjithë udhëtarët, përfshirë dhe mua, i zuri paniku.

“Po kalojmë mes turbulencave, të paparashikuara. Ju lutem qëndroni lidhur në sedilet tuaja, derisa kapiteni të heq shenjën e kuqe të rripave të sigurimit”, u përcoll nga altoparlanti zëri i shqetësuar i stjuardesës.

O zot... ..! O shpirt, gati bërtiti me zë të lartë, gruaja

-O nëna ime, që nuk të putha dot dot për herë të fundit!

Shkulma e erës e mbushur me borë e aromë të çuditshme u fut brenda avionit duke krijuar gjëndje të pakuptueshme. Mund të them se rashë në një gjendje që nuk e shpjegoj dot.Njësoj si dikur kur isha fëmijë , Dhe një ditë mes etheve të forta, nga një sëmundje që se mora vesh nga më erdhi, më ra të fikët pranë arqes prej druri të gjyshes time.Dimër dhe verë, ajo mbante aromë molle. Njësoj si atë ditë, brenda asaj kllapie sugjestionuese , të krijuar nga ajo shkulmë ajri me aromë të çuditshme, që sdi se si u fut aty në avion, unë u gjenda në një kopësht me bar jeshil, të korrur bukur, ku një puhizë ere, çelte lule të bardha edhe në ajër.Nuk kisha peshë. Kur ecja, gati fluturoja. Isha zvogëluar e kthyer një fëmijë i vogël, që e mbante prej dore një nënë. Këtë radhë e veshur me çitjane shumëngjyrëshe që çuditërisht, ngjante me gjyshen time Mbaja veshur, një kostum sportiv pambuku, atlete dhe xhakavento ngjyrë bojëqielli. U nisa nëpër një rrugë kalldrëmi, dhe iu shpërndaja njerëzve, ca gjethe hardhie, mbushur me reçel molle, përgatitur nga dora e gjyshes time. Një moment gjethet më ranë në tokë, I rrëmbeu një shkulmë ere e cila pasi i mbështolli rreth vetes, u nis në hapësirë, duke u fashitur ngadalë nga faqet e mia. Nuk di se ku gjeti rrugë, në atë rrugicë kalldrëmi, për të ardhur aq shpejt dhe ikur po me nxitim, njësoj si ajo shkulmë ere ardhur dhe njëkohësisht ikur në mënyrën më të çuditshme nga barku i avionit.

“Zotëri, çfarë dëshironi të shijoni”, pyeti një zë i ëmbël. Ishte stjuardesa.

U përmenda.

“Nuk ka mëëë...?” pyeta i habitur..

“Ka ujë, kafe, pije freskuese, çaj”, u përgjigj ajo

“Ujë dhe kafe ju lutem”.

Hodha vështrimin përpara ku qëndronte gruaja me fëmijën.

Ajo vijonte të dëneste, ndërsa përpiquej të ndante në dy pjesë, një mollë. Unë ndihesha i trazuar. Ndjeja brenda vetes vorbulla si prej ere përzier me borë. Avioni po udhëtonte drejt aeroportit të Tiranës.

Kjo poezi është shkruar për të nderuar poetin Arthur Rimbaud si edhe të tjerë si ai, poetë të mëdhenj, të ndaluar, jo për të stigmatizuar botimet e një kohe pasi për to, siç dihet, kam shprehur respektin tim në esenë Jeta dhe libri. Por botime të dobëta ka pasë atëherë e ka edhe sot, them, jo më pak. Ndryshimi është se atëherë dobësitë vinin nga fuqia e pushtetit, kurse sot vijnë nga liria.

TRI TERCINA PËR TË NDERUAR RIMBAUD-NË

Jam në një hije me një libër në dorë
Mendime, kujtime më vijnë si dridhje dheu
E gjitha kjo ka lidhje me Rimbaud-në

Ç’luzmë m’i trazon poshtë nën kafkë flokët
si dikur ndër përroje zallit të djegur
kur shkoja rënduar nën diellin e zhegut?

A mos shpirtrat e zogjve i lënduam me
shokët
ndërsa shuanin etjen ujërave të sheut?
-Jo, janë orët që ke vrarë kur lexoje
mediokrët!

1993/2023

Një shtesë shënimi për më të vëmendshmit:

Me sa duket, kjo poezi ka në vete një lëndë të fortë, të pakonsumueshme nga koha pasi jam marrë disa herë me të. Te përmbledhja “Nga dëshira për të jetuar”, kam paraqitur një variant të ripunuar të saj por në botimin e parë te libri “E pamundura”, 1993, poezia fillon me këto vargje:

*Lexoj Rembonë dhe sikur e shquaj
Te megjulla gri mbi pyllin e zi*

Për mua, janë disa gjëra si kjo këtu, dhe si kjo poezi, që përbëjnë argumentin e të qenit tim poet.

Më duhet të them gjithashtu se kjo, në atë kohë, nuk vinte nga ndonjë njohje e madhe e veprës së poetit francez, por ajo pak njohje ka mjaftuar për të më dhënë impulsin më të fortë poetik ndër të gjitha leximet e mia deri atëherë, e më pas, deri sot

Kjo poezi është botuar te libri “Zogjtë e perëndimit”, 1995. Nuk është përfshirë në përmbledhjen “Nga dëshira për të jetuar”, 2020.

PËR T’MË KUJTUAR MUA

S’e kam parë kurrë Parisin
ëndrrën udhëtare në botë
me urën Mirabo mbi Senë
dhe imazhin e Rembosë,

dhe me një çift pëllumba natyrisht
majë më majë çatave
për t’më kujtuar mua thirrjet e fëminisë
buzë lumit të vendlindjes.

1995

Kjo poezi është shkruar, dhe gjithashtu botuar, më 1995 te libri “Zogjtë e perëndimit”. Aty mban titullin “Dita që perëndon si shpresë”. Por botimi i parë, nuk është përfshirë në përmbledhjen me titull “Nga dëshira për të jetuar” ndërsa tash, këtu kemi një variant të dalë nga ripunimi i saj. Motori që ka vënë në lëvizje të shkruarit

Sokol Zekaj
RRETH NJË ARTI POETIK
Poezi



e kësaj poezie, gjithmonë ka qenë dëshira për ta nxjerrë këtë personazh vezullues të eposit nga skematizmi folklorik dhe për ta sjellë më pranë natyrës njerëzore, përmes mjeteve të poezisë që garantojnë një lexim të këndshëm, një kënaqësi estetike dhe shpirtnore.

KANTATË PËR TANUSHËN

Mjalt dhe helm, Tanushë, kjo kupa e jetës vashë me qerpikun si krah’ i dallandyshe ti që të shoh
me gishtat e hollë mbërthyer në shkëmb
si një meduzë e flakur nga deti,

Oh! Ti je e flakur nga fati
e flakur nga mamë dhe atë
nga shtëpia ku linde
nga porta e madhe prej ku
të qe shfaqur bota me më shumë ngjyra
se lulet që të vareshin ndër dritare
Kush je ti?
Njëfarë Helene por më afër zemrës–

Ndërsa i dashuri yt pret në pranga
mes një ushtrie që dëgjohet
ma shumë se shihet-
e tërhuzët, nën shtylla dhe zjarre-

Dhe dielli që larg perëndoi
në det / la në qiell
një hanë vezulluese / si një kamë
me majën te zemra jote...

Por ja: një erë e artë t’i trandi hijet
dhe një zog i beftë ta përshkoi ajrin

dhe një zë t’u dha mbi shkamb
me lahutën e detit:

.....
Ku e ke n’oren mori hanë
Ku e ke n’oren mori zanë
.....

Pra, hiqe atë gur nga qafa si zambaku

dhe gjoksin mbushe plot me lulet e bregdetit
dhe lulet lagi me lotë krahnor
si yjet që muzgut bien në det

a si mendimet kur pikojnë të arta
nga një zemër në plagë dhe dashuri
që prapë jetën e ndjen si detin
e pamatë që shëron vetveten
se e bekuar është dita që perëndon në besim
qoftë dhe pa e ditë te kush a në çfarë...

RRETH NJË ARTI POETIK

Duhet me u ndie plot emocione jete
për me u ndie plot poezi
si kova në shi nën një strehë shtëpie.

*
Kush e lexoi vërtet poemën
ndjeu që nuk e mori thjesht me sy
as thjesht me mendje
por me të gjitha poret e qenies
siç marrim erën e detit
në port, natën
tek presim anijen që po afrohet
ndër vezullima
dhe do na sjellë njeriun e dashur.
*
Në rrugë qytetesh
unë eci shpejt
se e di që nuk i gjej
ato çfarë kërkoj

Në rrugë fushash
shkoj penguar
në një panair vegimtar
gjërash që më ofrohen

Por në kthim... unë...
njësoj, duarzbrazët...
I them vetes: Banka e Poezisë

është kudo dhe askund...
...Vonë vë re grimca ari
që, pa e ditë, i paskesh’...

Në fushën e lulëzuar të poezisë

ndajfoljet vegjetojnë në hije metaforash
si bari i keq në hijen e një peme!

U mblodhën fjalët e një poezie
të binin dakord për kuptimin...
Por, sa nazelie
këto fjalët e metaforave!

Shkrova një poezi dhe dola i kënaqur
se pashë që isha i qetë
pa asnjë shqetësim se ç’do të ndodhte me të
se ç’do të bënte vetë kjo
në botën e panjohur të Poezisë
ku ndodhin të gjitha fenomenet e
Natyres...
Ajo thjesht u shkrua dhe do të mbetej
përgjithmonë
në jetë të jetëve
që janë së paku sa jeta ime

Kështu, tash mundesh me shkue poezi
me iu qasë botës se je e saj
dhe unë me qenë vetëm me veten
pa rëndësi dhe pa vëmendje

si lëvoret e portokallit mbi tryezë
si këmisha hedhur në shpinën e karriges
si buzëqeshja që ia dhuruam ditës
teksa ajo po zbardhte

a si ironia e harruar
mbetë në cepin e buzës
gaztore a idhnake

një dite atipike të një stine-
një pupël e pakapshme drite
e zogut të jetës...

E mblodha këtë natë
në dorë,
e hodha në gotë
dhe aty ranë drita, hije, yje, hënë
pa fjalë, dhe yje që këputen
Dhe piva gjithë i qetë
por plot përfytyrime
pak nga pak gjithë natën

deri sa zbardhi
mbi male e në shpirt
dhe gota tingëlloi me ditën!...

Nëse për natyrë, mendimi
teksa ndërrohet trajtë, të jep lodhje,
tjetër shfaqet frymëzimi
si një burim te një gurore.

Kush po kthehet në vendlindje
gjendet në këto rrethana, thotë Mjedja:
Bylbylat po e marrin me vedit!-

Si ti që merr një libër poetik në duar,

Nganjëherë metaforat dalin nga poezia
duke shkundur dritë dhe ngjyra
si rosat kur dalin nga pellgu
dhe shëtisin lëndinës së së gjelbëruar.

2023

JETË BALADASH

Nëse je ulur n’anë liqenit
me një libër poemash në shpirt
dhe sheh tri gra veshur në të zeza
tek hedhin valëve trëndafilë

ty do t’kujtohen varkat pas mesnate
nën sy dritash të paqeta shtëpive
dhe si velë e hollë një melodi balade
që në dritë qielli valëve ua përkëdhel
kurrizin

Atëherë poemat që shkrove dikur për liqenin
kanë me të shkëlqye në idhnim,
ndërsa vetima kregce ta përshkojnë zemrën
si në shiun që bie mbi një trëndafil.

2021

LULET E NJË RRUGE

Lulet në rrugën e xhamisë Ebu Beker
kanë formë zemre
dhe kanë aromë librash të vjetër
ndërsa lexohen si rubaira persiane

2008

KOPSHT

Kaltërsia kundruall
Dhe dridhja në shpirt

Dhe freskia që shëtit mes pemëve
Dhe qetësia përkul’mbi libër
Balli i bekuar

Dhe shenjtnia e dallëndyshes
Pranuar pa kureshtje

Si Vdekja e panjohur

2008

NJË DITË VJESHTE

Jam në një bar. Ditë vjeshte
mendoj një poezi
Drita jashtë asht e mugët
se asht vranët. Bie shi

Por tej rrugës, nj’argjendari
shikimin ma ka kapur
tekta shkëlqen dhe farfurin
e gjitha një brilant i hapur

2022

PËR NJË VDEKJE

E mora atë emër
në dorë,
e shkrova në një guacë
hidhërimi
dhe
e hodha errësirës
kah yjet

Tash kujtoj si përgjoja
dritares
tingullin që hapej
tekta një anije
çante ajrin
asaj nate
me qiell të kulluar

JETA JONË

Jeta jonë është si frutat e shtrenjtë
me më shumë se një shije
Në do e kërkonim me një shije t’vetme
do mund t’na dilte një frut i hidhtë

Suad Arilla
ZANAFILLA
fragment romani

I vogël, je dikush që nuk llogaritesh. I madh,
je dikush që i ke humbur pritshmëritë e
të tjerëve.

Me t’u zgjuar, Rexhi doli jashtë. Ishte
herët dhe pak njerëz dukeshin. Hodhi
vështrimin andej nga kishte qenë shtëpia
e prindërve: aty gërmadha e shembjes së
shtëpisë, ishte kthyer në një pirg të çrregullt
dheu dhe gurësh. Kjo nuk e habiti, edhe pse
do donte të shihte atë shtëpinë ku ishte
rritur dhe për të cilën i kishin thënë se ishte
shembur.

Gurët, blloqet, muret, trarët, tjegullat
nuk kishin zënë vetëm mobilie të vjetra
dhe të papërdorshme, por edhe një
grumbull kohe që kishte përfaqësuar jetën,
mbijetesën dhe kujtimet e pafajësisë. Aty
poshtë, e padukshmja kishte pasur një vlerë
kaq thelbësore dhe të gjallë, saqë tashmë
as njerëzit e gjithë botës nuk mund ta
zëvendësonin. Ashtu të përkulura dhe pa
mbrojtje përsipër, ajo frymë ishte ngjitur
lart në qiell dhe, jo se kishte humbur, por
nga një llogore tjetër jeta nuk mund të ishte
e njëjta.

- Qenke zgjuar herët, nipçe.

Rexhi u ndie si i zënë ngushtë dhe vetëm
e përshëndeti xhaxhanë. Shkuan në kuzhinë
të hanin diçka dhe shumë shpejt u gjenden
në kafene. Adani nisi një bisedë që lidhej me
shtëpinë e rrënuar.

- Shtëpia e vjetër pësoi krisje prej
tërmetit, fill pasi ike ti. Kush e mendonte se
ajo kurrizdalë do të thyhej përgjysmë! – dhe
heshti një grimëz, ndërsa kamerieri u solli
kafetë. – Por unë s’të nguca më tepër, prej
merakut që more me vete në ikje. Aq shpejt

dhe aq me nerva. Prindërit janë humbja e
vetme që sa herë na vijnë ndër mend, janë
të paplotë. – Dhe qeshi pak. – Mua më del
në ëndërr ndonjëherë im atë pa njërin sy,
hahahah.

Rexhi nuk i ndërhyri. Xhaxhai ishte
figurë komplekse, shpeshherë arrakat,
por në thelb njeriu që mbart mbi shpinë
një amanet. Të lidhur fort me tokën. Ndaj
sa here kishte menduar për xhaxhanë,
gjithmonë i kishte ardhur ndër mend
vetëm një copë tokë pjellore e lënë djerrë.
Përreth tyre vendi po mbushej. Ata të
dy herë buzëqeshnin si përpjekje e një
bashkëdakortësie për të vazhduar, here
shihnin rrotull si për të kërkuar njëfarë
kurioziteti të jashtëm. Adani, ndonëse jo
edhe aq krenar, kishte nevojë të tregonte
që ai trupmadh ishte i nipi. Ndërsa Rexhi,
me drojë përpëlitëse, e tundte kokën në
kërkim të ndonjë fytyre që kujtesa të mund
t’ia përngjasonte një kohe të largët dhe të
zbehtë. Por asgjë nuk ndodhi. Nuk dinin ç’të
flisnin, shikimet mes tyre ngjanin si grerëza
në ajër.

Pasi dolën në rrugë, Rexhi vendosi të
bënte një shëtitje në lagje. I vetëm hidhte
hapat dhe gjithçka i dukej e ftohtë dhe e
zymtë. Një vend ku jeta merr tjetër kuptim.
Herë pas here, ndonjë derë, mur, shtëpi,
kthesë a rrugë e ngacmonte dhe e kthente
pas në vitet kur gjërat nuk kishin qenë si
tani - të palëvizshme - por të gjalla dhe të
mbushura me frymë. Tani vetëm hiqnin
frymë. Ose, disa prej tyre, rrinin mbroth,
hijezonin të njëjtën atmosferë jete dhe nuk
nguteshin t’i sillnin një kalimtari si Rexhi,

diçka për të cilën s’kishin qëllime. Ndonëse
sillte diçka ndër mend, preferonte të rrinte
indiferent ndaj së shkuarës. Rexhi vetëm
përpiqej t’i shihte ato gjëra si për herë të
parë, me njëfarë habie të atypëratyshme.
Por sa u sillte shpinën, ato vende të njohura
menjëherë ktheheshin në humbëtira,
spiranca që e zhysnin në një indiferentizëm
të lëngshëm. Ai zhytej aty dhe notonte me
shumë kënaqësi. Ndërsa në kujtime ndihej
i vogëlth.

Në vendet që nuk i njihte filloi të ndihej i
lumtur, gati fitimtar. Syri mund t’i pushtonte
dhe asgjë në zemër s’do të vihej në lëvizje
për të mbajtur ekuilibrat. Ndonëse kthimi
mbarte nostalgjinë, aromat e vjetra, shijen
e fëmijërisë, për Rexhin ky nuk ishte i tillë. Ai
kishte ardhur të gllabëronte, të merrte çfarë
ishte tija dhe t’u tregonte njerëzve qoshen e
tyre. Ai ishte aty për të treguar veten që kishte
ndërtuar. Dhe ky rrëfim niste nga një kërkim.

“Pa shiko, – tha me vete, – jeta është një
kafaz që zbut egërsira. Shoh këto gjëra që më
ngajnë me disa ëndrra të bukura, por thellë
më vrasin. Njeriu që isha njëherë s’mund të
kthehet këtu kaq haptas, kaq papritur, kaq pa
qëllim. Diçka brenda meje më kërkon ta nxjerr
përrjashta. Por asgjë e jashtme nuk më thotë si ta
bëj këtë. Këto vende të njohura vetëm më bëjnë të
mbaj përbrenda atë që kam. Ta ushqej nga pak
si një kafshë të vogël e ta lë të rritet. Mbase e tillë
do mund të vendosë vetë mbi fatin.”


Vendet e panjohura rendnin njëra
pas tjetrës dhe Rexhi kuptoi se kjo ishte
gjëëgjëza e jetës që po vinte: koha ishte
vetëm iluzion, realiteti kishte rëndësi. Ku
ndodhej, kur dhe pse, ishin vetëm shkaqet
e natyrshme të së tashmes, të çdo minute
që rrjedh, të çdo dielli që perëndon. Ndaj
imazhet që shihte ishin pjesë e rëndësisë,
gjëëgjëzë e së vërtetës. Dhe të gjitha këto
kishin rëndësinë thelbësore e të bërit pjesë
në qerthullin vetëmohues, ku në fund
shpërblehej me çdo pikë të gjakut në zemër.

Ato imazhe, mendonte Rexhi, nuk kishin
qenë aty përgjithmonë, por ngriheshin dhe
uleshin, lëviznin, e bashkë me to edhe
njerëzit, sendet, ëndrrat, të dukshmet e të
padukshmet. Prandaj, sa herë kthehej në
një tjetër sokak të panjohur, ngadhënjehej
dhe përpiquej të fitonte lirinë që i shërbehej
hap pas hapi në grimca apo thërrime. E
mblidhte dhe e kapërdinte atë liri. Jo në
stomak, ndonëse e gëlltiste dhe përtypej
në çdo ecejake. Liria i shkonte diku në një
lidhje të fortë, të fshehtë, mes zemrës dhe
mendjes. Aty merrte formë, si një enigmë e
copëzuar. Nuk ishte dosido, por ishte liria
që përfntonte vetëm në vendin e kthimit. Në
vendet e panjohura. Vendet e njohura vetëm
e kishin zhytur në guaskën e ikanakut.

Ndërsa ajo enigmë endej në atë qark
të shkurtër, kuptonte se edhe ky qytet, me
të apo pa të, kishte tjerre lirinë e vet. Një
merimangë e zezë helmuese. Me trupin me
toptha blu. Ishte përpjekja për të dalë përtej
së tashmes. Ndërsa Rexhi e shtynte qenien e
vet drejt çdo të tashme.

Kur më në fund u ftillua, nuk njihte
asgjë. Ky moment ishte si një ëndërr. Aty
ai ishte njëfarë zoti që bëhej i paprekshëm,
fitonte respekt dhe të tjerët i frikësoheshin
vetëm duke e parë. Kalonte hijerëndë, me
trupin të kontraktuar, dhe shikonte se si
njerëzit kalonin poshtë tij dhe e humbnin
shikimin. Një gaz i vloj përbrenda se ai ishte
një njeri i ri. Aty mund të krijonte imazhin e
vetes ngritur mbi rrënoja.

Të humbur në mejtime, këmbët e sollën
para një ndërtesë të madhe. Ishte e gurtë,
e lartë, e mbyllur si katakomb. Patjetër që
ishte imazh më i egër se i trupit të tij, sepse
Rexhi iu ngërdhesh që të mos i frikësohej.
Iu duk kaq shterpë ajo godinë. E, ndoshta,
vetë kjo pikë e dobët ishte pika e fortë:
mekanizmi i mbrojtjes krijon te njeriu
ingranazhe aty ku mund të rikuperojë.



ETËR, BIJ DHE PYLLI

Djali erdhi nga thellësia e pyllit duke vrapuar dhe u shtri menjëherë mbi barin e thatë. Ai nuk po ngopej dot me frymë dhe ata të dy, burrë e grua, panë si ulej dhe ngrihej kraharori i dobët i tij. Gruaja u mat ta përkëdhelte duke ia marrë kokën në prehër, por nuk e la burri. Djali më shumë se i trembur dukej i pezmatuar. Burri ia nguli sytë fytyrës së djalit dhe dalloj në shprehjen e saj diçka të afërt me zhgënjimin.

Drita po thyhej në pyll dhe pishat u dukën më të vjetra sesa ishin në të vërtetë. Pasditja kishte ngrirë e gozhduar nën diellin e gushtit dhe dukej sikur nuk do të lëvizte ndonjëherë. Ndërsa në pyll filloi të fryjë një erë e lehtë. Për burrin gjithçka që jetonte mes pyllit ishte e njohur. Kur kishte qenë i vogël, ndoshta më i vogël apo në moshën e djalit, vinte shpesh me të atin në atë pyll me pisha. Sot ai kishte sjellë këtu të birin. Kishte çaste kur kjo e habiste dhe i dukej e pabesueshme. Nuk kishte mundësi që kishin kaluar tërë ato vite, sepse pylli ishte po ai i njëzet viteve më parë, aroma e halave të pishave po ajo e njëzet viteve më parë dhe zhurmat që nuk kuptoheshin nga vinin, ishin po ato të njëzet viteve më parë. Pylli kishte diçka të pandryshueshme, të përjetshme. Burri nuk e gjente dot se çfarë e bënte pyllin të dukej i pandryshueshëm dhe i përjetshëm. Dhe ai tha, për të mos qëndruar i heshtur, se e përjetshme ishte pikërisht thyerja e diellit të gushtit nëpër kurorat e pishave dhe kthimi i viteve pas, kur ai kishte ardhur këtu për herë të parë. Burri mbarte brenda vetes moshën që kishte pasur, kur kishte ardhur me të atin.


Burri vështroi të birin, frymëmarrja e të cilit ishte qetësuar, por në sytë e tij kishte mbetur ende, si një mjegull e bardhë, shprehja e zhgënjimit që ishte shfaqur, kur kishte ardhur me vrap nga thellësia e pyllit. Djali nuk dinte t'i fshihte zhgënjimet. Vështrimi i tij i pafajshëm, u ngul në fytyrën e të atit. Ai u përpoq të gjente aty përgjigjen e asaj që nuk kishte gjetur në thellësinë e pyllit. Burrin e tronditi vështrimi i djalit dhe u përpoq ta kalonte duke bërë shaka, por e përmbajti veten. Djali do të prekej dhe do kërkonte të largoheshin që atë çast nga pylli. Burri nuk donte ta pranonte që tërë atë zhgënjim ia kishte shkaktuar djalit pylli. Sepse ai e donte pyllin. Sepse edhe babai i tij e donte pyllin. Ai dëshironte që edhe i biri ta donte pyllin. Ai e dinte se në atë dashuri kishte diçka të heshtur, të thellë, të cilën vetëm mund ta ndjeje, sepse ishte e vështirë ta shprehje. Burri ishte munduar gjithmonë të gjente se çfarë fshihej pas tërë asaj dashurie për pyllin, por mbulohej përherë nga kujtimet e viteve të largëta. Ato nuk e linin të qetë. I kujtohej kur së bashku me të atin kërkonin luleshtrydhe nëpër shpatet e mbuluara nga fieri dhe rriheshin nga dielli. I kujtohej gëzimi që kishte ndjerë kur pa ketrin e parë që kërcente nga dega në degë... Kur e kishte parë ketrin e parë?... I kujtohej nëna që i përkëdhelte flokët duke i treguar me dorë varrezat e fshatit rrëzë pyllit me pisha. Aty nëna kishte gjyshin e saj. Pastaj i kujtohej dita kur i ati i tregoi se çfarë ishte për të pylli.

Kishim ditë që udhëtonim nëpër pyll. Ishte Lufta e Parë. Ishim nisur nga Babica e Vlorës për te një kushëri i largët në Dishnicë të Korçës. Nuk kisha mbushur dhjetë vjeç. Në pyll ecja vetë. Nëna sa vinte dhe dobësohej dhe vetëm rënkonte mbytur që të mos e dëgjonim. Atë vit kishte rënë tifoja dhe vdiqën shumë njerëz. Babai na mbante me shpresë. Edhe pylli sikur na e hiqte lodhjen dhe na e largonte mendjen nga sëmundja e nënës. Ne e dinim se ajo do të vdiste, por nuk donim ta prananim. Ecnim, sikur

Nasi Lera

ETËR, BIJ DHE PYLLI

dy tregime



po të mbërrinte gjallë në fshatin me emrin Dishnicë do shpëtonte. Por Dishnica nuk po dukej gjëkund, si të ishte fshati më i largët dhe më i thellë i botës. Më në fund arritën në Makërz të Vidhkuqit, te pylli i tij. Aty nëna nuk kishte forcë as të rënkonte. Dhe vdiq. E varrosëm të katër: babai, vëllai, motra dhe unë. Mbaj mend që motra qante dhe thoshte se nuk donte që ta linim aty nënën. Nuk do ta lëmë, thoshte babai. Ai qante pa zë. Kur do vijmë ta marrim, tha motra. Unë dhe vëllai nuk flisnim. Nuk kishim parë ndonjë të vdekur. Dhe nuk donim ta besonim se nëna kishte vdekur. Nguliteni mirë në mendje këtë vend, që të mos e harrojmë, tha babai. Nënë e varrosëm në një lëndinë të vogël të rrethuar nga pishat. Kur u larguam lëndina të tilla pamë kudo. Por neve na dukej se lëndinën ku varrosëm nënën nuk do ta harronim kurrë. Sepse njeriu nuk i harron vendet ku ka varrosur njerëzit e tij më të dashur. Dhe njëri më të dashur se nëna nuk ka. Varri i nënës ishte i thjeshtë, shumë i thjeshtë. Atë e mbuloi dëbora e parë, shiu i parë dhe kush e ka parë pa e mbuluar bari ka qëndruar dhe

ka ndjerë se ai varr kishte brenda një dhimbje të madhe, dhimbjen tonë.

Ne nuk e harronim lëndinën e vogël mes pyllit me pisha të Makrëzës. E shihnim në ëndërr. Shkuam pas tre vjetësh. Nuk e gjetëm dot. Lëndinat ishin njëlloj dhe nëna mund të ishte varrosur në secilën prej tyre. Pylli ishte i ngrysur. Si t'i vinte keq që nuk fliste dot. Vetëm ai e dinte ku ishte varri i nënës. Edhe zhurma që bënte pylli më ngjante me një ngashërim burri. Uuuuuu! Uuuuuu! Babai nuk fliste dot. Me siguri mendonte se vetëm ai dhe askush tjetër ishte fajtor që nuk e gjetëm varrin e nënës. Unë edhe në gjumë dëgjoja herë pas here u-në e dhimbshme të pyllit.

Ne shkuam pranverën tjetër, por përsëri nuk e gjetëm dot lëndinën. I humbëm përfundimisht shpresat. Por para se të dilnim nga pylli në rrugën e makinave, babai u ndal dhe na tha: S'ka gjë. Ajo është në pyllin me pisha të Makrëzës. Dhe ju e dini që pylli me pisha është gjithmonë i gjelbër. Dhe, megjithëse ishim të vegjël e kuptuam çfarë donte të thoshte me atë që pylli me pisha është gjithmonë i gjelbër.

I ati ia kishte treguar vetëm një herë, por burri e mbante mend shumë mirë. Ai e kishte dëgjuar kur qe i vogël. Dhe ndjeu dhimbje. Dhimbja e lidhi me pyllin. Ajo nuk ishte vetëm dhimbja e tij. Ajo kishte kaluar nga njëri brez te tjetri. Dhe të gjithë e kishin dashur dhe e donin pyllin. Burri donte që edhe i biri ta donte pyllin. Prandaj e kishte sjellë aty ku dikur e sillte i ati.

Djali i vogël nuk ia ndante vështirimin thellësisë së pyllit. Ai ndjeu dorën e të atit që po i përkëdhelte flokët. Dhe u prek. U bë gati të fliste por nga frika se mos qante nga zhgënjimi që i kishte shkaktuar thellësia e pyllit, ngjeshi kokën në prehër të nënës. Burri ia nguli sytë dhe përsëri iu kujtua diçka e largët. Sot atij çdo gjë i kujtonte diçka të largët. Kujtimet ishin si erërat që fryjnë në pyll. Secila ka aromën e vet. Ato treteshin pak nga pak dhe atë e pushtonte kujtimi i nënës së tij. Nëna, e thinjur, e rritur me mallin e përhershëm për erën e pishave dhe ujin e ftohtë të burimeve.

- Jo vetëm mua por të gjitha vajzave që ishin moshatare me mua na pëlqente Çezma e Floririt. Përse? Nuk e di. Voskopoja kishte edhe burime të tjera me ujë më të ftohtë dhe me vende më të bukura. Por vetëm kur shkonim aty zemra na rrihte ndryshe dhe se pse na pëlqente që aty rrihte ndryshe. Prandaj dhe shkonim shpesh aty. Kot fare. Uji i burimit humbiste poshtë në një përrua të vogël. Në dimër burimin e mbulonte dëbora e madhe që binte. Sipër burimit mbetej vetëm një e çarë që na dukej si sy. Tek ai sy shihnim veten tonë. Ishim vajza. Kur vinte pranvera, pa u errur, shkonim një herë nga burimi. Nën ujë feksnin disa gurë të verdhë. Sidomos kur kishte shumë yje dhe hënë. Thoshin se ato ishin lotët e hënës. Dhe ne e besonim. Ishim vajza. Në atë moshë vajzat besojnë çdo gjë. Para se të largoheshim pinim ujë. Uji na dukej sikur kishte tjetër shije nga uji që kishim pirë kur kishim ardhur dhe na jepte një zjarrmi në gjoks. Donim t'ia tregonim njëra-tjetrës, por na vinte turp. Ishim vajza.

Dhe kështu deri sa u fejova me babanë tënd. Yt atë ka qenë gjithmonë një djallë dhe një burrë i ndershëm. Kur u bëra nënë i thashë të më çonte në Voskopojë. Më çoi. Shkuam drejt e te Çezma e Floririt. Ajo nuk kishte ndryshuar. Rridhte dhe uji humbiste te përroi fare i vogël. Lotët e hënës nuk kishte shterur ende. M'u mbloodh një lëmsh në gjoks. Çfarë ke, më pyeti yt atë. Asgjë, i thashë. Por nuk e gënjeja dot. Dhe i thashë se më merrte shpesh malli për burimin. Përse nuk ma ke thënë, më tha yt atë. Më vinte rëndë, sepse lodhesh tërë ditën në punë, i thashë. Nga unë të vinte rëndë, u habit yt atë. Që nga ajo ditë më sillte këtu. Dhe sikur na shtoej përherë dashuria. Këtë yt atë e kuptonte, se ishte burrë i ndershëm.

Burri e kishte dëgjuar vetëm një herë nga nëna e tij dhe e mbante mend shumë mirë. E kishte dëgjuar kur ishte djallë. Dhe kishte ndjerë tërë poezinë e saj. Dhe kuptoi se ajo dashuri e lidhi më fort me burimin përballë pyllit me pisha. Dhe përsëri tha se njerëzit lidhen me tokën dhe pyllin vetëm kur dridhjet e zemrës janë dridhje që janë përcjellë nga brezi në brez. Ndaj e donte pyllin. Ndaj donte që edhe i biri ta donte pyllin. Ndaj e kishte sjellë sot këtu.

Djali i vogël ia nguli sytë burrit dhe i tha:

- Unë shkova shumë thellë në pyll.

- Dhe nuk kishe aspak frikë? – ndërhyri nëna.

- Jo, - tha djali i vogël. – Kudo pylli ishte njëlloj, si këtu.

Burri nuk po ia ndante vështrimin të birit.

- Si të ishte? – tha ai.
- Aty nuk kishte as ujq, as arinj, as sorkadhe. Ishte po aq qetë sa këtu.

Burri nuk iu përgjigj menjëherë. E mori me mend se djali i vogël nuk e kishte pasur të lehtë rrugën drejt thellësisë së pyllit. Djalit të vogël iu desh të ndeshej me frikën dhe përfytyrimin e tij për pyllin. Ndeshja me frikën nuk mund të kalonte pa lënë gjurmë. Ai e kishte mposhtur frikën, por nuk ishte shpërblyer si kishte menduar. Dhe ndjeu zhgënjimin që nuk e fshehu para prindërve.

- Ç’do bëje sikur të kishte dalë para ariu?
- pyeti djalin e vogël burri.
- Do ta vrisja, - tha djali i vogël.
 - E pastaj?
 - Pastaj... Pastaj... asgjë. Ky nuk është pyll i vërtetë sepse nuk ka kafshë të egra, ky është pyll i butë.

Burrit i erdhi për të qeshur.

- Jo, - tha ai, - ky është pyll i vërtetë.
- Nuk është i vërtetë, është pyll i butë.

Po ta dija se do më sillje në një pyll të butë nuk do vija.

- Po ky është pyll i vërtetë! – tha gruaja.
- Jo, - ngulmoi djali i vogël. – Unë shkova shumë thellë dhe nuk më doli para asnjë kafshë e egër. Kafshët e egra jetojnë në pyje të vërteta.

- Ato janë trembur nga ti, - tha burri.
 - Vetëm lepujt tremben, po jo arinjtë.
 - Ariu po fle, - tha burri.
 - Po ujku?
 - Edhe ujku.
 - Po dhelpra dinake?
 - Edhe dhelpra.
- Djali i vogël heshti i menduar.
- Ky nuk është pyll i vërtetë, gjersa të gjitha kafshët e egra po flenë. Kafshët e egra ditën kërkojnë ushqim.
 - Do t’i shohësh kur të vijmë herën tjetër,
- tha burri.

- Unë nuk vij më këtu, - tha i vendosur djali i vogël.

Burri e donte pyllin dhe donte që edhe i biri ta donte atë. Ai e dinte se zhgënjimi në moshën e të birit linte gjurmë. Dhe burri do të mërзитеj sikur i biri të mos e donte pyllin që donte ai.

- Ti do ta duash këtë pyll, - tha burri.
- Përse do ta dua? – tha djali i vogël.
- Sepse e dua unë, - tha burri. – Dhe ti e do shumë babanë tënd.
- Po, - tha i hutuar djali i vogël dhe hovi papritur dhe përqafoi të atin. – Vetëm më vjen keq që nuk ka kafshë të egra.

Burri ia mori fytyrën me të dyja duart dhe vështroi serioz të birin.

- Ka, ka. Ato duhet të jenë fshehur diku, por ky pyll ka diçka tjetër më të madhe, që nuk e kupton dot tani.
- Përse nuk e kuptoj dot tani?
- Sepse je i vogël.
- S’ka gjë që jam i vogël, ma thuaj, - u lut djali i vogël.

Burri heshti. Ai mund t’i thoshte veçse njeriu lidhet me një vend, me një pyll, me një burim, kur brenda tyre është një dhimbje dhe një dashuri e madhe. Dhimbja dhe dashuria ishin lidhja më e natyrshme, më e thjeshtë dhe më e përsëritura. Ai nuk mund të thoshte veçse ajo ditë po futej pa u kuptuar prej tij në dashurinë që kishte për prindërit. Por burri e ndjente se nuk ia thoshte dot aq thjesht sa ta kuptonte i biri. Ndërsa i biri priste. Sa më gjatë të heshte burri, aq më i madh do të ishte dhe zhgënjimi i fëmijës. Dielli ishte ulur më në perëndim. Rrezet futeshin midis drurëve duke shqetësuar jetën e pyllit. Pishat lëshuan një uuuuu të lehtë. Burri u prek nga zëri i pyllit, i cili do të vazhdonte më i fuqishëm natën, kur edhe era do të ishte më e fortë. Burri nuk po i përgjigjej të birit, që priste. Dhe burri tha se sido që t’ia shprehte lidhjen e tij me pyllin, i biri do ta kuptonte. Dhe i tregoi... Kur mbaroi së treguari, djali

i vogël e vështronte i menduar dhe nuk fliste. Burri nuk po duronte sa të dëgjonte çfarë do të thoshte i biri. Por djali i vogël vetëm mendohej dhe nuk dukej se kishte ndër mend të fliste. Burri ishte i sigurt se ajo që i kishte treguar do ta shqetësonte për një kohë të gjatë të birin. Në pyll po bëhej ftohtë. Ata zbritën në rrugë ku burri kishte lënë makinën. Para se të hipte në makinë, djali i vogël u kthye dhe tha:

- Atje është pylli, baba?
- Atje, - tha burri.
- Pylli po fle, - tha djali i vogël duke iu drejtuar më shumë vetes se të tjerëve.

MOS HARRO SE NË KONSTANCË...

... binte shi atë ditë dhe ne e kërkonim njëri-tjetrin nëpër pikat e tij...

Djali doli i mërzitur nga hoteli. Ndjeu ftohtë sepse nuk kishte veshur xhaketën. Të gjithë i thanë ta priste në holl se i ati mund të vinte nga çasti në çast, por atij nuk i rrihej në një vend. Mamaia ishte e shkretë dhe Deti i Zi i hirtë. Era përplaste shiun dhe gjethet e shumta mbi xhamat e autobusëve që dremisnin para hotelit si krijesa të pafajshme dhe të braktisura. Edhe ai duhej të kishte ardhur, tha djali. Ishte dita e tretë që po e priste. Kishte pyetur në të gjitha hotelet. Disa pika shiu ranë mbi fytyrën e tij. Stacioni i autobusëve ishte larg. Edhe qyteti ishte larg. Atë ditë çdo gjë ishte e largët. Tërë fajin e kishte vera. Ata vetëm ishin grindur gjatë saj. Djali donte ta harronte verën, por e kishte të pamundur. Ai u nis vetëm që ne të harronim verën e grindjeve tona, tha djali. Të gjithë erdhën. Edhe ai duhej të kishte ardhur. Moti sa vinte dhe keqësohej.

Djali nuk po e kuptonte përse ndodhej aty pa lëvizur. Atë çast mund të ishte kudo, vetëm aty nuk kishte arsye përse të ishte. Po nuk dinte ku të shkonte. Nuk kishte më forcë t’i merrte përsëri me radhë tërë hotelet e Konstancës, ku po bënte vitin e parë të studimeve. Sa dëgjonte që i thoshin se në hotel nuk kishte zënë dhomë një njeri me emrin e të atit, i priteshin këmbët dhe i kujtohej vera. Ata ishin grindur vazhdimisht gjatë saj.

Para hotelit ndaloi një makinë. Zbriti një burrë që nxitoi të hynte sa më shpejt në hotel. Se në Konstancë binte shi atë ditë dhe Deti i Zi ishte i hirtë. Djali ndjeu se po i qullej këmisha. Me siguri që nuk ka marrë çadër me vete, tha dhe se pse e përfytyroi të atin të plakur. Ndoshta nën shi çdo njeri duket më i plakur. Edhe ditën e ndarjes i ati i ishte dukur më i plakur se kurrë. Ishin ndarë që në shtëpi. Babai donte ta përcillte te stacioni i autobusëve, por ai nuk kishte pranuar. Sepse e dinte se ndarja te stacioni i autobusëve do ta plakte edhe më shumë. Me siguri që ka ardhur pa çadër, tha përsëri. Dhe në Konstancë shiu ishte i ftohtë dhe Konstanca ishte larg hotelit ku djali kishte shpresuar se do gjente të atin. Ai ishte hoteli i fundit në plazhin e shkretuar nga vjeshta. Ajo ditë të kujtonte dimrin. Djalit iu kujtua kur kishte shkuar me të atin në Korçë. Atëherë ishte i vogël dhe aty rrëshqiti për herë të parë mbi dëborë. I ati e shihte kur rrëzohej dhe qeshte. Atëherë as që mund të mendonte se i ati do të plakej një ditë. Ai ishte aq i gëzuar. Dëbora e bënte gjithmonë fëmijë të atin. Pastaj të dy rrëshqitën me një sanë të vogël. Djali mbylli sytë. Nuk donte të kujtonte asgjë që e kthente përtej ditës së sotme. Kujtimet e trishtonin, kur ishte vetëm. Për të fshirë çdo gjë nga kujtesa dhe për të jetuar vetëm me ardhjen e të

atit, doli nga streha e hyrjes së hotelit dhe vrapoi drejt stacionit të autobusit. U qull i gjithi. Edhe ai është pa çadër nën këtë shi. Në autobus kishte pak njerëz. Të stacioni i parë nuk hipi dhe nuk zbriti asnjë udhëtar. Djali nuk e dinte ku do zbriste. As nuk donte ta mendonte. Duke qenë në lëvizje i dukej sikur po ecte drejt diçkaje. Kjo diçka nuk ishte i ati (për këtë ishte i sigurt) por se pse e lidhte me të. Ashtu si lidhej dëbora me jetën e tyre. Ndoshta po më pret atje, tha dhe besoi se ashtu duhej të ishte. Nga padurimi zbriti një stacion para. Nuk u mërzit. Edhe i pëlqente të vraponte edhe kishte frikë të arrinte sa më shpejt. Se mund të gjendej përsëri i vetmuar.

Dhe u habit kur e pa veten përballë përmendores së Ovidit. Poeti iu duk më i trishtuar se kurrë dhe shiu iu duk sikur rridhte nga elegjitë e tij.


...mos harro se në Konstancë atë ditë binte një shi elegjiak dhe ne po e kërkonim njëri-tjetrin nëpër pikat e tij...

Atë ditë djali ngjalli habinë e kalimtarëve. Asnjë njëri nuk kishte qëndruar para Ovidit mes një shiu të ftohtë, vetëm, në këmishë. Por ndoshta asnjë nuk e kishte përjetuar dramën e vetmisë së Ovidit si po e përjetonte atë çast djali. Ndërsa për të gjithë banorët e Konstancës shiu që binte ishte një shi i zakonshëm vjeshte, për Ovidin dhe djalin ai ishte një shi elegjiak. Për poetin shiu kishte filluar të binte para njëzet shekujsh pa rreshtuar për asnjë çast, për djalin shiu kishte filluar verën e atij viti, kur dhe u grind me të atin. Ai mori tërë atë rrugë që të harronim verën e grindjeve tona. Ai nuk kishte për t’u nisur po të mos ishte mes nesh vera. Kur u ndanë babai iu duk më i plakur se kurrë.

Djalit nuk i ikej nga Ovidi. Shiu ishte rralluar, por era ishte bërë më e ftohtë. Dhe pa u kuptuar ishin ndezur dritat e rrugëve dhe kishte rënë mbrëmja. Djalit i dukej sikur Ovidi nuk do ta duronte vetminë e asaj nate, por të largohej dhe ai prej andej. Por ai nuk mund të rrinte më gjatë, sepse duhej të kërkonte të atin, ashtu si i ati po kërkonte të birin. Dhe u largua pa guxuar të shihte vetminë e bronztë të poetit. Kur arriti te teatri i qytetit shfaqja kishte filluar. Luhej një pjesë e Ioneskos. Do pres, tha djali dhe për t’u mbrojtur nga shiu dhe era e ftohtë hyri në një lokal prej nga dukej hyrja e teatrit. Porositi një konjak sepse po dridhej. Po sikur t’i ketë ndodhur gjë rrugës, tha i lodhur. Ai kishte luftuar tërë ditën me atë mendim. Gjithmonë e kishte lënë të përgjysmuar. Tani nuk kishte forcë ta mposhte pa lindur mirë. Djali e ndjeu se çdo përpjekje për të mposhtur atë mendim ishte e kotë. Tërë faji ishte i imi, tha. Dhe iu kujtua kur kthehej vonë në shtëpi, edhe pas mesnatës, dhe gjëja e parë që shihte ishte përshkënditja e cigares që pinte i ati duke e pritur në ballkon. Atë verë i ati kishte pirë më shumë cigare se kurrë. I ndizte njëra pas tjetrës dhe i thithte me tërë mushkëritë.

Mbi qelqet e mëdha të lokalit era ngjishte herë pas here ndonjë gjethe të zverdhur. Për të harruar verën djali kujtoi përsëri dimrin dhe dëborën e Korçës. Natën i futej në gjoks të atit dhe aty e zinte gjumi. Kur u rrit shkonte shpesh në Korçë te gjyshja dhe gjithmonë jetonte dëborën e parë. Djali tha se atë dimër dhe atë dëborë nuk do t’i harronte kurrë. Ne duhej të kishim vetëm atë dimër dhe atë dëborë, tha. Porositi dhe një konjak tjetër. Dritat para teatrit ishin të zbehta. Djali nuk shihte orën. Nuk donte që shfaqja të mbaronte. Ai do të priste aty, te lokali, përballë teatrit.

Dhe ajo që ishte më e pabesueshme dhe më e habitshme ishte se jashtë nuk po binte më shi po dëborë. Ishte një dëborë e largët që nuk e shihte kush, përveç djalit. Ajo vazhdoi të binte edhe kur mbaroi shfaqja dhe hyrja e teatrit mbeti e shkretë.



Matanë dashurisë është një lumë

Matanë dashurisë është një lumë
Asnjë ditë nuk i ngjan çastit
Kur shiu luan me heshtjen
Me mijëra herë
Asnjë natë nuk i ngjan dritës së hënës
Kur yjet i bëjnë rojë vetmisë
Me mijëra herë
Kur lumi del nga shtrati i vet
Belbëzojnë dy shpirtra
Dhe zgjohet një ëndërr
Në bregun e përqaimit
Matanë dashurisë është një lumë
Secili i shkruan kujtimet
Të stolisura me gjethe trëndafili
Me mijëra herë
Prapë koten valët
Si tufa e zogjve të mërzitur
Herët në mëngjesin e brengosur
Arratisen frymëzimet e etura
Me mijëra herë
Matanë dashurisë është një lumë

Zërat e paharruar të Bashotëve

Çdo ditë më merr malli
Për zërat e paharruar të Bashotëve
Më kujtohet si pagëzohej dashuria
Me ninullat më të bukura të fëmijërisë
Si i lidhnim kujtimet duke i numëruar hapat e dremitur
Pastaj iknin kukuvajkat nga kulmi i shtëpisë
Ndërsa shpirtrat bënin gjumë të ëmbël
Më vonë i palonim në heshtje të gjitha dallgët e jetës
Për t'i gëzuar buzëqeshjet pa brenga
Çdo ditë më merr malli
Për zërat e paharruar të Bashotëve
Si thurej nostalgjia me pëshpëritjet e mëngjesit
Nëpër thellësitë e përndritura të kujtesës
Kur i gdhendnim gurët e durimit
Për të ndërtuar shtëpi me pamje kah dielli
Pastaj vraponim fushave të blerta
Bashkë me aromën e zambakëve të lulëzuar
Ashtu vinte e lumtur buzëmbremja
Sepse aty kurrë nuk trembeshin shqiponjat
As fjala s'e humbte besimin e vet
Edhe pse qielli mbulohej me re të zeza
Edhe pse toka gjëmonte në të katër anët
Edhe pse zjarri përpinte të gjitha legjendat
Çdo ditë më merr malli
Për zërat e paharruar të Bashotëve
Aty nuk mungonte asnjë pjesë e dhimbjes
Secila përshëndetje ishte më e ngrohtë se tjetra
Ndërsa rrudhat e ballit ngjanin me vrullin e stuhisë
Secili plis i bardhë kishte krenarinë e vet
Dhe vdekja ikte nga hija e gjarpërinjve
Çdo ditë më merr malli
Për zërat e paharruar të Bashotëve
Pikërisht aty bekohej çasti i lumturisë
Dhe zgjohej ofshama e zemrës
Në formën e krahëve të dallëndyshes
Ndërsa imazhi më i përmallshëm
Mbështillej me lotët e mërgimtarëve
Nëpër librat e historisë së patreguar
Sa herë në lisin e gjakut skalitej liria
Çdo ditë më merr malli
Për zërat e paharruar të Bashotëve

E premtja e Ujmirit

Kujtoj të premtën e Pazarit të Ujmirit
Çastet e gëzimit të papërmbajtur
Përshkrimin e ngjyrave të çuditshme
Në çdo të pestën ditë të javës
Si rriste shtatin fëmijëria
Me hatërmbetje
Kujtoj orën e saktë të udhëtimit
Deri te Pazarit i Ujmirit
Për të blerë syze dielli
Këmishë me vija të kaltra
Pantallona bashkë me rrip të zi
Për t'i veshur vetëm për ditëlindje
Në ditën e fundit të muajit gusht
Dalëngadalë kështu argëtohej
Jeta e rrëfimeve përrallore
Me shkëndijat e para të mallit
Andej nga ikte gjumi i vendlindjes
Kujtoj lojën symbylltas skutave të shtëpisë

FUNDI I HARRIMIT

Poezi nga Sali Bashota



Plot çaste të shndritshme
Gjithë ato copa ëndrrash të lazduara
Që ngjanin me aromën e mollëve të ëmbla
Kujtoj të premtën e Pazarit të Ujmirit
Plisbardhët si Babain tim dritë pastë
Duke i larguar dhimbjet në të gjitha drejtimet
Me trenin e udhëtarëve Prishtinë-Pejë
Sa herë bartej
Liria e fshehur në librat e poezisë
Nëna thoshte mos e harro etjen
Duke imagjinuar fjalët më të bukura
Kur pi ujë në Kroin e Çabiqit
Shpirti bëhej më i lumtur
Pastaj të shtunën në mbrëmje
Shkonim bashkë te dajat
Nën soditjen e hënës
Më mbante në prehër
Duke treguar historinë e asaj kohe
Syri i keq të mos më shikonte
Të nesërmen fluturat e bardha
Pushonin në të dy krahët e mi
Sa herë kujtoj të premtën e Pazarit të Ujmirit
Mallëngjimi flet me zë tjetër
Si përfytyrimi i një fëmije gazmor
Tani aty nuk zgjohet dashuria
As përmallimi i buzëqeshjes
As shiu i shndërruar në metaforë

Krahët e engjëjve

Na duhen prapë
Krahët e engjëjve
Dhe ai kopsht i luleshtrydhave
Rrethuar me dritën e diellit
Ndoshta provë e vetme
Për ta pagëzuar ditën fatlume
Na duhen prapë
Krahët e engjëjve
Me mësue një herë e përgjithmonë
Ç'është vetmia e shiut
Pse nuk dridhen duart kur luten
Derisa sytë e njohin pikëllimin
Na duhen prapë
Krahët e engjëjve
Si ajo ditë e bekuar
Me mësue një herë e përgjithmonë
Si zgjohet rituali i lumturisë

Rituali i mërzisë

E mërzitur është nata
Kur gjërat e ndieshme grisen
Si fjet e holla të frikës
Në rrugën e ndjenjave të shkruaruara

Nuk ka kush me ndez të shkretin zjarr
As në mëngjesin tjetër
Kur ikin të gjitha pulëbardhat
E mërzitur është heshtja
Derisa harresa e gishtërinjve
Nuk e prek më fundin e puthjes
E mërzitur është vetmia
Kur retë e pikëlluara në qiell
Prapë inatosen me ikjen e zogjve
E mërzitur është dhimbja
Përse nuk ka sy të tjerë që shohin
Afshin e ngujuar në shpirtra
E mërzitur është dashuria
Kur e harrojmë emrin e luleve
E mërzitur është ëndrra
Nëse parakalojnë të gjitha hijet
Diku afër vdekjes

Prapë i njëjti portret

Prapë i njëjti portret
Me sy të kaltër
Me flokë ngjyrëgështenjë
Me buzë të fryra
Me mollëza të përflakura
Me ball të ndritur
Me qafë të gjatë
Me shikim të pafajshëm
Me ecje të nxituar
Prapë i njëjti portret

Edhe aty është mëkati

Nëse vret një qyqe
Mbi kulmin e shtëpisë
Bëhesh fatlum
Ta vrasësh edhe një ujk
Në pikë të ditës
Kur largohet mjegulla
Kur bien pemët në tokë
Kur ikin zogjtë shtegtarë
Bëhesh prapë fatlum
Nëse e vret edhe një gjarpër
Pa futur gjumë në sy
Mund të vdesësh si fatlum

E diela e fundit e shkurtit

A ikim andej nga s'vjen më zemërimi
Ndoshta mund t'i besojmë vetvetes si dikur
Disa do të thonë pikërisht këtu fillon rrëfimi
Por papritmas shndërrohemi si dy hije në mur

A ikim këndej me shumë kujdes
Nuk ka më arsye për të dyshuar
Pse kjo nostalgji s'e ka më asnjë ves
Siç e kishte atëbotë ëndrra e vetmuar

Ikim andej e këndej si vetëtimë
Ndoshta prapë s'bëhet vonë
Ndjesia e lumturisë ngjan me pantomimë
E mahnitur qenka kjo parandjenja jonë

Kështu një ditë ikim papritur
Edhe kur sytë shohin tjetrën fshehtësi
Secili poet ka më shumë se një kujtim të ndritur
Por njësoj nuk është asnjëra dashuri

Mëngjes marsi në Prishtinë

Liria bekohet kur e shikojmë njëri-tjetrin në sy
Sigurisht mirësia më nuk përmbysset
Çdo mars nuk e ka të njëjtën magji
Kur zgjohet fjala e dhimbja ngrysset

Sikur të heshtim si shpirtra të druajtur
A do të ëndërrojmë pa bërë zë
Sigurisht disa kujtime tashmë janë ruajtur
“Shpejtoni ngadalë”- ka thënë Horaci- asgjë më

Në këtë ditë marsi në Prishtinë
Bora shkund dridhmat në pafundësi
Nëse prapë do ta bartim lirinë mbi shpinë
Si do ta pagëzohet kjo dashuri

Të gjithë s’e kuptojnë ftesën për flijim
Nëse kushtrimi shpërthen ashtu papritur
As shpirtrat s’e kanë më të njëjtin shëmbëllim
Çdo gjë në këtë botë është në të ikur

Kur vjen çasti

Kur vjen çasti për një përfytyrim tjetër
Ndoshta mund të zgjohet i njëjti frymëzim
Nuk bën kështu më tha miku im i vjetër
Ndonjëherë edhe fjalët e pathëna kanë kuptim

Kur vjen çasti vetëm për afsh e mall
Edhe pritja e mëson fatin e vet
Do të ruhet ky kujtim i rrallë
Sikur vargjet e bukura të secilit poet

Kur vjen çasti të heshtim për çdo gjë
Papritur na rrëmben melankolia
Ndjenjat e përflakura nuk i largojmë më
Derisa shpirtrat të tërhiqen nga vetmia
Kur vjen çasti të duhemi pak më vonë
Fluturat e natës s’gjejnë vend askund
Të dashuruarit nuk janë të lumtur gjithmonë
Sepse rruga e dashurisë s’ka fund

Fundi i harrimit

Një ditë do ta harroj afshin
Si shiun e fundit të verës
S’do ta kujtoj më çastin
Kur më prisje në prag të derës

Një ditë do ta harroj shikimin
Bashkë me lamtumirën e shuar
Rrudhat e ballit e ndiejnë trishtimin
Si disa zogj të pikëlluar

Ndoshta do ta harroj hidhërimin
Derisa nuk bëhet shumë vonë
Dikush s’e kupton kurrë trazimin
Por është i çuditshëm gjithmonë

Një ditë do ta harroj heshtjen
Duke u përpëlitur mbi valë
Ndoshta s’është fjala për buzëqeshjen
Por për secilën ëndërr për secilën fjalë

Nëse e harroj edhe dashurinë
Asgjë nuk do të jetë si dikur
Kush do ta shkruajë librin për vetminë
Kur ndjenjat ngulen si gozhda në mur

Rituali i përmallimit

Sa herë vjen vjeshta më merr malli për dashurinë
Asnjë çast nuk ngjan si zemërimi
Vargjet nuk e përfillin më melankolinë
Ndoshta kështu fillon tundimi

Një ditë më mori malli për pritjen e braktisur
Kur gjethet e mërzitura u vyshkën dalëngadalë
Askush nuk mbërrin cakun pa u nisur
Nëse shpirtrat hidhërohen nga e njëjta fjalë

Malli më mori edhe për vetminë
Sa herë e zinte nata duke pëshpëritur
Askush s’e kuptonte më zilinë
Kur këputej përgjysmë pa u venitur

Sa herë vjen vjeshta më merr malli për dashurinë
Ëndrrat luajnë me gjumin e fëmijërisë
Nuk vdesin kujtimet pa shuar fantazinë
As kur përfundon akti i nostalgjisë

Fragment nga romani në proces

PEMA E
KRISHTLINDJES
nga Vangjush Saro

Në shesh po punohej mirë për vendosjen e bredhit; edhe pse koha s’dukej se ishte me ekipin modest të Bashkisë së Treshit. Dëbora dhe era trazonin gjithçka përreth. Kujtimi i mëngjesit të acartë, kur pema qe shembur në tokë, ishte ende aty përqark. Por mbase nuk ishte e thënë që ajo të rrëzohej për herë të dytë.

Brenda, përkundrazi, ishte ngrohtë. Ata vazhdonin të qëndronin përballë njëri-tjetrit, sërish duke u parë heraherës në sy; dy të saponjohur, të panjohur, kjo ishte e pak çuditshme.

Po, mendoi Ildira Mati, kjo është e çuditshme e, mbase, edhe pa vend. Ose jo. Kishte ndodhur magjia (!) Këtu, në këtë qytezë të vogël e të shurdhët; por në prag të Krishtlindjes. Hollësia e fundit të prishte mendjen. Fundja, ajo gjithnjë e kishte ëndërruar diçka të tillë, paçka se tani mendonte që ishte herët për ta zmadhuar aq shumë. A thua, *zmadhuar* ishte fjala e duhur? Tjetri po heshte, por gjithnjë duke u skuqur nga pak. Paska ende djem që mund të skuqen, kur një vajzë, një vajzë...

-Pra, ky shërbim është për hir të novelës që po shkruan, - u kthye Adi Kraja në bisedë me një fjalë disi konfuze.

-Jo jo, - Ildira tundi kokën me një buzëqeshje që u duk sikur do të përcillte shpjegimet e mëtejshme. - Kjo është puna ime e përditshme. Departamenti i Kulturës dhe Trashëgimisë. Në këtë qytezë, për herë të parë merren me një ceremoni të tillë. M’u duk me interes, prandaj po e ndjek... E zgjodha vetë. Në fakt, ‘Pema e Krishtlindjes’, ajo imja, është krejt tjetër; jemi në dy rafshe që pakgjë kanë të përbashkët. Këtu po jetojmë njëlloj farse, zyrtarët e mbiluajnë rastin, sajohen tendera, ngatërrohen ato me të drejtën legjitime për të përdorur fondet e Bashkisë... Sidoqoftë, në këtë rast, formalisht u bënë një: novela ime dhe shërbimi. - Vajza ndaloi një hop dhe prapë kërkoi, as vetë s’e dinte çfarë, në sytë e tij. - Por unë, ashtu si personazhi im, e dua Krishtlindjen, festat në përgjithësi; është koha që ndjehem gjithnjë e inspiruar. Ia dole të më bëje llafazane. Ti?

-Unë si? Hë, Krishtlindja. Po vërtet, - qeshi Kraja - gjithë ato përgatitje, pema, këngët, dhuratat...

-Duke shfletuar për Pemën e Krishtlindjes, - ajo sërish ia mori fjalën nga goja, - kam lexuar se romakët dhe egjiptianët e lashtë çonin gjethe të gjelbra në shtëpi, duke i konsideruar ato fatsjellëse dhe simbol të jetës në ashpërsinë e të ftohtit dimëror.

-Ou!
-Gjermanët ishin të parët që filluan të vendosnin një dru pishe në shtëpi, si një zbukurim Krishtlindjeje... Por pema e parë e Krishtlindjes, e ndriçuar, është qasje e Edwart Johnson, një ortak i Thomas Edisonit. Në fund të dhjetorit 1882 në mos gaboj, në New York, ai vendosi në shtëpinë e tij një pemë me llampa të vogla inkandeshente...

Ajo nuk pushonte së foluri. Tjetri dëgjonte dhe tundte kokën, pak i habitur, ca më shumë inkurajues, uau, pra kështu qenka, s’e dija... Dhe kur, më në fund, ai guxoi e pyeti nëse në makinën e tyre kishte një vend - porosinë për të cilën gjendej atje, ia kishte besuar gruas që shërbente te bari - ajo mori një pamje tjetër, sikur u ndriçua edhe më në fytyrë; iu afrua, pothuaj e tërhoqi nga duart duke i treguar një dashuri që nuk po e mbante më brenda vetes.

-Tani u bëre rob i im.
-Me shumë dëshirë, - u dorëzua ai.
-Të jesh djalë i mbarë, - shtoi ajo me përkëdheli dhe duke e parë në sy, pa le a e kishte kuptuar tjetri përse ishte fjala; që ajo donte shpirtin binjak, si ta thoshte... hë, një pëllumb, një mik me të cilin nuk mërzitesh asnjëherë, një njeri që të rendte pas saj pa u lodhur.

-Po përpiqem, - tha Adi Kraja duke i mbajtur dorën. Ajo e kujtoi të merrte *ajfonin*, që po e harronte mbi tryezë. Sa nuk i tha me zë ‘qetësohu!’ Dolën duke qeshur dhe duke vazhduar të ngacmoheshin, me fjalë dhe me vështirime.

Do vijë me mua, po thoshte me vete Ildira Mati, pa pasur nevojë të mendonte tjetër gjë.

Gjatë udhëtimit, ata ndenjën të heshtur, por duke u vështruar kohë e pa kohë. I vetmi çast kur folën diçka, ishte ai gjatë të cilit shkëmbyen numrat e celularëve. Idili u kishte rënë në sy qyshkur edhe shoferit e operatorit. Por ata shikonin punën e tyre; diskutonin nëse mund të kapnin një ndeshje të Champions League.

Kur mbërritën në Tiranë, e ndërsa këtu binte një shi i mërzitshëm dhe i ftohtë, edhe ajo po ashtu ia zgjati dorën... Kraja bëri përpjekje të formulonte ndonjë ftesë, ndonjë shtyrje të këtij çerek takimi, por koha ishte kundër tij.

-Shkoi vonë, - tha ajo. - Duhet të hidhem një vrap edhe në studio.

Por në çast u pendua që po e përcillte disi vakët. Dhe ajo dhënie dore, sikur sapo mbaroi ndonjë mbledhje...

Në të vërtetë, kishte nevojë për një pauzë. Po shkonte pak larg, ndoshta qe herët. Duhej të mendohej. S’kishte pasur rastin të bënte as ndonjë kërkim në adresat e tij në rrjete; nuk mund ta shuante dot kureshtjen gjatë rrugës.

-Ti do kthehesh në Krujë?
-Te gjyshërit; siç të thashë.
-Do më flasësh?
-Po.
-Thuaj edhe ndonjë gjë tjetër!
-Nesër jam këtu...
-Kjo po që peshon, - qeshi ajo.

Dhe u afrua. Përqafimi ishte më mirë se dhënia e dorës. Ai po kërkonte një taksi, por kokën e mbante këtej. Ildira Mati e ndoqi me sy gjatë. Mbase mund të kishin pirë një tjetër kafe. Ashtu ishte fjala. Mbase jo, pse duhej të dukej si e përgjëruar për dikë? E megjithatë, qortoi veten, kjo është njëlloj hipokrizie. Ti je gati të qash për atë.

Kraja e kishte gjetur taksinë. Ajo i dha një përhëndetje të fundit me dorë. Vetëm dhjetë minuta në studio, nëpër zyra, erdha unë, bredhin e kishte rrëzuar era, por u ngrit sërish, Treshi është në festë, materiali gati, teksti nesër... dhe i hipi makinës së vet e duke gëlltitur me shumë vullnet trazimet dhe zhurmat e trafikut, mbërriti në shtëpi. U mbyll në dhomën e saj dhe filloi lundrimin në internet.

Ja ku qenka ‘i turpshmi’ që po ia merrte mendjen. Gjithë ai portret pa ndonjë kujdesje të madhe për veten; por të jepte përshtypjen se qe në një qetësi e në një paqe me gjithçka. Çiltërsia dhe buzëqeshja zotëronin në të gjitha fotot. Dhe ato ishin pak. Nga ç’po shikonte në rrjete, ai nuk ishte fort aktiv; ajo e kishte parandjerë këtë. Një foto me të motrën dhe burrin e saj. Një tjetër me beben e tyre. Ai e mbante atë në duar me një dhembshuri që ishte sa për njëqind fjalë. Një tjetër me kolegë, diku në një mal, kështu dukej, ku bëhej ski...

-Edlira, darka!
Tani ai është te gjyshërit. Por unë mund t’i flas. A thua fle sonte?
“Mati,” i tha ajo vetes, “ti shkallove...”



Nëntor 1933

E pra pikërisht në një ditë të zymtë e të ashpër nëntori moskovit, në mes të Terrorit të Madh, spastrimeve, syrgjynosjeve e vrasjeve masive në gjuajtje të antiTrockistëve dhe armiqve të popullit, poeti me prejardhje hebreje Osip Mandelstam do të krijonte Epigramin kundër Stalinit.

Kjo poezi me 16 vargje, ndarë në dy strofa, me një satirë therëse, nëntorin e sivjetëm mbushi 90 vjet. Ndërsa më 27 dhjetor bëhen 85 vjet kur krijuesi i saj poeti Osip Mandestam vdiq nga tifoja në kampin e përqendrimit në Vladivostok. Atje mbeti i pavarrosur deri në pranverë kur e hodhën në një varrezë masive. Por Epigrami i tij kundër Stalinit jeton.

Osip Mandelstam së bashku me Nikolai Gumilev, Anna Akhmatova dhe Sergey Gorodetsky në fillim të dhjetë vjeçarit të dytë të shekulli XX do të krijonin shkollën moderne poetike të Akmeizmit si një vijimësi e poezisë dhe kulturës botërore për t'u shprehur për së drejti e qartas përmes imazheve, në ndryshim nga misticizmi i simbolistëve rusë. Ishte Periudha e Argjendte e lulëzimit të poezisë ruse pas Periudhës së Artë të kohës së Pushkinit, Lermontovit, Fjedor Tjutçevit. Por që nuk do të zgjaste shumë.

Atë ditë kur u takuan për të diskutuar rreth projektit të shkollës së tyre poetike në The Stray Dog Cafe, Shën Petersburg, që njihej asaj kohe si një kafë pikëpjekje për artistët dhe shkrimtarët rusë, asnjëri prej tyre nuk do ta merrte dot me mend se çfarë do ta priste Rusinë dhe ata vetë.

As një dekadë më vonë më 1921 poeti Nikolai Gumilev, bashkëshorti i poeteshës Anna Akhmatova do të arrestohej dhe vritej nga Çeka, KGB e asaj kohe, krijuar menjëherë me ardhjen në fuqi të bolshevikëve për të ushtruar terror të kuq. Nën drejtimin direkt të Leninit.

Poeti dhe shkrimtari Ivan Bunin, Nobelisti i parë rus që e mori këtë çmim pikërisht në vitin 1933, ndërsa jetonte në Paris si një emigrant i arratisur dhe pa kurrëfarë shtetësie, në “Manifestin e emigrimit rus” botuar më 1924 do të shkruante: “Rusia ishte e banuar nga një familje e fuqishme, e cila ishte krijuar nga puna e bekuar e brezave të panumërt.”... Ndërsa shtëpia e familjes të madhe “fjalë për fjalë u shkatërrua me një vëllavrasje të padëgjuar. Një bastard, një idiot moral që nga lindja, Lenini i paraqiti botës .. diçka monstruoze, marramendëse, ai përçau vendin më të madh në Tokë dhe vrau miliona njerëz në dritën e diellit...”

Ivan Bunin e shkruante këtë manifest jashtë Rusisë, natyrisht duke e marrë parasysh rrezikun. Kjo diçkaja monstruoze bëri që shumë poetë e shkrimtarë rusë tash të quajtur sovjetikë do ta përjetonin nën lëkurën e tyre “Terrorin e Madh” që, pas vdekjes së Leninit më 1924, do ta udhëhiqte Stalini, një gjakatar edhe më i pashpirt.

Qielli i errët i nëntorit bolshevik i kishte marrë nën vete poetët, sepse sikur thoshte Yevgeny Yevtushenko “Në Rusi të gjithë tiranët besojnë se poetët janë armiq të tyre më të rrezikshëm.”

Por jo vetëm në Rusinë sovjetike. Edhe në Shqipërinë staliniste dhe poststaliniste.

Samizdat – Disidencë nën terror

E megjithatë, në klimën më të egër të vrasjeve, dëbimeve, internimeve, përgjimeve, frikës, çmendinave, syrgjynosjeve dhe më vonë, edhe nën diktatin e kafazit me hekura burgu të Doktrinës Zhdanov në Rusinë sovjetike, pati disidencë. Ky term lindi pikërisht aty prej shpirtit të poetëve, shkrimtarëve dhe gazetarëve që guxonin të rebeloheshin me qëllimin që t'i linin botës dëshmi, t'i linin brezave trashëgimi.

Në kulmin e censurës dhe përgjimeve, kur kishin veshë muret dhe rruga ku ecje, ku të denonconin miqtë e të afërmit, në Rusinë Sovjetike lindi letërsia dhe gazetaria klandestine, krijimtari që mësohej përmendsh apo kopjohej me dorë, sepse makinat e shkrimit ishin të regjistruara, dhe pastaj shpërndahej dorë më dorë e gojë më gojë, si një veprimtari e mirëfilltë disidente që gjallonte në mesin e një tiranie mizore.

Ky fenomen unik në llojin e vet do të quhej Samizdat (vetëbotim) për të sfiduar barbarinë e censurës sovjetike.

Disidenti i shquar rus Vladimir Konstantinovič Bukovskij, që kishte provuar tortura shnjërzore në birucat e KGB në Lubyanka do të shkruante rreth Samizdat. «Ne nuk prisnim të fitonim, nuk kishim as shpresën minimale për një fitore. Por secili kishte të drejtë t’iu thosh bijve të tij: “Unë bëra gjithçka sa munda”.

Osip Mandelstam dhe gruaja e tij Nadezhda Mandelstam nuk patën fëmijë. Epigrami kundër Stalinit mbeti trashëgimtari i poetit dhe gruas së tij, si trashëgimi e mbarë njerëzimit. Të dy, burrë e grua, hoqën të zezat e

90 vjet më parë, Osip Mandelstam krijoi Epigramin kundër Stalinit

KUR POETI U MËSON QYTETARËVE SI TË JETOJNË TË LIRË

Ese nga Elida Buçpapaj

Dje ishte nëntor, sot është nëntor, fundnëntori. Nëntori të cilit i referohem nuk është as i sotshmi dhe as i djeshmi apo i nesërmi, por i nëntëdhjetë viteve më parë.

Nëntor moskovit i egër, i ngrirë nën terrorin e Çekës.

Nëntori është muaji më i padëshiruar në dymbëdhjetë muajt e vitit të kryeqytetit rus. Kemi vizituar Moskën e erës Jelcin, kur rruga nga aeroporti Sheremetyevo Alexander S. Pushkin ishte e mbushur me banderola që prisnin këngëtarin Tom Jones. Tiranën e lamë në kulmin e pranverës mes lulëzimit të dorëzonjave, jargavanëve dhe akacieve ndërsa Moskën e gjetëm në ngjyrë gri, me këmbët të mbuluar nga bora llohë.

E shtyrë nga kurioziteti fillova të pyes për pranverën ruse, për muajt më të bukur, më të vizituar nga turistët. Në nëntor jo, më thanë në nëntor nuk shkohej në Moskë. Në nëntorin bolshevik, mendova.

ullirit. Nadezhda Mandelstamit pas internimit iu lejua të kthehej në Moskë vetëm në vitin 1964, 26 vjet pas vdekjes së Osipit. Në dy librat e saj me kujtime që do të botonte, ajo denoncon degradimin moral dhe kulturor të Bashkimit

EPIGRAMI KUNDËR STALINIT

E shqipëroi Elida Buçpapaj

Ne jetojmë pa e ndjerë tokën nën këmbë

Ne jetojmë pa e ndjerë tokën nën këmbë hije,
Bisedat tona s’mund të dëgjohen dhjetë hapa larg,
Dhe aty ku thuhet një gjysmë fjalie,
Duhet të përmendet kaukaziani i Kremlinit qoftë larg.
Gishtat e tij të trashë të dhjamosur si krimba,
Fjalët e tij të sakta janë të rëndë kuinaloshë,
Mustaqet e tij qeshin me antena buburrecash
Dhe çizmet i shkëlqejnë lart e poshtë.

Rreth tij një turmë udhëheqësish qafëhollë,
i shërbejnë rreth e rotull gjysmënjerëzorë.
Disa fishkëllejnë, disa mjaullijnë, disa rënkojnë, rënkues,
Ai është i vetmi që i ndëshkon, ndëshkues
Si me patkua, dekretet i falsifikon u hyn në hak:
Disa i godet në ijë, disa në ballë, disa në vetull, disa në sy.
Sikur ha mjedra për çdo vrasje e gjak
Gjoksi i Osetianit vjen duke u fry e fry.



Sovjetik të viteve 1920 e më vonë dhe e lartëson figurën e Osip Mandelstam si të një martiri.

Osip Mandelstam në epigramin e tij e skaliti figurën e Stalinit si të një gjaksori paranojak, të cilit gjaku njerëzor i ngjante si ai i mjedrave.

Në nëntorin e 1933 Osip Mandelstam ua recitoi përmendsh epigramin miqve të tij të ngushtë, midis të cilëve edhe Boris Pasternakut and Anna Akhmatovas. Në materialet e botuara rreth këtij takimi shkruhet se Pasternaku u trondit pa masë kur e dëgjoi. “Ajo që më reciton nuk ka të bëjë me letërsinë apo poezinë, ky nuk është një fakt letrar, por akt vetëvrasjeje që unë nuk e miratoj dhe në të cilin nuk dua të marr pjesë. Ju Osip nuk më recituat asgjë, unë nuk dëgjova asgjë dhe ju lutem të mos ia recitoni askujt tjetër.”

Megjithëse Osip Mandelstam nuk e hodhi në letër epigramin e tij therrës kundër Stalinit, dikush i shkroi dhe çoi vargjet në duart “me gishta të dhjamur krimba” të diktatorit. Një poezi me 16 vargje mjaftoi dhe për Osip Mandelstam nisi rruga drejt vdekjes. E arrestuan në majin e 1934 dhe e dënuan me vdekje.

Osip Mandelstam-it i dhanë Epigramin e Stalinit të shkruar. Ai mund të mos pranonte se ishte autori i saj, sepse poezinë nuk e kishte zbardhur kurrë në letër. Por ai e pranoi menjëherë se ishte e tija, pasi e shihte diçka të pamundur që një poet të mohonte veprën. “Unë jam gati të vdes – poezia është një fuqi sepse për të vritesh” i kishte thënë të shoqes më 1934. Nadezhda Mandelstam në dy librat e saj me kujtime shkruan “se Osip Mandelstam kishte zgjedhur formën e vdekjes së tij në respekt ndaj kulturës ruse për poezinë.”

Pas ndërhyrjes së Nikolai Bukharin-it, dënimi kapital iu zbut me internim bashkë me Nadezha Mandelstam-in për ta arrestuar prapë në majin e 1938 dhe internuar për në moskthim.

Për shkak të epigramit të Mandestam arrestuan edhe bashkëshortin e tretë të Anna Akhmatova studiuesin dhe shkrimtarin Nikolay Punin si dhe të birin e saj 22 vjeçar Lev Gumilev, të cilit do t'i shkonte pas për shtatëmbëdhjetë muaj rresht në burgun e Leningradit, nga ku do të merrte shkas të shkruante Requiem, një poemë monumentale kundër tiranisë staliniste.

Me Epigramin kundër Stalinit, Osip Mandelstam kishte firmosur vdekjen e tij. Syrgjyn gjallë e syrgjyn vdekur do të shkruante Noli në elegjinë kushtuar Luigj Gurakuqit. Syrgjyn gallë dhe syrgjyn vdekur do të mbesë edhe Osip Mandestam. Për viganin liberator do të ketë një varr, për poetin vigan nuk do të ketë as varr. Osip Mandestam do të vdiste në një nga Gulagët sovjetikë në Lindjen e Largme, më 27 dhjetor 1938, pak ditë përpara se të mbushte 47 vjeç. Nuk e kishte pranë as Shpresën e tij – në rusisht Nadezhda quhet shpresë. Ai mbeti edhe pa varr, eshtrat e tij humbën në një varrezë masive afër Vladivostokut, por jo Epigrami me talljen therëse të poetit kundër tiranit

Osip Mandestam jeton edhe pas nëntëdhjetë nëntorësh me Epigramin e mosbindjes kundër Stalinit, që i kushtohet gjithë autokratëve, diktatorëve, tiranëve, ku poeti iu mëson qytetarëve si të jetojnë të lirë.

Filozofi francez Éttienne de La Boétie thotë se “diktatorët dhe tiranët duken të mëdhenj e të gjatë kur ne gjunjëzohemi.” Epigrami kundër Stalinit është një grotesk politik që na bën ta mbajmë trupin drejt, të papërkulur e të pagjunjëzuar.

Osip Mandestam e shkroi Epigramin kundër Diktatorit në një ditë nëntori moskovit, ku vjeshta ishte e egër dhe e ashpër njëjtas si klima e terrorit stalinist. Është trashëgimia e tij e mosbindjes që na e la ne dhe brezave.

Prej atij nëntori deri te ky nëntor kanë kaluar 90 vjet. 90 vjeçar do të duhet të jenë edhe ato 16 vargjet e Epigramit të Osip Mandestam kundër Stalinit, por që nuk njohin as plakje, as syrgjyn dhe as vdekje.

Ndërkaq, sa i përket vjeshtës sovjetike kur janë shkruar këto 16 vargje, mjerisht, vitet kanë rrjedhur por vjeshta ka mbetur e ngrirë në vend.

Në veprën e tij të vlefshme, me qasje shkencore e ndriçuese, me titull: “Histori e Letërsisë Botërore për fëmijë” me autor prof. as. dr. Astrit Bishqemi¹; pasi lexojmë, fillimisht, të dhënat për jetën e përralltarit të famshëm danez Hans Kristian Andersen, më pas analizën e thukët të përrallave të tij, klasifikimin e tyre; ndalemi në faqen 84, ku mësojmë këtë informacion: “Duke përfunduar shënojmë se vëllimi i parë i përrallave të Andersenit në vendin tonë, me sa dimë është: “L. Efthimiadhi - F. Fishta - K. Shiroka / KALLXIMET E ANDERSEN-it - për shkolla e familje -, Shkodër, Shtëpia Botuese “ORA”, 1936.

Duke i hequr frazën “me sa dimë”, nga hulumtimet e mia, pohoj se, botimi i parë i përrallave të Andersenit është në Shkodër, 87-vjet më parë. Pra, udhëtimi i parë i përrallave të Danezit të Madh është në Shkodër. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe, ajo magji e përrallave vinte në një qytet me kulturë, me trashëgimi të pasur, me dëshmi letrare, me rrezatim shkrimtarësh në vite. Iniciativa dhe misioni i tre përkthyesve: L. Efthimiadhi - F. Fishta - K. Shiroka përbën një monument nderimi dhe lavdie që duhet përmendur dhe nuk duhet harruar. Është e rëndësishme të theksojmë se, botimi i dytë i përrallave të Andersenit në vendin tonë, vjen në vitin 1955. 68 vjet më pas, dhe përkthyer nga rusishtja. Kjo ardhje me “vonesë”, nuk bën asgjë tjetër por autorëve-përkthyes iu rritet më tej lavdia dhe evropianizimi i tyre.

Tre përkthyesit, të ditur e të kulturuar i bënë nder lexuesit të vogël shkodran, qytetit të Shkodrës e më gjerë, si dhe Shkollës e Familjes, të cilët me të drejtë e kanë vënë si nën titull, për të vlerësuar maksimalisht këto dy vatra të rëndësishme të edukimit dhe dijes, që në raport me fëmijët, në mirërritjen dhe edukimin e tyre janë bazamentale.

Tre përkthyesit, “Kallximet e Andersen-it” e kanë shoqëruar edhe me një parathënie autoriale. Këndvështrimi im është i përqendruar te kjo parathënie e vlefshme, ku spikasin disa dukuri interesante.

Dukuria e parë, në Parathanje-n e tre përkthyesve rrezaton përgjegjësia, dëshira, brumosja dhe kulturimi i fëmijëve me një letërsi dimensionale, cilësore, edukuese dhe të bukur. Autorët shkruajnë: “Dishiri me u dhënë lexuesave të vegjel Shqiptarë një libër njikohësisht të vjefshëm dhe t’argëtueshëm, na shtyni t’u vëm ndër duer përkëthimin e kallximeve të HANS KRISTJAN ANDERSEN-it...”.

Dukuria e dytë, vlerësimi i emrit të shkrimtarit dhe raporti i tij me përrallën që la shenjë në letërsinë botërore, i bënë përkthyesit të shprehen, kështu: “Emni i tij, sidomos në botën e të vegjelvet, u kujtue dhe kujtohet me kënaqjen më të madhën. Ka kenë një nga ata shkrimtarët e përmendun i cilli me prrallat e veta të bukura të cillat nuk kan për të dijtë kurr mort (nënkupto: përjetësinë dhe pavdekësinë), kâ përcjellë me një mjeshtri të jashtëzakonëshme dhe të hollë rienin në botën e ngjarjeve të bukura, qi përbân jeten e sajë dhe prirjet e saja. (Nënvizojmë: “Shum nga librat kan gjetun vend ndër shkollat si libra shum të dobishëm për arsimin e fëmijvet.”).

Dukuria e tretë, Fëmijët, nga që

NË SHKODËR PËR HERË TË PARË “KALLXIMET E ANDERSEN-IT” - PËR SHKOLLA E FAMILJE -

Nga Xhahid Bushati

duhet të lexojnë vepra të mira; i motivon përkthyesit të shprehen në rëndësinë e këtyre shprehive: “Asht gjâ e dijtun se fëmijt dishrojnë të lexojnë ngjarje. Rreth tyne asht i qandëruem krejt interesi i tyne. Ata kërkojnë pà tjetër pralla, kallxime qi t’a kënaqin fantazin e tyre të pângishme.»

Dukuria e katërt, Evidentohet roli, vlera dhe misioni i vyer i edukatorëve ndaj fëmijëve. Autorët-përkthyes shkruajnë këtë mesazh: “Asht një detyrë e edukatorit qi të përfitojë nga kjo rasë dhe kështu t’u paraqesë këtyne natyrave të njoma sende të dashtuna per to e më të dashtuna per ata mirërritës të tyne qi zhvillimin menduer dhe mirërritjen e fmijvet i këqyrin si dritën e syvet.”

Dukuria e pestë, Misioni i tre përkthyesve: L. Efthimiadhi - F. Fishta²

2 Fishta, Filip (28.04.1904 - 1976). Gjuhëtar, studiues, Profesor. U lind në Shkodër. Në vendlindje kreu shkollën fillore dhe Kolegjin Saverian. Shkollën e mesme dhe studimet e larta i kreu për gjuhësi në Beograd. Në vitet 1924 - 1925 fillon të botojë vjersha në revistën “Kalendari i Vjetës” së Shoqërisë “Vepra Pijore”. Në vitet 1931 - 1932 botoi në revistën “Misao” të Beogradit “Historinë e letërsisë shqipe”. Pas studimeve punon si lektor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në “Ecole Nationale des Langues Orientales vivantes” në Paris nën drejtimin e Prof. Mario Roques. Në vitin 1933 emërohet në Elbasan, ndërsa në vitet 1934 - 1935 vjen në Shkodër, më 1938 është në Tiranë në Institutin “Nana Mbreteshë”, ku punon deri në mars të vitit 1944. Në mars emërohet në bibliotekën e “Institutit të Studimeve Shqiptare”, deri në fillim të vitit 1945. Me datën 19.01.1945 arrestohet nga komunistët. Dënimin e rëndoi në mënyrë të veçantë botimi në revistën “Drini”, i studimit “Kosova për historinë e letërsinë kombëtare”. Pas daljes nga burgu punoi në

- K. Shiroka³ përmes “Kallximeve të Andersen-it” është që Letërsisë Shqipe

Bibliotekën e qytetit të Shkodrës, duke lënë një skedar me shënime të çmueshme albanologjike, pastaj në Bibliotekën Kombëtare të Tiranës dhe në Institutin e Gjuhësisë derisa vdiq. Bashkëpunoi me revistat e kohës: “Kalendari i vjetës”, “Hylli i Dritës”, “Leka”, “Përpjekja shqiptare”, “Shkëndija”, “Tomorri i vogël”, “Drini”, etj. Jep ndihmesë në fushën e folklorit duke botuar këngë të mbledhura si dhe folklor të Kosovës. Ka shkruar me pseudonimin ‘Qytetari akademik’. (Shih më gjerë edhe shënimet e Willy Kamsit).

Në letërsinë për fëmijë e të rinj këtë autor e përmendim për dy tekstet antologjike që ka hartuar për shkollat e mesme. Botimi I mban këtë mbulesë: - “Filip Fishta / Profesuer i Gjymnazit Shtetnuer të Tiranës / ANTHOLOGJI SHQIPE / Për përdorimin e shkollave të mesme: për gjymnaz, për institut teknik, për shkollë normale e për shkollë qytetse. / Pelqem me shkresë Nr. 3924, d. 27 - IX - 1935 të Ministris sArsimit / Bleni I. / Tiranë, 1935 / Shtëpia Botonjëse “Kristo Luarasi””. Gjithashtu Filip Fishta ka dhënë ndihmesë edhe në shqipërimin e përrallave të Andersenit. Në këtë mbulesë të këtij libri shënohet: - “L. Efthimiadhi - F. Fishta - K. Shiroka. “Kallximet e Andersen-it”. Për shkollë e familje. Në faqen e parë shënohet: “Shkodër, Shtëpia Botuese “ORA”, 1936”.

Filip Fishta ishte një figurë poliedrike. Gjithashtu, ai ishte: studiues letërsie, bibliotekist, bibliograf, përkthyes dhe njohës arkivash.

3 Shiroka, Kolë (Kolë B. Shiroka, Prizren, 01.01.1922 - Beograd, 21.05.1994). Ka qenë aktivist dhe luftëtar shqiptar nga Kosova, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në maj të vitit 1982, u emërua në postin e Kryetarit të Kryesisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovë. Në këtë post qëndroi për një mandat, deri në maj të vitit pasues (1983), kur Shefqet Nebih Gashi u emërua në këtë post. Veprimtaria e tij letrare: “Përmbledhje pjesësh teatrale, redaktorë: Sulejman Drini, Hilmi Kryeziu; përkthyer nga Kolë B. Shiroka; Prishtinë, Botues: “Rilindja”, 1961, f. 357, tirazhi: 3000 kopje; fjalët kyçe: Letërsia jugosllave, Letërsia botërore, Letërsia për fëmijë, drama; “Sikur të isha djalë” (dramë në katër akte, simbas romanit të Haki Stërmillit), Prishtinë, (botuesi: pa emër, f. 66, viti 1969); “Me kangë deri në fitore” (recital kushtue kremtimeve të ndryshme të revolucionit popullor dhe krijimit të Jugosllavisë së Re; Prishtinë, botuesi: pa emër, f. 36, me nota, 1969.




për fëmijë duhet t’i ofrohen vetëm vlera të qenësishme nga Letërsia Botërore, si dhe të flasin e shkruajnë bukur Gjuhën Shqipe. Kumti i tyre është: “Kemi pasë përmbi të gjitha kujdesin qi tekstin e këtyne kallximevet t’a paraqesim të kandëshem edhe si shtyp, përcjellë aty këtu edhe me piktura, qi i apin më gjallësi kallximit. Në këtë rasë kemi këqyrë të bâajmë me bashkpunuem arti e letratryra me edukatën mëndore, morale e esthetike të fmis dhe kështu dora doras t’i arrihet sâ më parë atij qellimi të bâjmë qi ndër fmit t’onë të lindi vullndeti për lexim e, dalë ngadalë, lexuesit e vegjel t’onë të bâahen ata vetë t’aftë jo veç të mendojnë, por edhe të flasin e të shkruajnë më së miri.”

Dukuria e gjashtë, Në “Kallximet e Andersen-it” janë përzgjedhur këto përralla përmes një gegnishtje të amël, si: - “Tuku i vogël”, - “Hia”, - “Robot e rea të Dukës së Madh”, - “Shoku i udhtimit”, - “Princesha mbi një bizele”, - “Vogëlusha”, - “Vajza e vogël dhe shkrepsat”, - “Vajza qi shkeli bukën”, - “Lule-delja”, - “Ushtari trim prej plumbi”, - “Ndeshja e të ngamit”.

Dukuria e shtatë: Fjalët kyçe: dëshira, vlefshmëria, argëtimi, lexuesi i vogël, edukatorët, emri i shkrimtarit, vlera dhe magjia e përrallave, mirërritje, si drita e syve, ardhmëria, të shkruajmë mirë gjuhën shqipe, edukatë, kujdes, edukim... etj.

Shkodër, dhjetor, 2023



1 Bishqemi, prof. as. dr. Astrit: Histori e Letërsisë Botërore për fëmijë, botim i dytë i përmirësuar e i plotësuar, Sejko, 2006; shkrimi: Hans Kristian Andersen (1805 - 1875), f. 77 - 84.

TANI MOTI ËSHTË MË I MIRË tha Thomasi ndërsa u kthym djathtas për në Travaträsk.

Nuk ka mushkonja edhe pse është ende ngrohtë dhe së shpejti do të fillojë gjuetia e drerëve.

Isha dakord që ishte stinë e mirë.

Bëmë disa kilometra duke krahasuar muajtë.

E urrej pranverën, mendova.

Nga janari deri në prill është një kohë goxha e mërzitshme, thashë unë duke belbëzuar paksa në fjalën e mërzitshme.

Jo, tha Thomasi. Stina e pestë është kulminacioni i vitit. Me përjashtim të gjuetisë së drerëve.

Ai i referohej fund-dimrit. Kur temperatura e ditës kalon pikën plus. Ekskursionet me skuter, pjekje salsiçesh dhe termosat mbushur me çokollatë. Tërë ditën në ndonjë liqen së bashku me të tjerë që ngasin skuter.

Unë nuk e kisha problem të ulesha në liqenin e ngrirë kur dilyn rrezet e para të diellit dhe të lexoja një libër ndërsa Thomasi peshkonte. Por ngasësit e skuterëve nuk mund t'i duroja. Termosat të mbulshur plot me liker. Mënyrën se si njerëzit aty nuk përgjigjen kurrë pa thënë posi, posi.

E bëtë funeralin e nënës suaj ?

Posi posi!

Gjetët mjedra këtë vit?

Posi posi!

A keni akoma menstruacion?

Posi posi!

Për të shmangur ekskursionet me skuter unë sugjeroja të blinin një shtëpi verore.

Pranë ndonjë liqeni ose ndoshta buzë detit, thashë. Mund të shkojmë atje në fundjavë, vetëm unë dhe ti. ishte një burrë i trishtuar që shiti skuterin për të përballuar paradhënien.

Faleminderit për gjithçka, tha ai dhe përkëdheli dyshekun.

Shkuam atje. Bëra kafe. Ia zgjata njërin filxhan Tomasit. Pikërisht kur makina e tronditi shumë. Dreqi ta marrë, mallkoi dhe u fut në rrugë. Tani pantallonat iu lagën. I zgjata pecetat prej letre. Një dhëlpër rrëshqiti në rrugë.

Shiko, thashë. Në hendek është një biçikletë e hedhur. Dukej vetëm një pjesë e timonit dhe e dorezës. Pjesa tjetër ishte fshehur nën degët e bredhit.

Vend i çuditshëm për një biçikletë, thashë. Mu në mes të askgjësë.

Duhet të jetë ndonjë mbledhës manaferrash që ka frikë se mos ia vjedhin, tha Thomasi.

Nga kush, thashë unë. Askush nuk jeton këtu .

Ka shumë njerëz që sillen përreth, tha. Hajdutët e naftës dhe gjërave tjera. Unë mora hartën dhe e studiova.

Do të shkojmë pak më tej dhe do të marrim rrugën djathtas menjëherë pas kthesës, thashë.

T' i zësh. Gratë dhe hartat. Është po aq e pamundur sa çiftëzimi i një skifteri me një shqiponjë. Ashtu siç mendova, tha ai. Do të marrim kthesën majtas. Kur rruga dalëse vazhdoi në të djathtë, unë s' bëra zë.

As Thomasi.

Rrezet e fundit të diellit e mbanin vilën verore nën përqafimin . Nga brenda të sulej zagushia. Unë hapa dyer e dritare. I lash mizat, mushkonjat, grerëzit dhe fluturat e zeza të kenë një shans të fundit.

Oborri ishte zverdhur, ashtu si dhe mëshsteknat poshtë liqenit. Morëm gjërat nga makina. Qeset me ushqime dhe çantat. Kutitë me gjëra që na duheshin. Gjëra qyteti.

Uthull balsamike

Vaj ulliri

Xhenxhefil

Chili

Verë

Birrë

Karin Smirnoff

MISSING PEOPLE

Përktheu Qerim Raqi



Raki

Diçka për të përzier rakinë

Perime

Fileto trofte

Kripë

Mulli piperi

Çfarë do të hash sonte, i thashë.

Unë po ndez zjarrin, tha Thomasi.

Kur u ndez zjarri, gatuam salciçe secili në shkopin e vet. Thomasi piu birrë. Unë nuk mora birrë.

A je e kënaqur tani që ke shtëpi verore?

Po, thashë, duke pyetur veten se kah do të shkonte biseda.

Nëse mund ta quash shtëpi verore, tha ai. I ngjan më shumë një kasolle.

Të paktën kemi mbulesa të reja, thashë unë. Mund të të rregulloj shtratin nëse do të shtrihesh.

Të shpenzosh para përsëri je e zonja gjithsesi, tha ai. Asgjë nuk bëhet më mirë vetëm pse është e re.

Shumë gjëra bëhen më mirë pse janë të reja, nuk thashë . Në vend të kësaj, i hodha duart rreth qafës, sikur të doja diçka.

Dëshiron diç posaqërisht, tha dhe bëri siç bënte zakonisht kur më afrohej.

Shtrati ishte rregulluar. Thomasi ejakuloi.

Tani nuk kishte asgjë në trup që duhej të dilte jashtë, përveç gërhitjes dhe ajrit.

U ula në shkallë dhe ndeza një cigare. Ai nuk do ta nuhaste tymin. Birra ishte e mirë për këtë gjë. Ashtu si tableta që shkërmoqa në kavanozin e fundit.

U zgjuam nga një trokitje në derë.

Mund ta hapesh, i thashë duke u veshur. Duhej të vishesha. Kush dreqin është tani para agimit, tha Thomasi duke u ngritur nga

shtrati. Vuri batanijen rreth belit dhe hapi derën.

Më fal, tha zëri. Nuk kishim qëllim t' ju zgjonim, por pamë biçikletën.

Biçikletën, tha Thomasi. Ç'dreq biçiklete. Ajo që është varur në pjesën e pasme të makinës. Një Crescent e kuqe.

Nuk është e juaja?

Po, thirra unë nga dhoma e gjumit. E jona është. Mbërritëm mbrëmë vonë. Thjesht jemi paksa të lodhur.

U veshja shpejt.

Gruaja në derë kishte të veshur një jelek të verdhë reflektues. Pas saj qëndronin ca njerëz të tjerë me jelek të verdhë reflektues. Kush jeni ju, pyeta.

Missing Poeple, u përgjigj gruaja. Jemi në kërkim të një burri. Është zhdukur nga Bergaträsk-u disa ditë më parë me një biçikletë të kuqe femrash. Biçikleta është e së njëjtës firmë me atë që keni ju. Menduam se mund ta kishit gjetur dhe ta kishit marrë me vete. Ka edhe një shportë, mu si e juaja. Doni kafe, i pyeta. Ishim duke bërë mëngjesin.

Ajo shikoi prapa njerëzit e tjerë me jelekë.

Me kënaqësi, u përgjigj. Dhe ndoshta pak ujë. Është shtator dhe kaq vapë.

Ora ishte pothuaj tetë. Mjegulla rridhte mbi liqen. Jashtë nuk ishte aq nxehtë.

Ata u grumbulluan rreth tryezës së kuzhinës. Mobiljet ishin përfshirë në marrëveshjen e blerjes. Divani ishte me vija portokalli.

Ashtu si tavani dhe muret, edhe mobiljet ishin prej druri, ngjyrë ari.

Vendosa ca simite në një pjatë.

Shtëpinë e blemë verën e kaluar, thashë. Por nuk kemi pasur kohë të qëndrojmë këtu më parë. Kush është personi i zhdukur ?

Emri i tij është Tage Nilsson tha zëdhënësi duke shpalosur ca të dhëna. 73 vjeç. Në gjendje të mirë për moshën. Kontabilist në pension. Bën të njëjtën xhiro çdo ditë, pavarësisht nëse është shi i dendur apo fest Krishtlindjesh. Kur është zhdukur, ka qenë i veshur në tuta gri dhe me një kapelë të zezë. Ndoshta ka pasur edhe një çantë shpine të vogël.

Ajo po mbante në dorë një fotografi. Një burrë flokëshkurtër dhe një grua pak më e re para një shtëpie. Fakti që ai qëndronte disa centimetra përballë gruas - këtë e mendova vetëm unë.

A është gruaja e tij, e pyeta. Po, tha ajo. Aina Nilsson. Kanë tre fëmijë, të rritur. Vajza e vetme jeton në Bruksel dhe është politikanë.

A nuk ishte avokate, tha një person tjetër nga jelekëveverdhtë?

Pikërisht. E ngatërrova me djalin . Ai është një politikan i këshillit të qarkut në Boden. Këtë mund ta themi. Edhe pse ata tani e kanë vështirë të vijnë këtu. Është rrugë e gjatë nga Brukseli. Duhet të ndërrosh avion. Ndoshta nga aty nuk ka fluturime direkte për në Skelefte.

E ndërpreva me posi, posi. A jetojnë në fshat, pyeta.

Shtëpia jonë verore ishte jashtë rrugës. Në anën tjetër të liqenit.

Po, tha ajo. Në Västerbottensgården, që ndodhet në kodër. Sapo të kalosh shenjën e trafikut ku shkruan Mirë se vini në Bergaträsk.

U ngrita dhe pastrova tryezën. Ata më falënderuan për kafën dhe u larguan.

Ndjeva vështrimin e turbullt të Tomasit ndërsa laja gotat.

Dole dhe e more biçikletën pasi më kishte zënë gjumi, më pyeti? Nuk e kisha bërë këtë. Nuk po kuptoja asgjë. Dikush duhet të ketë qenë këtu me të.

Sidoqoftë na duhet një biçikletë, thashë. Unë do të jem vetëm për një javë kur të fillosh punën.

Thomasi u mendua. I pëlqenin avantazhet. Fakti që unë gjeta një biçikletë funksionale nën një pemë ishte një gjë që e vlerësonte.

Fshati kishte një karburant ngjatur me një dyqan. Aty kishte edhe dërgesa të paketave ushqimore, një kënd për bastore dhe këndin për gjëra të ndryshme si doreza, kapele, mbathje dhe thika.

Mora një palë doreza. Kapela kishte të njëjtën ngjyrë. Nxora një thikë nga këllëfi dhe testova mprehtësinë e saj në thonin e gishtit tim të madh. Është artizanat samez, tha një zë pas meje. Babai im i bën këto.

Ktheva kokën.

Vështruam njëri-tjetrin. Vështrimi i tij ishte më ngulitës se imi.

A kanë edhe ndonjë funksion, e pyeta. Apo janë thjesht për dekor.

Më shumë u duhen njerëzve të qytetit, tha. Që presin ndonjë salsiçe dhe mprehin ndonjë shkop.

Në mbrëmje. Teksa i preva vetes një copë salsiçe dhe mpreha një shkop, mendova për djalin e vëllait të thikëpunuesit. Mendova për të dhe vështrova Tomasin. Drita e celularit ia ndriçoi fytyrën. Rrathët poshtë syve iu bënë edhe më të errët. Ishte përqendruar në diçka. Gishtat e tij po shkruanin mesazhin shpejt. Buza i shkoi në gaz. Pyeta veten se kujt po i shkruante.

Duhet të jesh kaq dyshuese gjatë gjithë kohës, më tha.

Nuk isha. Qëndroja indiferente. Por nëse e shihnim gjithë këtë nga një tjetër pikëvështrim. Ta zëmë se unë shkrova një tekst. Ai nuk kërkonte vetëm ta lexonte. Por kërkonte që celulari im të ishte plotësisht i dukshëm dhe me zë të lëshuar. Pa fjalëkalime apo pengesa të tjera kur të shfletonte nëpër listat e telefonatave, fotove dhe mesazheve.

Kush është Stigu, tha. Pse thërret të dielen.

Është shefi im, thashë. Më pyet nëse mund të punoj fundjavën tjetër.

Thomasi ma zgjat gotën bosh. Këtu, tha. Bëj edhe një liker.

Nuk e di pse hezitova. Padëgjueshmëria fluturoi në mua si një dallëndyshe mbi hambar. Bëje vetë, i thashë Thjesht bëje, tha. Jo, thash.

Ai përplasi gotën mbi tavolinë. Zakinisht mjaftohet me të bërtiturat. Por kur u ngrit në këmbë, celulari i ra në dysheme. Një çarje u përhap në të gjithë ekranin.

E kuptova. Duhet të kisha vrapuar. Në vend të kësaj, qëndrova aty . Kur më kapi për fyti mbylla sytë dhe mendova për thikën në këllëf. Atë që e kisha në brez dhe që ishte gdhendur nga një burrë, nipi i të cilit kishte një vështrim ngulitës.

Të nesërmen. Sepse gjithmonë ka një të nesërme. Më zgjoi heshtja.

Thomasi nuk qëndronte shtrirë pranë meje. As nuk e dëgjova duke bërë ndonjë gjë në shtëpinë verore.

U deshën disa sekonda. Para se e djeshmja të zinte fillin. Fillova nga këmbët dhe vazhdova lart. U ndala në pjesët e trupit ku fryrjet dhe mavijosjet ishin përhapur si blozë.

Pas ndodhisë ai kishte qarë. Ishte çliruese për të, të qante. Një lehtësim, siç tha, derdhje lotësh kur më e keqja të ketë kaluar. Thjesht u zemërova shumë, tha.

Më fal, i thashë. Ishte faji im. Më mbajti si një batanije ngushëllimi derisa të qarat u qetësuan.

Bëra kafe. Testova të bëja disa hapa mbi dyshtemenë e kuzhinës. Ndihesha më lehtë kur lëvizja. Më në fund veshja rrobat. Shtëpia verore ishte bërë shumë e ftohtë. Ishte një ditë më e ftohtë. Brymë nëpër gjethe. Sobës i hodha dru mështekne. U ula aty pranë me filxhanin e kafesë dhe nxehtësia më masazhoi trupin . Vapa më bëri të përgjumur. Duhet të kem tundur kokën. Dikush ishte në derë. Dikush që përpiquej të hapte derën. Dera ishte e mbyllur.

Jashtë qëndronte një burrë me tuta gri. Me duart prapa. E njoha. Ishte Tage që ishte zhdukur me biçikletën e kuqe. O zot, thashë, hyni brenda.

Ai u mbajt pas kornizës së derës dhe çapiti brenda. Bëri ca hapa deri te kolltuku buzë zjarrit, u mbështet tek unë. Mbajta veten të mos bërtisja. Teksa m'u ngjit për krahu. Eca në tym, tha. Ke një pikë ujë?

I dhash ujë, kafe, sanduiç me sallam dhe lëng. E ndihmova të thërriste gruan e tij.

Aina, tha, dhe ia shkrehu të qarit.

Mora përsipër dhe i shpjegova se ku ndodhej shtëpia verore.

Ashtu ë, ju rrini atje, tha ajo. Në fshatin e fatkeqësisë. Nuk dukej e lehtësuar. Ajo nuk tha faleminderit. Vetëm tha se do të vinte në një moment. Sapo të ketë ardhur brumi.

Tage u ul në një batanije duke shikuar zjarrin.

Diçka më ndodhi në pyll, tha ai. Tri ditë pa ushqim. Manaerrat gjysmë të ngrira ishin gjithçka që munda të gjeja. Natën ishte minus gradë. E mbajta ngrohtësinë me degët e bredhave.

Çfarë ndodhi me ty, pyesja veten. Që një jetë e tërë nuk mund të të ndryshonte.

Mendoj se takova Zotin, tha. Zoti tha se do të më ndihmonte. Se çasti im nuk kishte ardhur. Se së shpejti do të ulesha sërish në tavolinën e kuzhinës dhe do të gatuaja simite. A nuk tha asgjë më shumë, pyeta veten.

Jo, tha ai. Kjo është e gjitha. Kur mbërriti Aina, unë e ndihmova me Tagen. Ai u mbështet tek ne të dyja.

Të dhemb dikund, më pyeti Aina. Ndoshta më shihej në fytyrë.

Kam dhimbje nga stërvitjet, thashë. Do të kalojë. Në fakt këtë e thashë kur e futëm Tagen në makinë: çfarë deshe të thuash për aksidentin?

Nuk e di ti se çfarë ka ndodhur këtu, u përgjigj ajo? Shtëpia ka qenë bosh që atëherë. Nuk është çudi që ju e bletë atë me çmim të ulët.

Ne shikuam drejt liqenit. Ishte një vend i bukur.

Familja që jetonte këtu ishte ndryshe, tha Aina . Ata qëndronin të izoluar. Kur fëmijët nuk u shfaqën në shkollë për disa javë, mësuesi erdhi këtu. Ishte ai që i gjeti.

Ishin të vdekur, pyeta.

E gjithë familja, tha ajo. Por që atëherë kanë kaluar shumë vite.

Çfarë kishte ndodhur, e pyeta, por Aina mbaroi së foluri.

Më thuj nëse do të blesh dru zjarri, tha ajo duke hipur në makinë. Tage mund të t' i sjellë këtu me traktor.

Kur u ktheva brenda, pashë se biçikleta ishte zhdukur. Nga ana tjetër, makina ishte aty ku kishte qenë . Imagjino Thomasin me pantallona çiklizmi . Qesha. Brinja nuk ma ktheu të qeshurën.

Dita kaloi, pasditja erdhi dhe më në fund mbëmja.

Biçikleta ishte ende e zhdukur. Edhe Thomasi.

Bëra një xhiro në fshat. Më shumë vetëm sa për të bërë diçka. Shfrytëzova rastin të laja makinën në një garazh vetë-shërbimi. Edhe brenda. Ishte vërtet e nevojshme.

Dy ditë më vonë thirra policinë dhe tregova se si qëndronte puna. Se burri im kishte dalë me një biçikletë të kuqe të markës Crescent dhe nuk ishte kthyer më. Biçikleta ka edhe shportë, thashë.

Pse nuk keni telefonuar deri tani, tha policia.

Mendova se kishte shkuar te një shok. Zakonisht kështu bën.

Jelekët e verdhë u kthyen. I qerasa me simite të reja. Bashkë me fshatarët kërkimin e bënim në zinxhirë.

Ditën e shtatë, policia hoqi dorë. Do të gjendet, thanë. Gjuetia e drerëve fillon javën e ardhshme. Por askush nuk mbijeton pa ushqim, ujë dhe ngrohtësi.

Më në fund, në oborr mbetëm vetëm unë dhe djali i vëllait të thikëpunuesit.

E ke hedhur akoma thikën, pyeti ai.

Shtrëngova brezin. Këllëfi ishte bosh.

Si e ke emrin, i thash.

Silas, u përgjigj.

Silasi hyri brenda. Vura zjarrin dhe bëra kafe. U ndje si në qytetin e tij të lindjes. U ula në karrigen e kuzhinës me duart në prehër.

Uluni, tha ai. E kuptoj që është e tmerrshme të humbasësh bashkëshortin në këtë mënyrë.

Ju nuk dini asgjë për këtë, i thashë.

Por ju keni një emër.

Marie Antoinette thashë unë.

Si mbretëresha, tha ai.

Si mbretëresha, thashë unë.

Një grua që humb burrin e saj duhet të jetë në pushim mjekësor.

Stigu telefonoi dhe më shprehu ngushëllime.

Biçikleta e fshehur mirë nuk do të gjendet kurrë.

Më rastiste të kërkoja thikën.

Mavijosjet në trup u zbehën dhe u zhdukën.

Kur vinte koha për të shkuar në shtëpi, dimëroja në shtëpinë verore.

Ngrohesh nga soba. Zbrazja kazanin e ujit dhe paketoja në thasë mbulesat e shqyera nga minj dhe brejtës të ndryshëm. Fshija dyshtemenë dhe e pastroja me ujë të ngrohtë. Më në fund i vura dryrin. Çelësin e vura në një gozhdë dhe zbrita në liqen për herë të fundit.

Nori ka marrë të vegjlit dhe është zhvendosur në Francë. Dimri është afuar.

Tashmë mbi liqen është krijuar një shtresë akulli . Së shpejti do të mbulohet me dëborë.

LIDHJA E SHOIPTARËVE NË RUMANI “ALAR” NË BIBLIOTEKËN KOMBËTARE TË SHOIPËRISË

Me datë 13 dhjetor 2023, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë organizoi aktivitetin “Letërsia Shqipe në Ruman” me të ftuar Lidhjen e Shqiptarëve në Ruman, “ALAR”. Të pranishëm ishin deputeti i Kuvendit të Rumanisë si përfaqësues i grupit etnik shqiptar në atë vend, z. Bogdan Alin Stoica; Presidenti i “ALAR”-t, z. Radu Cosmin Savulescu si dhe dr. Luan Topçiu, shkrimtar, kryeredaktor i Albanica-s, hartues i Historisë së Letërsisë Shqipe dhe Antologjisë së Letërsisë Shqipe në gjuhën rumune.

Takimi filloi me një pritje në ambientet e Bibliotekës nga drejtori i saj, z. Piro Misha, ku u diskutuan mundësitë e mëdha të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Rumanisë në rrafshin e kulturës, sidomos në atë të librit dhe bibliotekonomisë. Më pas, aktiviteti vijoi në qendrën e saporikonstriktuar “Sotir Kolea”, ish biblioteka e vjetër ku edhe u mbajt veprimtaria. Në fillim, z. Misha prezantoi shoqatën në terma të përgjithshëm, foli për rëndësinë e aktivitetit të saj, vlerat që ajo tejçon dhe punën e madhe që bën, fatkeqësisht jo aq e njohur sa duhet në Shqipëri. Në mbarim, ia dha fjalën z. Stocia, deputeti që tregoi aktivitetin politik të shqiptarëve dhe mënyrën se si ky aktivitet realizohet nëpërmjet ndërmarrjeve kulturore, duke bërë publik edhe lajmin se “ALAR” kishte blerë një godinë të re si seli të vetën në qytetin e Krajovës.

Pas tij, z. Savulescu ndërtoi një hartë kronologjike të aktiviteteve kryesore, foli për bashkëpunëtorët dhe për hapësirat e reja ku shoqata synon të shpërndajë perspektivat e veta.

I fundit, dr. Luan Topçiu, i dekoruar me urdhrin e *kalorësit* nga presidenti i Rumanisë për merita të veçanta në fushën e kulturës, tha se si antologjia, po ashtu edhe historia janë ndërmarrje personale të cilat kontribuojnë, por nuk shterojnë çështjet bazë të ngritura në to. Ndër të tjera, foli për “Albanica”, revistë e cila paraqet një pjesë të madhe të letërsisë dhe albanologjisë për lexuesin rumun dhe e cila shpërndahet në bibliotekat kryesore të botës dhe sigurisht, në të gjitha bibliotekat e Rumanisë. Po ashtu, paraqiti shkurtimisht edhe vijimin e traditës së gazetës së parë në shqip, *Drita – Lumina* që akoma dhe sot botohet, në një tirazh të lartë prej mijëra kopjesh.

Në fund, ambasadori i Rumanisë në Shqipëri, Sh. T. z. Octavian Čerban vlerësoi lart kontributin e ALAR në Ruman dhe falënderoi Bibliotekën për mundësinë që u dha të paraqisnin edhe në vendin amë punën e tyre të paçmuar.

Më pas, me kërkesën e deputetit dhe kryetarit të shoqatës, u realizua një takim mes tyre dhe shkrimtarit Ismail Kadare, gjatë të cilit u diskutua për lidhjet e hershme Shqipëri-Rumani dhe perspektivat e reja të bashkëpunimeve shumëplanëshe.

Shoqata Lidhja e Shqiptarëve të Rumanisë (ALAR) është organizata përfaqësuese e pakicës kombëtare të shqiptarëve të Rumanisë. Ajo është krijuar në vitin 1999 dhe që nga viti 2000 ka përfaqësuar pa ndërprerje pakicën shqiptare të Rumanisë në Parlamentin e Rumanisë. Objektivi i përgjithshëm i shoqatës është përfaqësimi i interesave të pakicës shqiptare të Rumanisë, si në pikëpamje të promovimit dhe ruajtjes së identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar, ashtu edhe në plan politik, në kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe nga ligji zgjedhor. Në këtë kuptim, ALAR zhvillon një numër të madh veprimtarish kulturore, organizon evenimente, boton dhe shpërndan libra dhe revista, merr pjesë nëpër takime dhe festivale që u kushtohen pakicave kombëtare të Rumanisë, po kështu, promovon në të gjitha kanalet e medias elementë të identitetit të shqiptarëve të Rumanisë dhe të të gjithë shqiptarëve kudo që ndodhen.



Kur isha në shkollë të mesme, ja ç'më ndodhi krejt papritmas. Mësuesi më kërkoi të lexoja me zë të lartë. Dhe nga hiçi, më pushtoi një frikë e beftë e cila më mposhti. Sikur u zhduka brenda asaj frike dhe e gjithë qenia ime përbëhej prej saj. U ngrita dhe dola me vrap nga klasa. Vura re sytë e zmadhuar nga habia të nxënësve si dhe mësuesin vështrimet e të cilëve më ndiqnin ndërsa dilja nga jashtë. Më pas u përpoqa ta shpjegoj sjelljen time të çuditshme duke thënë se isha i detyruar të shkoja në tualet. Mund të pikasja në fytyrat e atyre që më dëgjonin se nuk po më besonin. Dhe ndoshta po mendonin se isha çmendur, po, me siguri drejt asaj rruge isha.

Kjo frikë për të lexuar me zë më ndiqte nga pas. Me kalimin e kohës, gjeta guximin t'u kërkoja mësuesve të mos më kërkonin të lexoja me zë të lartë, pasi kisha shumë frikë ta bëja, disa më besuan dhe nuk ma kërkuar, disa menduan se në një mënyrë a në një tjetër, po përpiqesha të bëja të zgjuarin.

Nga kjo përvojë mësova diçka të rëndësishme për njerëzit. Por nuk mësova vetëm aq.

Po, ka shumë të ngjarë kam mësuar diçka që më mundëson të qëndroj këtu sot dhe të lexoj me zë të lartë sot para një auditori. Dhe tani po e bëj gati pa asnjë lloj frike.

Çfarë mësova?

Në një farë mënyre m'u duk sikur frika ma mori gjuhën dhe se duhej, si të thuash, ta merrja mbrapsht. Dhe nëse duhej patjetër ta bëja këtë, kjo s'mund të ndodhte sipas kushteve të njerëzve të tjerë, por sipas mënyrës time.

Fillova të shkruaj tekstet e mia, poezi të shkurtra, tregime.

Dhe zbulova se duke vepruar kështu, m'u krijua një ndjenjë sigurie, më ngjalli të kundërtën e frikës.

Në një farë mënyre gjeta një vend brenda vetes që ishte vetëm i imi, dhe nga ai vend mund të shkruaja atë që ishte vetëm e imja.

Tani, rreth pesëdhjetë vjet më vonë, ende ulem dhe shkruaj - dhe ende shkruaj nga ky vend i fshehtë brenda meje, një vend për të cilin sinjerisht nuk di shumë, përveçse ekziston.

Poeti norvegjez Olav H. Hauge ka shkruar një poezi në të cilën e krahason aktin e të shkruarit me të qenit një fëmijë që ndërton kasolle me gjethe në pyll, ecë zvarrë nëpër to, ndez qirinj, ulet dhe ndihet i sigurt në mbrëmjet e errëta të vjeshtës.

Mendoj se ky është një imazh i mirë që tregon se si e përfetoj edhe unë aktin e të shkruarit.

Tani - si pesëdhjetë vjet më parë.

Dhe mësova edhe diçka tjetër, mësova se, të paktën për mua, ka një dallim të madh midis gjuhës së folur dhe asaj të shkruar, ose midis gjuhës së folur dhe asaj të letërsisë.

Gjuha e folur është shpesh një komunikim monologues i një mesazhi që diçka duhet të jetë kështu ose ashtu, ose është një komunikim retorik i një mesazhi që përpiket të bindë ose shpreh një bindje. Gjuha e letërsisë nuk është kurrë e tillë - ajo nuk informon, është kuptim më shumë sesa komunikim, ka ekzistencën e saj të mëvetshme.

Dhe në këtë kuptim, letërsia e mirë dhe të gjitha llojet e predikimit, padyshim dallojnë plotësisht nga njëra-tjetra, pavarësisht nëse predikimi është fetar apo politik apo i çfarëdo lloji qoftë.

Nga frika e leximit me zë, hyra në zonën e vetmisë, në atë që është pak a shumë jeta e një shkrimtari - dhe prej

JON FOSSE: NJË GJUHË E HESHTUR

Ligjërata e Nobelit, 8 dhjetor 2023

Përktheu: Granit Zela



Jon Fosse, në ceremoninë e ndarjes së Çmimit Nobel

atëherë kam qëndruar atje.

Kam shkruar shumë, edhe prozë edhe drama.

Dhe sigurisht, ajo që e karakterizon dramën është ligjërimi i shkruar, ku dialogu, biseda ose shpesh përpjekja për të folur, dhe ajo që mund të jetë monolog, është gjithmonë një univers i imagjinuar, është pjesë e diçkaje që nuk informon, por që ka qenien e vet, ekziston.

Dhe kur bëhet fjalë për prozën, Mikhail Bakhtin-i ka të drejtë kur argumenton se mënyra e të shprehurit, vetë akti i të treguarit, ka dy zëra. Për ta thjeshtuar: zëri i personit që flet, që shkruan dhe zëri i personit për të cilin flitet.

Këto zëra shpesh kalojnë te njëri-tjetri në mënyrë të tillë që është e pamundur të dallosh se zëri i kujt është. Ai thjesht bëhet një zë i dyfishtë i shkruar - edhe kjo sigurisht është pjesë e universit të shkruar dhe logjikës brenda tij.

Çdo vepër që kam shkruar ka, si të thuash, universin e vet imagjinuar, botën e vet. Një botë e cila është e re për çdo dramë, për çdo roman.

Por një poezi e mirë, sepse kam shkruar edhe shumë poezi, ka gjithashtu universin e vet - lidhet kryesisht me vetveten. Dhe pastaj dikush që e lexon mund të hyjë në universin që është poezi - po, është më shumë si një lloj bashkimi sesa një komunikim.

Në fakt, kjo ka gjasë të jetë e vërtetë për gjithçka që kam shkruar.

Një gjë është e sigurt, nuk kam shkruar kurrë për të shprehur veten, siç thonë, por për t'u larguar nga vetja.

Po që përfundova si dramaturg - po, çfarë mund të them për këtë?

Shkrova romane dhe poezi dhe nuk kisha dëshirë të shkruaja për teatër, por me kalimin e kohës e bëra sepse - si pjesë e një nisme publike të financuar për të shkruar më shumë drama të reja norvegjeze - m'u ofrua ajo që ishte për mua, një autor i varfër, një shumë e mirë

parash për të shkruar skenën hapëse të një drame, dhe përfundova duke shkruar një dramë të tërë, dramën time të parë dhe ende më të vënë në skenë, "Dikush do të vijë".

Hera e parë që shkrova një dramë doli të jetë befasia më e madhe në gjithë jetën time si shkrimtar. Sepse si në prozë ashtu edhe në poezi jam përpjekur të shkruaj atë që zakonisht - në gjuhën e zakonshme të folur - nuk mund të thuhet me fjalë. Po ashtu është. U përpoqa të shpreh të pathënën, siç u dha si arsye e dhënies së çmimit Nobel.

Gjëja më e rëndësishme në jetë nuk mund të thuhet, por vetëm të shkruhet, nëse themi një version të ndryshuar të thënies së famshme të Jack Derrida-s.

Kështu që përpiqem t'i jap fjalë ligjërimin të heshtur.

Dhe kur shkruaja dramë, mund ta përdorja ligjërimin e heshtur, njerëzit e heshtur, në një mënyrë krejtësisht tjetër nga ajo në prozë dhe poezi. Gjithçka që duhej të bëja ishte të shkruaja fjalën "pauzë" dhe ligjërimi i heshtur ishte aty. Në dramën time fjala "pauzë" është pa dyshim fjala më e rëndësishme dhe më e përdorur - pauzë e gjatë, pauzë e shkurtër ose thjesht pauzë.

Në këto pauza mund të ketë kaq shumë, ose kaq pak. Ajo është diçkaja që nuk mund të thuhet, diçkaja që nuk dëshiron të thuhet, ose është më mirë të thuhet duke mos thënë asgjë fare.

Megjithatë, jam shumë i sigurt se ajo që flet më shumë gjatë pauzave është heshtja.

Në prozë, ndoshta të gjitha përsëritjet kanë një funksion të ngjashëm siç bëjnë pauzat në dramën time. Ose mbase kështu e mendoj unë, se ndërsa ka një ligjërim të heshtur në drama, ka një gjuhë të heshtur pas gjuhës së shkruar në romane, dhe nëse dua të shkruaj letërsi të mirë, ky ligjërim i heshtur duhet të jetë edhe i shprehur, për shembull te "Shtatologjia" (Septologjia), është kjo gjuhë e heshtur, për të përdorur disa shembuj të thjeshtë, konkret, që thotë se rrëfimtari i parë i quajtur Asle dhe Asle-i tjetër mund të jenë i njëjti person dhe se i gjithë romani i gjatë, rreth 1200 faqe, është ndoshta vetëm një shprehje e shkruar e një fragmenti të shkëputur nga e tanishmja.

Por një komunikim i heshtur, ose një gjuhë e heshtur, flet kryesisht me tërësinë e një veprë. Qoftë një roman, apo një dramë, apo një krijim teatror, nuk janë vetë pjesët ato që janë të rëndësishme, është tërësia, e cila duhet të gjendet në çdo detaj - ose ndoshta mund të guxoj të flas për frymën e tërësisë, një frymë që në një farë mënyre flet nga afër dhe nga larg.

Dhe çfarë dëgjon atëherë, nëse e dëgjon nga aq afër sa duhet?

Dëgjon heshtjen.

Dhe siç është thënë, vetëm në heshtje mund të dëgjosh zërin e Zotit.

Ndoshta.

Tani për t'u rikthyer te bota reale, dua të përmend diçka tjetër që më dha të shkruarit për teatrin. Të shkruarit është profesion i vetmuar, siç thashë, dhe vetmia është e mirë për sa kohë që rruga e kthimit te të tjerët mbetet e hapur, për të cituar një tjetër poezi të Olav H. Hauge-it.

Dhe ajo që më mbërtheu herën e parë që pashë diçka që kisha shkruar të luajtur në një skenë, po, ishte pikërisht e kundërta e vetmisë, ishte marrëdhënia njerëzore, po, të krijosh art përmes ndarjes së artit me të tjerët - kjo më ngjalli një ndjenjë të madhe lumturie

dhe siguri.

Kjo përndritje më ka shoqëruar që atëherë, dhe besoj se ka luajtur një rol në atë që jo vetëm kam këmbëngulur, me një shpirt të qetë, por edhe kam ndjerë një lloj lumturie edhe nga vëniet e dobtëta në skenë të dramave të mia.

Teatri është me të vërtetë një akt i madh dëgjimi – një regjisor e ka të detyrueshme, ose të paktën duhet ta dëgjojë tekstin, ashtu si aktorët e dëgjojnë njëri-tjetrin dhe regjisorin, dhe po ashtu si publiku e dëgjon të gjithë shfaqjen.

Dhe akti i të shkruarit është për mua akt i të dëgjuarit: kur shkruaj nuk përgatitem kurrë, nuk planifikoj asgjë, filloj me të dëgjuarit.

Pra, nëse duhet të përdor një metaforë për aktin e të shkruarit, duhet të jetë ai i të dëgjuarit.

Kështu, thajse vetëkuptohet se të shkruarit të kujton muzikën. Dhe në një kohë të caktuar, në adoleshencë, kalova pak a shumë drejtpërdrejt nga të angazhimi vetëm me muzikën, te të shkruarit. Në të vërtetë nuk luaja asnjë instrument muzikor dhe as dëgjoja më fare muzikë, fillova të shkruaj, dhe në shkrimet e mia, u përpoqa të krijoja diçka nga ajo që përjetoja kur luaja.

Kjo është ajo që bëra atëherë - dhe ajo që ende bëj.

Diçka tjetër, ndoshta pak e çuditshme, ndodh që kur shkruaj, në një çast të caktuar gjithmonë kam një ndjesi se teksti tashmë është shkruar, është atje diku jashtë, jo brenda meje, dhe se më duhet vetëm ta shkruaj përpara se teksti të zhduket.

Herë pas here mund ta bëj pa asnjë ndryshim, në raste të tjera më duhet ta kërkoj tekstin duke e rishkruar, duke e shkurtuar e redaktuar dhe me kujdes të përpqem të nxjerr tekstin që tashmë është shkruar.

Dhe pikërisht unë që nuk doja të shkruaja për teatër, përfundova duke bërë vetëm këtë gjë për rreth pesëmbëdhjetë vjet. Madje pjesët që shkrova janë vënë në skenë, po, me kalimin e kohës, ka pasur shumë krijime të mia teatrore të vëna në skenë në shumë vende. Ende nuk mund ta besoj këtë. Jeta është kaq e pabesueshme.

Ashtu siç nuk mund ta besoj që tani po qëndroj këtu duke u përpjekur të them disa fjalë pak a shumë të arsyeshme për atë që do të thotë të shkruash, me shkas marrjen e Çmimit Nobel në Letërsi.

Dhe ky çmim, me sa kuptoj, më është dhënë për atë që kam shkruar në dramë dhe në prozë.

Pasi kisha shkruar vetëm drama për shumë vite me radhë, papritur m'u duk sikur mjaftonte, kisha shkruar më se mjaftueshëm, dhe vendosa të mos shkruaja më drama.

Por të shkruarit është bërë një zakon pa të cilin nuk mund të jetoj – ndoshta si Marguerite Duras, mund ta quash sëmundje – kështu që vendosa të kthehem atje ku filloi gjithçka, të shkruaj prozë dhe lloje të tjera shkrimi, siç kisha bërë pak a shumë një dekadë përpara debutimit tim si dramaturg.

Kjo është ajo që kam bërë gjatë dhjetë a pesëmbëdhjetë vitet e fundit. Kur fillova të shkruaj sërish seriozisht prozë, isha i pasigurt nëse mund ta bëja akoma. Fillimisht shkrova “Trilogjinë” – dhe kur më dhanë Çmimin e Letërsisë së Këshillit Nordik për atë roman, e përjetova si një konfirmim të madh që kisha diçka për të ofruar edhe si prozator.

Pastaj shkrova “Shtatologjinë”.

Dhe gjatë procesit të shkrimit të atij romani, kam përjetuar disa nga çastet e mia më të lumtura si shkrimtar, për shembull kur njëri Asle gjen tjetrin të shtrirë në dëborë dhe kështu i shpëton jetën. Ose tek fundi, kur Asle i parë, personazhi kryesor, nis udhëtimin e tij të fundit, me një varkë, një varkë e vjetër peshkimi, me Asleikun, mikun e tij më të mirë dhe të vetëm, për të festuar Krishtlindjet me motrën e Asleikut.

Nuk kisha plan të shkruaja një roman të gjatë, por romani pak a shumë shkroi veten, dhe u bë një roman i gjatë, dhe shkrova shumë pjesë ndërsa gjithçka mori një rrjedhë kaq të qetë, saqë nuk kishte nevojë të ndryshoje asgjë.

Dhe mendoj ky është çasti kur jam më afër asaj që mund ta quash lumturi.

E gjithë “Shtatologjia” ka kujtime brenda saj për shumë nga veprat e tjera që kam shkruar, por të para në një këndvështrim tjetër. Fakti që nuk ka asnjë pikë të vetme në të gjithë romanin, nuk është shpikje. Thjesht e shkrova romanin ashtu, në një rrjedhë, një lëvizje që nuk kërkonte një pikë.

E kam thënë një herë në një intervistë se të shkruash është një lloj lutjeje. Dhe u ndjeva në siklet kur e pashë të shtypur. Por më vonë lexova, si për të më ngushëllim, se Franz Kafka kishte thënë të njëjtën gjë. Pra, ndoshta ashtu është - në fund të fundit?

Librat e mi të parë u vlerësuan shumë pak, por vendosa të mos dëgjoj kritikët, duhet t'i besoja vetes, po, t'i përmbahem mënyrës time të të shkruarit. Dhe nëse nuk do ta kisha bërë këtë, po, atëherë do të kisha reshtur së shkruari pasi romani im debutues, “E kuqe, e zezë” u botua para dyzet vjetësh.

Më vonë pata më së shumti recensa të mira, madje fillova të merrja edhe çmime - dhe më pas mendova se ishte e rëndësishme të vazhdoja me të njëjtën logjikë, nëse nuk do të merrja parasysh recensat e këqija, po kështu nuk duhej të lejoja as suksesin të ndikonte tek unë, duhej të vazhdoja i palëkundur të shkruaja sipas mënyrës sime, të mos hiqja dorë, të ecja pas asaj që kisha krijuar.

Dhe mendoj se kjo është ajo që kam arritur të bëj, dhe vërtet besoj se do të vazhdoj ta bëj këtë edhe pasi kam marrë çmimin Nobel.

Kur u njoftova se më ishte dhënë çmimi Nobel në letërsi, mora shumë imejle dhe urime, dhe sigurisht u kënaqa shumë, shumica e përshëndetjeve ishin të thjeshta dhe gazmore, por disa njerëz shkruanin se po fluturonin nga gëzimi, të tjerët se ishin përlotur. Ishte vërtetë prekesë.

Në veprat e mia ndodhin shumë vetëvrasje. Më shumë se sa do të doja të kishte.


Kam pasur frikë se në këtë mënyrë, mund të kem kontribuar në legjitimimin e vetëvrasjes. Pra, ajo që më preku më shumë se çdo gjë ishin ata që shkruan sinqerisht se ajo që kisha shkruar thjesht u kishte shpëtuar jetën.

Në një farë kuptimi, e kam ditur gjithmonë se të shkruarit mund të shpëtojë jetë, ndoshta edhe mua më ka shpëtuar jetën. Dhe nëse ajo që shkruaj mund të ndihmojë edhe për të shpëtuar jetën e të tjerëve, asgjë tjetër nuk do të më bënte më të lumtur.

Faleminderit Akademisë Suedeze që më vlerësoi me Çmimin Nobel në Letërsi.

Dhe faleminderit Zotit.

OM SWAMI



PYETJET E MËDHA TË JETËS

A është vuajtja pjesë e nevojshme e jetës?

A e kemi ne në dorë shmangien e dhimbjes? Si?

Minerva

Botim i ri nga Minerva

OM SWAMI Pyetjet e mëdha të jetës

Dhimbja është e pashmangshme; vuajtja është zgjedhje.

Humbja është e pashmangshme; pikëllimi jo.

Vdekja është e sigurt.

Po jeta?

Jeta nuk është e sigurt. Pasiguria, paparashikueshmëria, madje dhe irracionaliteti i saj, e bëjnë jetën atë që është.

Shpeshherë, turremi drejt zjarrit symbyllur, shkelim mbi gjarpërinj, biem në gracka. Këto janë zjarri i dëshirës, gjarpë- rinjtë e afekcionit dhe grackat e xhelozisë e të lakmimit. Nëse kafshohemi, digjemi e lëndohemi, e quajmë vuajtje dhe besojmë se e tillë është jeta, kur, në fakt, dhimbjen e ngatërrojmë me vuajtjen. Për të parën kemi pak kontroll, por e dyta është tërësisht në duart tona. Mund të përballemi me qetësi me situatat, ose të rrëmbehemi prej tyre. Gjithçka që duhet është të hapim sytë. Nuk duhet të harrojmë se kjo zgjedhje është e jona; gjithmonë.

Libri i ri i Om Swami-t tregon rrugën drejt ndriçimit përmes vetëdijesimit.

Om Swami është një udhëheqës shpirtëror dhe autor bestseller. Përpara se të hiqte dorë nga jeta materiale, ishte një sipërmarrës i suksesshëm i disa kompanive teknologjike. Ai u bë milioner në moshën 25 vjeçare. Në moshën 30 vjeçare dhuroi të gjithë pasurinë dhe nisi rrugëtimin e tij shpirtëror. Nga apartamentet luksoze në Londër e Sidneji, te një kasolle pa ujë dhe stërnë, në vetminë tmerruese himalajane, historia e tij është e pazakontë.

Përktheu Arben Shehu

220 faqe

Çmimi 1000 lekë



Akademia e Shkencave e Shqipërisë
*Njësia kërkimore-studimore për
arbëresbët, arvanitët dhe arbnesbët*



Universiteti i Shkodrës
Luigj Gurakuqi



Provincia Françeskane Shqiptare
Shkodër



Fondazione Universitaria
Fondazioni Universitarie
"Francesco Solano"

Leonardo De Martino

Opere - Vepra

(a cura di Matteo Mandalà)



Botime Françeskane
Shkodër 2023